



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 maj 2023
Nr.ref.: AGJ 2197/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI69/21

Parashtrues

Partia Liberale Egjiptiane (PLE)
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK)

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, AA.nr.29/2021
të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 12 marsit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), e përfaqësuar me autorizim nga Veton Berisha dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), e përfaqësuar me autorizim nga Albert Kinolli (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [AA.nr.29/2021] e 12 marsit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Vendimin [A.nr.736/2021] të 7 marsit 2021 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (në tekstin e mëtejme: PZAP).
3. Parashtruesit e kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e kanë pranuar më 15 mars 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat e garantuara me: (i) nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 3 [E drejta për zgjedhje të lira] të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); (ii) paragrafin 4 të nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrotjtjen e Pakicave Kombëtare (në tekstin e mëtejme: Konventa Kornizë); dhe (iii) nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 13 prill 2021, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 prill 2021, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR.KSH KI 69/21] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
8. Më 19 prill 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe u kërkoi që të: (i) plotësojnë formularin e kërkesës; (ii) të dorëzojnë autorizimet për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese; dhe (iii) të dorëzojnë ankesat e tyre të parashtruara në PZAP dhe Gjykatën Supreme.
9. Më 28 prill 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë: (i) formularin e plotësuar të kërkesës; (ii) autorizimet për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese nga Veton Berisha dhe Albert Kinolli, respektivisht; dhe (iii) kopjet e ankesave të tyre të parashtruara në PZAP dhe kopjen e ankesës së parashtruesit të kërkesës (PLE) në Gjykatën Supreme.

10. Më 11 maj 2021, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme, PZAP, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.
11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit [KK-SP 71-2/21] të 17 majit 2021 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit [Nr. KK160/21], përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani caktohet kryesuese në Kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar si anëtare e Kolegjit, duke përfshirë rastin aktual.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit [KK-SP 71-2/21] të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, përmes Vendimit [Nr. KSH.KI69/21], caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi anëtar në Kolegjin shqyrtues në vend të Arta Rama-Hajrizi, mandati i së cilës si gjyqtare, kishte përfunduar më 26 qershor 2021.
16. Më 6 gusht 2021, Avokati i Popullit dorëzoi një opinion në Gjykatë të titulluar: *“Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën e subjekteve politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), dhe individët Veton Berisha dhe Albert Kinolli”*.
17. Më 10 dhjetor 2021, Gjykata shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri vendosi që shqyrtimin e mëtejme të kërkesës ta shtyjë për një seancë të radhës pasi të jetë plotësuar me analizë shtesë.
18. Më 31 janar 2022, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës (PLE) dorëzoi një kërkesë në Gjykatë për: (i) informim se në cilën fazë të procedurës është kërkesa e tij; dhe (ii) kërkoj që kërkesa e tij të trajtohet me urgjencë.
19. Më 1 shkurt 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës (PLE), se kërkesa e tij është në procedurë të shqyrtimit para Gjykatës.
20. Më 30 mars 2022, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri vendosi që shqyrtimin e mëtejme të kërkesës pas plotësimeve shtesë të përcaktojë për një seancë të radhës.

21. Më 1 qershor 2022 përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës (PLE) dorëzoi një kërkesë në Gjykatë për informim se në cilën fazë të procedurës është kërkesa e tij.
22. Më 11 nëntor 2022 përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës PLE dorëzoi një kërkesë në Gjykatë për informim se në cilën fazë të procedurës është kërkesa e tij.
23. Më 16 nëntor 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës (PLE), se kërkesa e tij është në procedurë të shqyrtimit para Gjykatës.
24. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
25. Më 13 prill 2023, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri vendosi që shqyrtimin e mëtejme të kërkesës pas plotësimeve shtesë të përcaktojë për një seancë të radhës.
26. Më 20 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi: (i) të deklarojë, njëzëri të papranueshme kërkesën e Partisë Rome të Bashkuar të Kosovës (PREBK) të përfaqësuar nga Albert Kinolli; (ii) të deklarojë, njëzëri të pranueshme kërkesën e Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), të përfaqësuar nga Veton Berisha; (iii) të konstatojë, me shumicë votash që Aktgjykimi [AA.nr.29/2021] i 12 marsit 2021 i Gjykatës Supreme nuk ka cenuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës (PLE) për tu zgjedhur sipas paragrafit 1 të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe (iv) të konstatojë, me shumicë votash që ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe që në bazë të parimit të sigurisë juridike nuk prek të drejtat e palëve të treta.
27. Në përputhje me rregullin 62 (Mendimet konkurruese) të Rregullores së punës të Gjykatës, gjyqtari Radomir Laban ka përgatitur mendim mospajtues, i cili do të publikohet së bashku me këtë Aktgjykim.

Përmbledhja e fakteve

28. Më 6 janar 2021, U.d Presidentja znj. Vjosa Osmani, nxori Dekretin nr.02/2021, për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të cilat u caktuan për tu mbajtur më 14 shkurt 2021.
29. Më 22 janar 2021, parashtruesit e kërkesës (PLE) dhe (PREBK), përmes Vendimeve [229/221] dhe [224/2021] të KQZ-së, u certifikuan si subjekte politike për të garuar në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021. Në të njëjtën datë përmes Vendimit [231/2021] të KQZ-së, subjekti politik Romani Iniciyativa po ashtu u certifikua si subjekt politik për të garuar në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021.
30. Më 14 shkurt 2021, u mbajtën zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
31. Më 4 mars 2021, KQZ përmes Vendimit [nr. 860-2021], shpalli rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend të mbajtura më 14 shkurt 2021.

32. Sipas rezultateve të shpallura të KQZ-së (i) parashtguesit e kërkesës, përkatësisht subjekti politik (PLE) morri 2.430 vota ndërsa subjekti politik (PREBK) morri 1.074 vota; dhe (ii) subjekti politik Romani Iniciyativa morri 4.049 vota.
33. Më 5 mars 2021, parashtguesit e kërkesës, përkatësisht PLE dhe PREBK, si dhe tri (3) subjektet politike, Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK) dhe Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), respektivisht, dorëzuan ankesë të përbashkët në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) *“përkitazi me votat e fituara në mënyrë kundër kushtetuese dhe kundërligjore nga Subjekti Politik “Romani Iniciyativa”*. Parashtguesit e kërkesës përmes ankesës së tyre kontestuan *“rezultatit e Subjektit Politik “Romani Iniciyativa” të Zgjedhjeve të Parakohshme të mbajtura më 14 shkurt”* duke pretenduar shkelje të paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës.
34. Parashtguesit e kërkesës, në thelb, pohuan se: (i) *“votat e fituara nga Subjekti Politik “Romani Iniciyativa” janë të orkestruara dhe të koordinuara në mes të këtij subjekti politik dhe të Subjektit Politik Lista Serbe, si dhe me subjekte tjera politike, me qëllim të përforsimit të kundërligjshëm të pozitës së tyre politike në Kuvendin e Republikës së Kosovës”*; dhe (ii) *“votat e “Listës Serbe” në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019 në Kosovë ishin më të larta për nga numri dhe kësaj here, në këto zgjedhje ato ishin më të vogla, pasi pjesa tjetër e tyre janë edhe tek Subjekti Politik “Romani Iniciyativa”*; dhe (iii) *“Lista Serbe” organizoi, orkestroi dhe detyroi pjesën tjetër të mbetur të votuesve serb të votojnë Subjektin Politik “Romani Iniciyativa”*. Për më tepër, në komunat e lartshënuara [Kamenicë, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Graçanicë, Klokot dhe Mitrovica e Veriut], numri i banoreve nga komuniteti rom' është shumë më i vogël se sa votat që kishte marrë Subjekti Politik “Romani Iniciyativa”, kurse në komunat Ranillug dhe Partesh, bazuar në të dhënat statistikore zyrtare të Agjencisë Statistikore të Kosovës, të publikuara në vitin 2011, në bazë të regjistrimit të popullsisë, fare në këto dy komuna nuk kishte pjesëtar të komunitetit rom”.
35. Më tej dhe përkitazi me pretendimin për shkelje të paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës, parashtguesit e kërkesës pretenduan, ndër tjerash, se: (i) *“Republika e Kosovës dhe të gjitha autoritetet e saj, përfshirë PZAP-në e kanë për obligim kushtetues konform nenit 58(4) që mes tjerash, të garantojnë pjesëmarrjen efektive të të gjitha komuniteteve në jetën publike dhe vendimmarrje. Një obligim i tillë për Kosovën derivon edhe nga neni 15 i Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e cila, konform nenit 22(4) të Kushtetutës, ka status kushtetues dhe është direkt e aplikueshme në Kosovë dhe, në rast konflikti, ka epërsi ndaj dispozitave ligjore edhe akteve tjera të autoriteteve publike”*; dhe (ii) *“Mekanizëm kyç në tërë këtë strukturë pa efikasitetin e të cilit nuk: kanë kuptim mekanizmat tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve në Kosovë padyshim që është pjesëmarrja e garantuar e komuniteteve joshumicë në Kuvendin e Kosovës. Njëzet ulëse nga gjithsejt 120 janë të garantuara për komunitetet joshumicë sipas nenit 64 (2) të Kushtetutës (të cilat elaborohen tutje nga neni 111 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme). Ky garancion kushtetues i njëzet vendeve të garantuara (dhjetë për serbet dhe dhjetë për jo serbet) është i sanksionuar me faktin që as Kushtetuta e as Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk përcaktojnë prag për fitimin e këtyre vendeve, por mjafton plotësimi i dy kushteve: e para, që ata që konkurrojnë të deklarohen se i takojnë dhe përfaqësojnë komunitetin përkatës; dhe, dy, se, pa marrë parasysh votën e fituar, njëzet vendet janë të garantuara për shkak se vota supozohet se vjen pikërisht nga komuniteti i njëjtë me atë që deklarohet se përfaqëson komunitetin që konkurron për deputet”*.

36. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton që KQZ kishte paraqitur përgjigje ndaj apeleve të lartcekura, përmes së cilës, ndër të tjerash, kishte kërkuar që PZAP apelet t'i refuzojë si të pabazuara, duke theksuar, ndër tjerash se: *"Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin e punës, si dhe futjen e të dhënave, skanimit e materialeve zgjedhore, verifikimin, hetimin e Formularëve e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve, Formularët e Rezultateve të Kandidateve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe jo relevantë". Në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr. 06/2013, secili Formular i Rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e subjekteve me votat e kandidatëve. Nga auditimi që i është bërë Formularëve të Rezultateve, rezulton se ka pasur probleme të mos shënimit të saktë në kuptimin teknik të votave të subjekteve, kur krahasohen me votat e kandidatëve, rezulton se kandidatët kanë vota por subjekti nuk ka vota dhe ka raste kur subjekti ka vota ndërsa kandidatët nuk kanë vota. Procedura e QNR-se, nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të (te procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim. Po ashtu, në rastet kur subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në auditim. Gjatë procesit të auditimit kontrollohen të gjitha këto raste dhe në bazë të të gjeturave përgatitet raporti. Andaj, mbi bazën e të gjeturave nga raporti i auditimit, QNR, i ka rekomanduar KQZ-së, që një pjese e vendvotimeve të caktuara, e të cilat kanë pasur probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Një gjë e tillë ka ndodhur gjithmonë edhe në të kaluarën, kur është mundësuar korrektimi i secilit lëshim që është vërejtur në proces, po ashtu edhe në këto zgjedhje. Formularët të cilët nuk kanë përputhje matematikore nuk mund të procedohen si të rregullt (këtë nuk e lejon sistemi i përpunimit të të dhënave) dhe i njëjti do t'i nënshtrohet auditimit në QNR, dhe varësisht nga rezultati, eventualisht edhe rinumërimit. Në QNR, procedohen të dhënat nga Formularët e Rezultateve nga subjektet dhe kandidatët e tyre, në bazë të të dhënave që janë në FRK dhe FPR. Andaj, KQZ-ja, është e obliguar që të procedoj formularët e proceduar në mënyrë të rregullt dhe rezultatin i cili është i pasqyruar në FRK dhe FPR. Ndërsa, gjatë procedimit të materialit zgjedhor KQZ-ja, nuk ka autorizim që të vlerësoj se si kanë votuar komunitetet dhe për kënd kanë votuar. Andaj, konsiderojmë se ankesa ka të bëjë me të drejtat kushtetuese, dhe jo procedurale, pra KQZ-ja, nuk është kompetente të bëjë interpretime kushtetuese, por vetëm bënë organizimin e zgjedhjeve në mënyrë teknike dhe procedurale. Andaj, i gjithë materiali zgjedhor i cili gjendet në QNR, nëse PZAP, konstaton dhe konsideron të nevojshme mund të bëjë hetim dhe verifikim të gjendjes faktike." (shih faqe 5 e Vendimit [A. nr. 736/2021] të 7 marsit 2021 të PZAP-it).*

37. Më 7 mars 2021, PZAP përmes Vendimit [A. nr. 736/2021] vendosi që:

- I. Të PRANOHEN pjesërisht apelet e parashtresve të kërkesës dhe subjekteve politike PAI dhe PDAK duke vendosur që të anulohen fletëvotimet [e specifikuar në këtë pikë] për subjektin politik Romani Iniciativa në dyzet e një (41) vendvotimet e specifikuar në këtë Vendim në Komunën e Leposaviqit [234 fletëvotime në 10 vendvotime], Komunën e Novobërdës [209 fletëvotime në 11 vendvotime], Komunën e Ranillugut [159 fletëvotime në 8 vendvotime] Komunën e Parteshit [88 fletëvotime në 7 vendvotime] dhe Komunën e Kllokotit [147 fletëvotime në 5 vendvotime];
- II. Të URDHËROHET KQZ që fletëvotimet e anuluar sipas pikës I të dispozitivit të Vendimit t'i largojë nga rezultati përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të publikuara përmes Vendimit të KQZ-së nr. 860-2021 të 4 marsit 2021;

III. REFUZOHEN si pjesërisht të pabazuara apelet e parashtruesve të kërkesës [PLE dhe PREBK], dhe subjekteve politike PAI dhe PDAK për anulimin e fletëvotimeve për subjektin Romani Iniciyativa në vendvotimet e specifikuar [50 vendvotimet e specifikuar në këtë pikë të dispozitivit, faqe 2 e Vendimit të PZAP-it] në këtë vendim. Në këtë pikë, nuk ishte vendosur përkitazi me kërkesën e parashtruesve të kërkesës për anulimin e fletëvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

38. Në Vendimin e tij, PZAP fillimisht theksoi se: *“Paneli, me datat 06 dhe 7 mars 2021, sipas detyrës zyrtare, ka zhvilluar hetime për të vërtetuar gjendjen faktike të rastit konkret dhe erdhi në përfundim se apelet janë pjesërisht të bazuara: Subjekti politik Romani Iniciyativa, ka marrë vota më shumë se që ka pasur votues potencial të komunitetit Rom, për të votuar në ditën e votimit të datës 14 shkurt 2021, në [41 vendvotimet e specifikuar në Vendimin e PZAP-it, faqe 6 që i referohen komunave të Leposaviqit, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit dhe Klokotit] bazuar në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i vitit 2011, Raportit të OSBE-së të vitit 2018 dhe bazuar në Listën Përfundimtar të Votimit të verifikuar emër për emër për secilin votues potencial, në vendvotimet e lartcekura. Votat e marra në vendvotimet e lartcekura nga Romani Iniciyativa janë në disproporcion me numrin e banorëve, të komunitetit rom, e të cilat paraqesin vota të pavlefshme, për faktin se është standard jodemokratik, që me votat e votuesve të një komunitetit tjetër të sigurohet e drejta e përfaqësimit të një komunitetit tjetër dhe si të tilla nuk paraqesin lidhje objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar”.*
39. Së dyti, PZAP në Vendimin e tij shton se: *“Për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, subjekte të caktuara si në këtë rast Romani Iniciyativa ka marrë shumicën e votave nga Komunitetit Serb, gjë që në këtë rast, paraqet devijim të vullnetit të votuesit të komunitetit rom, e krejt kjo në thelb paraqet minimin e integritetit të procesit.”* Në kontekst të kësaj të fundit, PZAP konsideroi se *“Sipas vlerësimit të Panelit, minimi i procesit zgjedhor, përmes votimit në këtë mënyrë të orkestruar për subjekte të caktuara për të zgjedhur përfaqësuesit e komunitetit rom, përveç devijimit të vullnetit të votuesit, kjo në vetvete cenon demokracinë e brendshme zgjedhore, eliminon garën në mes të subjekteve për vendet e garantuara dhe krejt kjo është në kundërshtim me nenin 111 paragrafi 1 i [Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme], nenin 58, paragrafin 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane”.*
40. Së treti, sipas PZAP: *“E drejta e votës dhe liria e votimit sipas vlerësimit të Panelit, në rastin e vendeve të rezervuara nuk është identike me rastin e vendeve jo të rezervuara, pasi për vendet e rezervuara është më rëndësi lidhje objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar, sepse vetëm kështu sigurohet e drejta e përfaqësimit në kuptim të dispozitave të LZP-së dhe në frymën e dispozitave dhe standardeve kushtetuese. Vendet e rezervuara janë garanci kushtetuese, të cilat Republika e Kosovës i ka marr, me të vetmin qëllim për trajtimin e avancuar të të drejtave të pakicave në kuadër të institucioneve shtetërore”.*
41. PZAP konstatoi se: *“[...] se ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara e të cilat vota janë fituar nga votues të cilët janë të komunitetit tjetër në krahasim me komunitetin e subjektit për të cilin ka votuar kjo vërtetohet nga numri i banorëve në krahasim me numrin e votave të marra, ndërsa numri i banorëve pasqyrohet përmes të dhënave të marra nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës të vitit 2011, por edhe raporteve kredibile të OSBE-së [Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim e Evropës] dhe Librat e Votuesve”.*

42. Së katërti, PZAP duke u bazuar në Raportet e OSBE-së [të vitit 2018]; Listën Përfundimtare të Votuesve, e verifikuar nga PZAP në lidhje me komunat e Leposaviqit, Novobërdës, Parteshit, Klokotit dhe Ranillugut theksoi dhe konstatoi si në vijim: (i) në Komunën e Leposaviqit numri i banorëve të komunitetit rom është 12, dhe nga lista e votuesve rezultoi të jetë një votues, dhe në këtë komunë kanë votuar 234 votues për subjektin politik Romani Iniciyativa; (ii) në Komunën e Novobërdës *“numri i banorëve të komunitetit Rom [...] është 63 banorë, ndërsa nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të verifikuar nga PZAP, për VV [Vendvotimet] në këtë Komunë rezultoi të mos jetë asnjë votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 209 votues, për subjektin politik Romani Iniciyativa, që rezultoi se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti rom”* në këtë komunë; (iii) në Komunën e Ranillugut, sipas Raportit të OSBE-së *“po ashtu as nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të Verifikuar nga PZAP, për VV në këtë Komunë, nuk ka asnjë votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 159 votues, për subjektin politik Romani Iniciyativa, që rezultoi se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti Rom pasi që nuk ekziston asnjë banorë në këtë komunë të komunitetit Rom”*; (iv) në Komunën e Parteshit, PZAP duke u bazuar në Raportin e OSBE-së theksoi se nuk ka banorë të komunitetit Rom në Komunën e Parteshit, po ashtu as nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të Verifikuar nga PZAP, për VV [Vendvotimet] në këtë Komunë, nuk ka asnjë votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 88 votues, për subjektin politik Romani Iniciyativa, që rezultoi se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti Rom; dhe (v) në Komunën e Klokotit, PZAP duke u mbështetur në Raportin e lartcekur të OSBE-së specifikoi se në këtë Komunë janë 9 banorë të komunitetit Rom në Komunën e Klokotit, ndërsa nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të verifikuar nga PZAP nuk ka asnjë votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 147 votues, për subjektin politik Romani Iniciyativa, që rezultoi se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti Rom.
43. Në kontekst të kësaj të fundit, PZAP vlerësoi se: *“tendenca për krijimin e praktikave të tilla të votimit masiv nga pjesëtarët e njërit komunitet për subjektin e komunitetit tjetër, paraqet praktikë të rrezikshme e cila në të ardhmen do të mund të shfrytëzohej nga komunitetit shumicë, për t’ia pamundësuar të drejtën e përfaqësimit në mënyrë objektive komuniteteve tjera pakicë”*.
44. Në fund, PZAP përkitazi me pikën III të dispozitivit, përmes së cilit apelet e parashtruesve të kërkesës ishin refuzuar si pjesërisht të pabazuara konstatoi se: *“[...] pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse kërkesën për anulimin e të gjitha votave në vendvotimet e cekuar si në pikën e III-të të dispozitivit të këtij vendimi, do të përbënte anulim të pabazuar të fletëvotimeve të vlefshme, pasi jo të gjitha votat për komunitetin romë kanë qenë të orkestruara”*.
45. Më 9 mars 2021, kundër Vendimit të lartcekur, të 7 marsit 2021 të PZAP, ankesa në Gjykatën Supreme parashtruan subjektet politike PLE, PAI dhe LPRK, përmes të cilave kontestuan ligjshmërinë e Vendimit të PZAP-it dhe kërkuan që ankesa e tyre të pranohet dhe të anulohen fletëvotimet që i përkasin subjektit politik Romani Iniciyativa në vendvotimet e specifikuar në ankesë në Komunat e Graçanicës, Kamenicës dhe Mitrovicës së Veriut. Subjektet politike PLE dhe PAI, në ankesën e tyre kishin specifikuar se PZAP, nuk ka vendosur në lidhje me vendvotimet në Komunën e Mitrovicës së Veriut.
46. Kundër Vendimit të lartcekur të 7 marsit 2021 të PZAP-së subjekti politik (PREBK), nuk kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme.

47. Në ankesën e tyre kundër Vendimit të 7 marsit 2021 të PZAP-së të parashtruar në Gjykatën Supreme, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht PLE: (i) fillimisht theksoi se PZAP, përmes Vendimit të tij të 7 marsit 2021, nuk kishte vendosur për kërkesën e tij për anulimin e fletëvotimeve të subjektit politik Romani Iniciyativa në vendvotimet e specifikuar në Komunën e Mitrovicës së Veriut; (ii) “[...] për të gjitha vendvotimet të cilat ne i kemi kontestuar në këto tri komuna [Graçanicë, Kamenicë dhe Mitrovicë Veriore] si me lart të ANULOHEN votat që kanë shkuar për "Romani Iniciyativa" proporcionalisht me numrin e popullsisë rome, duke qenë se edhe në këto komuna ka një disproporcion mes votës së dhënë për këtë subjekt si dhe numrit real të popullsisë rome: Në Graçanicë, ku RI ka fituar 1773 vota ndërkaq numri i votuesve potenciale të popullsisë rome është 745, të anulohen 1028 vota për RI; Në Kamenicë, ku RI ka fituar 283 vota ndërkaq numri i votuesve potenciale të popullsisë rome është 240, të anulohen 43 vota për RI; si dhe në Mitrovicë Veriore, ku RI ka fituar 198 vota ndërkaq numri i votuesve potenciale të popullsisë rome është 40, të anulohen 158 vota për RI”; dhe (iii) “Ne mirëpresim Vendimin e PZAP i cili gjente pjesërisht të bazuar apelin tonë. Si rrjedhojë e këtij Vendimi të PZAP, njëra ulëse e projektuar të plotësohet nga përfaqësues rome por të zgjedhur nga komuniteti serb siç duket do t'i kthehet përfaqësuesve legjitime të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Mirëpo, duke qenë se ulësja tjetër akoma do të vazhdojë të përfaqësohet nga një deputet i " përkatësisë rome por i zgjedhur nga komuniteti serb, ne konsiderojmë se kjo gjendje e tillë përbën shkelje të të drejtave themelore të garantuara në nenin 58(4) të Kushtetutës (Amandamenti I), duke u mohuar komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përfaqësimin efektiv në Kuvendin e Kosovës, ashtu siç e kemi elaboruar në Ankesën tonë të parashtruar në PZAP (të cilën e bashkëngjitem në këtë Ankesë për Gjykatën Supreme dhe lusim Gjykatën t'i referohet, në veçanti seksionit me titull Shkeljet kushtetuese dhe ligjore të rastit)”.
48. Më 10 mars 2021, PZAP nxori Vendimin plotësues [A. nr. 736/2021] përmes të cilit vendosi që Vendimi i tij [A. nr. 736/2021] i 7 marsit 2021 të plotësohet si në vijim:
- I. Pranohen pjesërisht të bazuara apelet A. nr. 736/2021 të 5 marsit 2021, të parashtruara nga subjektet politike PLE, PAI, PREBK, PDAK, LPRK, anulohen 40 fletëvotime në Vendvotimin 3502/01R në Komunën Ranillug, të cilat i përkasin subjektit politik Romani Iniciyativa; dhe*
- II. Refuzohen si të pabazuara apelet e parashtruara nga subjektet politike PLE, PAI, PREBK, PDAK dhe LPRK përmes së cilave kanë kërkuar që të anulohen edhe fletëvotimet në pesëmbëdhjetë (15) vendvotimet e specifikuar që i përkasin subjektit politik Romani Iniciyativa. [Sipas verifikimit përmes uebfaqes së KZQ-së këto vendvotime gjenden në Komunën e Mitrovicës së Veriut].*
49. Kundër Vendimit plotësues të PZAP-it, të 10 marsit 2021, parashtruesit e kërkesës, përkatësisht PLE dhe PREBK, nuk kishin paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme.
50. Më 9 mars dhe 11 mars 2021, respektivisht, kundër Vendimit të lartcekur të 7 marsit 2021 të PZAP-it dhe Vendimit plotësues të 10 marsit 2021 të PZAP-it, subjekti politik Romani Iniciyativa kishte parashtruar ankesë, ndër të tjerash, duke kërkuar nga Gjykata Supreme që të anulohet Vendimet e PZAP-it, pas konstatimit se të njëjtat janë në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës.
51. Në një datë të paspecifikuar, në Gjykatën Supreme, PZAP parashtroi përgjigje ndaj ankesave të sipër cekura të parashtruesit të kërkesës (PLE) dhe subjektit politik (PAI), si dhe ankesës së subjektit politik Romani Iniciyativa.

52. Më 12 mars 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [AA.nr.29/2021] vendosi që: (i) të refuzojë si të pabazuar ankesën e subjektit politik Romani Iniciyativa kundër Vendimit të PZAP-it të 7 marsit 2021 dhe Vendimit plotësues të PZAP-it të 10 marsit 2021; dhe (ii) të refuzojë si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës (PLE) dhe subjekteve politike, PAI dhe LPRK kundër Vendimit të PZAP-it të 7 marsit 2021.
53. Më 13 mars 2021, KQZ përmes Vendimit [nr.950/2021] certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend të 14 shkurtit 2021, sipas listës vijuese të rezultateve të zgjedhjeve:
- a. Lëvizja VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejshëm LVV), 58 deputetë;
 - b. Partia Demokratike e Kosovës - PDK, 19 deputetë;
 - c. Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK, 15 deputetë;
 - d. Srpska Lista, 10 deputetë;
 - e. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës -AAK, 8 deputetë;
 - f. Kosova Demokratik Turk Partisi - KDTP, 2 deputetë;
 - g. Koalicija “Vakat”, 1 deputet;
 - h. Iniciyativa e Re Demokratike e Kosovës, 1 deputet;
 - i. Roman Iniciyativa– RI, 1 deputet;
 - j. Nova Demokratska Stranka - NDS, 1 deputet;
 - k. Socialdemokratska Unija –SDU, 1 deputet;
 - l. Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;
 - m. Partia e Ashkalinjëve për Integrim, 1 deputet;
 - n. Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës - LPRK, 1 deputet.

Pretendimet e parashtrueseve të kërkesës

54. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përkitazi me refuzimin e ankesës së tyre kundër Vendimeve të PZAP-së përmes së cilit pjesërisht ishin refuzuar apelet e tyre për anulimin e fletëvotimeve për subjektin politik Romani Iniciyativa në vendvotimet e Komunës së Graçanicës, Kamenicës dhe Mitrovicës së Veriut përbëjnë shkelje të (i) paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë; dhe (ii) nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
55. Parashtruesit e kërkesës, në kërkesën e tyre, fillimisht theksojnë se: *“Si rezultat i këtyre Vendimeve të atakuara, vetëm njëra ulëse në Kuvendin e Kosovës që u fitua në zgjedhje nga Romani Iniciyativa (ulësja e përbashkët për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian) u arrit të rikuperohej, me c ‘rast mandatin e deputetit në këtë ulëse e fitoi përfundimisht përfaqësuesi tjetër (legjitim) nga komuniteti rom. Ndërkaq, mandati i ulëses tjetër, asaj të garantuar për komunitetin rom, vazhdon të ushtrohet në mënyrë jolegjitime nga përfaqësuesi i Romani Iniciyativa. Sikur PZAP dhe Gjykata Supreme të kishin anuluar edhe votat e parregullta që Romani Iniciyativa ka marrë në tri komunat e lartpërmendura, ku numri i votave të fituara është gjithashtu më i lartë sesa numri i banoreve të komunitetit rom në atë komune (sidomos në Graçanicë), edhe në ulësen tjetër të garantuar do të vinte përfaqësuesi tjetër legjitim nga komuniteti rom (ku përfaqësuesi legjitim aktual në ulëse të përbashkët për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian do të zinte ulësen e garantuar për komunitetin rom që momentalisht përfaqësohet nga Romani Iniciyativa, ndërkaq një përfaqësues tjetër legjitim do të zinte ulësen e përbashkët për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian). Kështu, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të mos përfaqësohen*

plotësisht në mënyrë efektive në Kuvendin e Republikës së Kosovës si pasoje e këtyre Vendimeve pjesërisht jokorrekte”.

(i) Përkitazi me pretendimin për shkelje të paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë

56. Përkitazi me paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë, parashtuesit e kërkesës, në thelb, pretendojnë (i) shkelje të përfaqësimit efektiv të komuniteteve jo-shumicë në komunat e Kamenicës, Graçanicës dhe Mitrovicës së Veriut; (ii) mungesë të mekanizmave konkret për garantimin e pjesëmarrjes efektive të komuniteteve jo-shumicë; dhe (iii) shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së dhe nenit 4 (2) të Konventës Kornizë.
57. Përkitazi me paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë, parashtuesit e kërkesës, fillimisht theksojnë se “*në rendin kushtetues kosovar ekziston një e drejtë kushtetuese e komuniteteve për përfaqësim dhe pjesëmarrje efektive në jetën politike*” dhe në këtë kontekst, i referohen kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës, në të cilin kapitull sipas tyre “*hyn edhe e drejta e komuniteteve për pjesëmarrje efektive në procesin politik, e cila korrespondon me obligimin e përcaktuar shtetëror për të garantuar këtë pjesëmarrje, ashtu siç parashihet edhe me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*”. Në këtë kontekst, parashtuesit e kërkesës në mënyrë specifike i referohen paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës (i cili është ndryshuar me Amandamentin nr. 1 të Amandamentimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të publikuar në Gazetën Zyrtare më 7 shtator 2012).
58. Sipas parashtuesve të kërkesës “*Republika e Kosovës dhe të gjitha autoritetet shtetërore të saj e kanë për obligim kushtetues konform nenit 58 (4) të Kushtetutës që, mes tjerash, të garantojnë pjesëmarrjen efektive të të gjitha komuniteteve në jetën publike dhe vendimmarrje. Një obligim i tillë për Kosovën derivon edhe nga neni 15 i Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e cila, konform nenit 22 (4) të Kapitullit II të Kushtetutës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], ka status kushtetues dhe është direkt e aplikueshme në Kosovë dhe, në rast konflikti, ka epërsi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve tjera të autoriteteve publike*”.
59. Parashtuesit e kërkesës, më tej nënvizojnë se: “*Jo vetëm që të drejtat nga kapitulli III janë të zbatueshme dhe secili individ nga komuniteti mund të kërkojë zbatimin e tyre (përfshirë të drejtat nga neni 58 (4), të cilat shprehimisht u garantohen pos komuniteteve edhe pjesëtarëve të tyre), por e drejta për pjesëmarrje efektive në rastin konkret është e garantuar edhe me kapitullin II të Kushtetutës [Të Drejtat dhe Lirinë Themelore], përmes dispozitave të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (zbatimi i së cilës garantohet me nenin 22 të Kushtetutës)*”.
60. Më tej dhe sipas parashtuesve të kërkesës: “*Njëzet ulëse nga gjithsejt 120 janë të garantuara për komunitetet joshumicë sipas nenit 64 (2) të Kushtetutës. Ky garancion kushtetues i njëzet vendeve të garantuara (dhjetë për serbet dhe dhjetë për joserbet) është i sanksionuar me faktin që as Kushtetuta e as Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk përcaktojnë prag për fitimin e këtyre vendeve, por mjafton plotësimi i dy kushteve: e para, që ata që konkurrojnë të deklarojnë se i takojnë dhe përfaqësojnë komunitetin përkatës;*

dhe, dy, se, pa marre parasysh votën e fituar, njëzet vendet janë të garantuara për shkak se vota supozohet se ujen pikërisht nga komuniteti i njëjtë me atë që deklarohet se përfaqëson komunitetin që konkurron për deputet”. Mbështetur në këtë arsyetim, parashtuesit e kërkesës nënvizojnë se ky është një variant i demokracisë konsociacionale.

61. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, parashtuesit e kërkesës pohojnë se: “Në rastin konkret të zgjedhjeve të datës 14 Shkurt 2021, përfaqësuesit të Romani Inicijativas që momentalisht ka zënë ulësen në Kuvend i mungon lidhja objektive me komunitetin rom, duke qenë se votat që ky subjekt politik ka marre në komunën e Graçanicës, Kamenicës dhe Mitrovicës se Veriut janë gjithashtu në numër më të madh sesa banorët e komunitetit rom në këto komuna, ndaj ato vota janë marrë nga votuesit e komuniteteve tjera. Pa këto vota të parregullta ky përfaqësues nuk do të ushtronte këtë funksion aktualisht në Kuvend. Përfaqësuesi nga komuniteti rom ka arritur të zgjedhet deputet në ulëse të garantuara si rezultat i votave të një komuniteti tjetër, për faktin e thjeshtë që ai komunitet është numerikisht më i madh sesa ai rom. Rrjedhimisht, ekziston një shpëputje mes përfaqësuesit dhe elektoratit të këtij komuniteti që sipas Kushtetutës supozohet t’i japë legjitimitetin përfaqësues deputetit në rend të parë. Një deformim i tillë i këtij mekanizmi përfaqësues mbron përfaqësimin efektiv të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë dhe bie ndesh me nenin 58(4) dhe 64(2) të Kushtetutës së Kosovës”.
62. Në lidhje me vendimet e kontestuara të PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme, parashtuesit e kërkesës theksojnë se gjatë interpretimit të tyre: “PZAP dhe Gjykata Supreme ishte në rrugën e duhur që të përbente një “mase adekuate” në rrethanat e rastit konkret për garantimin e pjesëmarrjes efektive të komuniteteve në jetën politike. Fatkeqësisht, për arsye të paqarta për ne, PZAP dhe pastaj Gjykata Supreme, mbase edhe në mungesë të standardeve precize ligjore, nuk anuluan edhe votat që Romani Inicijativa kishte fituar në tri komunat e lartpërmendura, megjithëse edhe në këto komuna vlenin të njëjtat parregullsi, duke shfaqur kështu mungesë të adekuatshmërisë së masave dhe përpjekjeve të shtetit të Kosovës për të garantuar pjesëmarrjen efektive të komuniteteve në jetën politike”.
63. Parashtuesit e kërkesës specifikojnë që: “nuk ka praktika dhe norma precize ndërkombëtare, as në kuadër të Këshillit të Evropës e as gjetiu, të cilat në mënyrë shprehimore përcaktojnë që në ulëse të garantuara duhen zgjedhur në çdo vend dhe çdo rast përfaqësues vetëm me vota që vijnë nga pjesëtarët e komunitetit të cilit ai përfaqësues i takon. Zatën, nuk ka as standarde precize ndërkombëtare përgjithësisht të pranueshme që kërkojnë ulëse të garantuara në rend të parë”, dhe për pasojë, ndër tjerash, propozojnë që: “Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës duhet ta rregullojë këtë gjendje. Në vlerësojmë që Gjykata Kushtetuese do ta rregullonte gjendjen aktuale të pjesëmarrjes së mangët të komuniteteve në çështjet publike dhe vendimmarrje në Kosovë, ku një komunitet ia cakton përfaqësuesin komunitetit tjetër në ulëse të garantuara, duke gjetur fillimisht që masat aktuale për të garantuar këtë pjesëmarrje, përkundër kërkesave të nenit 58 (4) të Kushtetutës dhe nenit 15 të Konventës Kornizë, nuk janë adekuate-dhe rrjedhimisht kemi të bëjmë me shkelje kushtetuese të këtyre neneve”.
64. Në vijim, parashtuesit e kërkesës konsiderojnë se: “[...] Gjykata Kushtetuese do duhej që të obligonte Kuvendin e Republikës së Kosovës që sa më parë të ndërmerrte këto masa adekuate dhe të krijonte kushtet e nevojshme, duke rregulluar kornizën ligjore në këtë fushë, ashtu që komuniteteve jo shumicë në vend t’u mundësohet përfaqësimi efektiv në ulëse të garantuara, dhe, si rezultat, përfaqësimi efektiv në çështje publike dhe vendimmarrje në përgjithësi. Këto masa adekuate do duhej të garantonin që komunitetet

në mënyrë substanciale të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, duke mos lejuar shndërrimin e ulëseve të garantuara në mekanizma iluzore të përfaqësimit. Gjykata Kushtetuese, konform standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, do duhej t'i linte Kuvendit një margjinë të gjerë vlerësimi që të përcaktojë se cilat masa do të ishin adekuate për të arritur këtë pjesëmarrje efektive. Një masë e tillë adekuate, për kontekstin kushtetues kosovar, do të ishte, shembull, përcaktimi ligjor që komunitetet të regjistroheshin në lista zgjedhore të veçanta (separate communal/electoral rolls) ashtu që vetëm votuesit e komuniteteve që gjenden në ato lista të mund të votojnë për përfaqësuesit që janë deklaruar se do t'i përfaqësojnë ato komunitete në ulëse të garantuara. Askush jashtë atyre listave nuk do të mund të votonte për ulëset e garantuara për komunitetin tjetër. Kështu do të pamundësohej votimi manipulativ mes komuniteteve në shkallen siç ka ndodhur në Zgjedhjet e 14 Shkurtit. (Megjithëse, siç thamë, standardet ndërkombëtare precize dhe shprehimore mungojnë, të paktën në një rast është sugjeruar nga Komisioni i Venecias që një mase e tillë e listave të veçanta zgjedhore të komuniteteve të implementohej, duke marrë parasysh specifikat e situatës në atë shtet.) Kuptohet, regjistrimi në këto lista zgjedhore nuk do të ishte i detyrueshëm: secili pjesëtar i komunitetit jo shumicë, konform standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, do mund të vendoste se a të regjistrohej në listat e veçanta të komuniteteve (për të votuar për komunitetin e vet), apo në listën e përgjithshme të votuesve (për të votuar për 100 ulëset tjera në Kuvendin e Kosovës). Regjistrimi i etnicitetit të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në lista zgjedhore do të bëhej me kriter objektiv të përkatësisë, konform Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, gjithnjë duke ruajtur privatësinë e deklartuesve siç përcaktohet edhe me standarde të Komisionit të Venecias”.

65. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i PZAP dhe Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme për mosanulimin e votave edhe në tri (3) komunat, përkatësisht të Graçanicës, Kamenicës dhe Mitrovicës së Veriut “përbën shkelje të nenit 58 (4) të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 15 të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtje të Pakicave Kombëtare, zbatimi i se cilës garantohet me nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës”.

66. Parashtruesit e kërkesës po ashtu konsiderojnë se: “Vendimet e atakuara kanë cenuar kështu pos komponentës tjetër të nenit 58 (4) të Kushtetutës (barazinë efektive) në lidhje me nenin 4 (2) të Konventës Kornizë, edhe nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili përcakton një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit për të gjitha të drejtat e garantuara me kushtetutë dhe ligj”.

(ii) Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 45 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së

67. Përkitazi me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretendojnë (i) shkelje të së drejtës për tu zgjedhur të Veton Berishës; dhe (ii) mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor, përkatësisht Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.

68. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 45 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “Sikur Vendimet e atakuara të kishin anuluar edhe votat që Romani Inicijativa ka marrë nga komunitetet jorome në Graçanicë, Kamenicë, dhe Mitrovicë të Veriut, njëri nga parashtruesit e kërkesës, Veton Berisha nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), do të bëhej deputet i Kuvendit të Kosovës në vend të përfaqësuesit aktual (legjitim)

nga komuniteti rom që përfaqëson ulësen e përbashkët për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kuvendin e Kosovës, i cili përfaqësues legjitim pastaj do ta zëntë ulësen e veçantë për komunitetin rom të cilën në mënyrë jolegjitime e mban aktualisht përfaqësuesi i Romani Inicijativas”.

69. Tutje, parashtuesit e kërkesës theksojnë se: *“Praktika gjyqësore e GjEDNJ-së ka përcaktuar që të drejtat e garantuara në nenin 3 të Protokollit nr. 1 përfshijnë jo vetëm organizimin dhe menaxhimin e procesit të votimit, por gjithashtu edhe mënyrën e rishikimit të rezultateve zgjedhore si dhe kontesteve që mund të lindin sa i përket numërimit të votave dhe certifikimit të rezultateve zgjedhore [...] në këto Vendime nuk është arsyetuar mirë se përse votat e Romani Inicijativas nuk janë anuluar edhe në komunat Graçanicë, Kamenicë dhe Mitrovicë e Veriut, megjithëse edhe në këto komuna vlenin të njëjtat kritere për anulim sikur në komunat tjera ku votat ishin anuluar: edhe në këto tri komuna numri i votave të fituara nga Romani Inicijativa ishte më i lartë sesa numri i banorëve të popullsisë rome në këto komuna. Megjithëse sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-se kontestet zgjedhore nuk ekzaminohen nën prizmin e nenit 6 [të KEDNJ-së] (te drejtës për gjykim të drejtë) të KEDNJ-së, kjo praktikë gjyqësore ka përcaktuar megjithatë që vendimet sa i përket kontesteve zgjedhore duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuara dhe objektive, praktikë kjo e konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Sipas kësaj praktike gjyqësore, zgjidhja e kontesteve zgjedhore duhet të jetë i atillë që të garantojë një vendim mjaftueshëm të arsyetuar, të drejtë dhe objektiv”.*
70. Sipas parashtuesve të kërkesës: *“Vendimet e atakuara nuk kanë respektuar këto kërkesa siç duhet. Me vendimin e PZAP-se dhe pastaj të Gjykatës Supreme, nuk tregohet mjaftueshëm dhe bindshëm arsyeja se përse votat në Graçanicë, Kamenicë dhe Mitrovicë të Veriut nuk janë anuluar gjithashtu. Arsyetimi tentohet të jepet, mirëpo nuk është arsyetim i drejtë dhe objektiv. Së pari, vendimi i atakuar i PZAP thjeshtë thekson që “[n]ë raport me pjesën refuzuese pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse kërkesën sepse anulimi i të gjitha votave në vendvotimet e cekura si në piken e III-të dispozitivit të këtij vendimi, do të përbënte anulim të pabazuar të fletëvotimeve të vlefshme, pasi jo të gjitha votat për komunitetin romë kanë qenë të orkestruara [...] në asnjë moment Vendimet nuk tregojnë në mënyrë korrekte se si dhe për çfarë arsye kjo kërkesë nuk ka qenë e besueshme. Kjo pasi që edhe në tri komunat e lartpërmendura kanë ekzistuar të njëjtat kondita sikur në komunat tjera ku janë anuluar votat: edhe këtu banoret e komunitetit rom kanë qenë në numër më të vogël sesa votat që Romani Inicijativa ka marrë në këto komuna. Një gjë e tillë ka qenë lehtë e provueshme, pasi që PZAP dhe Supremja kane pasur qasje në të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë edhe për këto komuna, njësoj si për komunat tjera ku i kanë anuluar votat. Në fakt, ta zëmë, në komunën kryesore ku ne kontestojmë mosanulimin (Graçanicë), PZAP dhe Gjykata Supreme veçse kishin anuluar votat e marra në mënyrë të parregullt për komunitetin boshnjak, duke gjetur se edhe në këto komuna ka pasur orkestrim të votave. Prandaj nuk e kuptojmë se përse kërkesa jonë edhe në këtë pjesë nuk ka qenë e besueshme. Në mënyrë krejtësisht arbitrare ajo që ka vlejtur për komunitetin boshnjak nuk ka vlejtur për komunitetin rom, megjithëse të njëjtat standarde dhe kritere për anulim vlejné për të dyja komunitetet edhe në komunën e Graçanicës, ku votat e marra për subjektet politike të caktuara janë dukshëm më të mëdha sesa numri i popullsisë së komunitetit përkatës”.*
71. Rrjedhimisht, parashtuesit konkludojnë se vendimet e kontestuara: *“nuk kanë pasur arsyetim të drejtë dhe objektiv por arbitrar si dhe kanë qenë të arsyetuara pamjaftueshëm. Me këtë kanë kryer shkelje të nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së”.*

72. Gjykata në vijim vë në pah se parashtruesit e kërkesës në Gjykatë kanë dorëzuar edhe vendimin e PZAP-së [A.nr.565/2021] të 7 marsit 2021 dhe Aktgjykimin [AA.nr.30/2021] e 11 marsit 2021 të Gjykatës Supreme që i referohen apeleve të subjekteve politike *Nasha Inicijativa; Lista Boshnjake Unioni Social Demokrat dhe Nova Demokratksa Stranka* kundër Vendimit të KQZ-së, të 4 marsit 2021 dhe ankesës së subjektit politik *Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hodžić* kundër Vendimit [A.nr. 656/2021] të 7 marsit 2021 të PZAP-së në Gjykatën Supreme. Në lidhje me këto vendime, parashtruesit e kërkesës theksojnë se në rastin e subjekteve politike, që përfaqësojnë subjektet e lartcekura, të cilat kishin parashtruar apele kundër Vendimit të KQZ-së, të 4 marsit 2021 dhe kishin kërkuar anulimin e fletëvotimeve të subjektit politik *Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hodžić*, PZAP përmes Vendimit kishte anuluar fletëvotimet në të gjitha vendvotimet të cilat ishin kontestuar nga katër (4) subjektet politike të lartcekura.
73. Parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre specifikojnë që:

“Po që se Gjykata Kushtetuese gjen qe pretendimet tona janë të sakta dhe ka pasur shkelje kushtetuese, kjo nënkupton që përfaqësuesi aktual në Kuvendin e Kosovës nga Romani Inicijativa funksionin e tillë e ushtron në mënyrë jokushtetuese. Rrjedhimisht, kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që, po që se arrin në konkluzionin e tillë, mandatin e të njëjtit deputet ta anulojë dhe në ulësen e garantuar të vijë deputeti tjetër si përfaqësues legjitim i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, i zgjedhur me vota të komuniteteve përkatëse. Nuk mund të tolerohet që vetëm të konstatohet shkelja ndërkaq çështja të mos kthehet në gjendjen e mëparshme. Po qe se konstatohet jolegjitimiteti i një deputeti në këtë rast ai deputet nuk duhet të vazhdojë të ushtrojë këtë funksion për katër vitet e ardhshme, ndërkaq për këto katër vite komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të mos përfaqësohen efektivisht në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që, në formën si ajo e sheh me të përshtatshme, të bëjë rikthimin në gjendjen e mëparshme dhe të garantojë edhe në këtë legjislature të Kuvendit të Kosovës pjesëmarrjen efektive të komuniteteve jo shumicë. Ne në vijim do të paraqesim propozimin tonë se si do duhej të dukej një rikthim i tillë në gjendjen e mëparshme; sidoqoftë, lusim Gjykatën që të vlerësojë me vetëiniciativë mënyrat më të mira se si një gjë e tillë do duhej të ndodhte, marre parasysh situatën në rastin konkret. E rëndësishme është të arrihet rezultati i kërkuar me Kushtetute: përfaqësimi efektiv i komuniteteve në jetën politike.”

74. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese si në vijim:

“Marrë parasysh të gjitha këto, ne propozojmë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të:

VENDOS

- I. *Të deklarojë kërkesën të pranueshme;*
- II. *Të konstatojë shkeljet kushtetuese nga Vendimet e atakuara dhe të anulojë pjesërisht vendimin e Gjykatës Supreme, ashtu që ta obligojë të njëjtën të korrigjojë vendimin në pjesën ankimuese konform gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese, duke anuluar proporcionalisht edhe votat në Graçanicë, Kamenicë dhe Mitrovicë të Veriut, si dhe pastaj zëvendësimet eventuale të deputetëve në Kuvendin e Kosovës të behën konform këtij anulimi;*

- III. Të konstatojë obligimin e Kuvendit që të nxjerrë legjislacionin përkatës në mënyrë që përgjegjësitë shtetërore për garantim të pjesëmarrjes efektive te komuniteteve sipas nenit 58(4) të Kushtetutës të përmbushen.”

Shkresa e titulluar “Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën e subjekteve politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), dhe individët Veton Berisha dhe Albert Kinolli”

75. Në shkresën e tij të titulluar Opinion, Avokati i Popullit fillimisht kishte theksuar që: “Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut në lidhje me çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), dhe individët Veton Berisha nga komuniteti egjiptian dhe Albert Kinolli nga komuniteti rom, në cilësinë e parashtruesit të kërkesës, të cilët kanë kërkuar nga Gjykata që të bëjë: “kontrollin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AA.nr.29/2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe vendimit A.nr. 736/2021 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)”.
76. Në vijim, pas elaborimit të kërkesës së parashtruesve të kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AA.nr.29/2021] të Gjykatës Supreme si dhe Vendimit [A.nr.736/2021] të PZAP-it, të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, Avokati i Popullit njofton Gjykatën se: “z. Veton Berisha nga komuniteti egjiptian ka paraqitur ankesë te Avokati i Populli [...]”. Avokati i Popullit elaboron kronologjinë faktike të rastit, përkatësisht nxjerrjen e vendimeve të kontestuara, vendimin e këtyre dy autoriteteve në raport me kërkesën dhe ankesën e parashtruesve të kërkesës, respektivisht dhe arsyetimin e dhënë përmes këtyre vendimeve.
77. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit thekson se: “Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit vëren se PZAP dhe GjS kanë qëndrim unik se për tu konsideruar votimi i vlefshëm duhet të ekzistojë lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar që ndërlidhen me të drejtën e votës dhe lirinë e votimit në rastin e vendeve të rezervuara. Sipas informatave të ofruara nga ankuesit, kuptohet që PZAP dhe GjS nuk kanë marrë parasysh argumentet e paraqitura nga ankuesit për numrin e votave që Romani Iniciativa ka marrë në tri komunat, që janë objekt i ankesës në raport me numrin e popullsisë rome në komunën e Graçanicës, Kamenicës dhe Mitrovicë e Veriut, e që janë argumente krejtësisht të njëjta me rastet e tjera për të cilat PZAP dhe GjS kanë anuluar votimet në disa vendvotime. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit është informuar nga ankuesit se në tri komunat e theksuara më sipër numri i votave dhe i votuesve është si në vijim:
- Komuna e Graçanicës, 745 numri i popullsisë rome, 1773 numri i votave,
 - Komuna e Kamenicës, 243 numri i popullsisë rome, 283 numri i votave,
 - Komuna e Mitrovicës së Veriut, 40 numri i popullsisë rome, 198 numri i votave”.
78. Tutje, Avokati i Popullit i referohet përmbajtjes së nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nenit 58 të Kushtetutës dhe nenit 15 të Konventës Kornizë. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit, thekson se: “në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se është përgjegjësi e institucioneve të Republikës së Kosovës që duke organizuar procesin zgjedhor të garantojnë realizimin e të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, duke i përfshirë edhe pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë. Avokati i Popullit ka vërejtur që edhe standardet ndërkombëtare (KEDNJ dhe KKKEMPK) përcaktojnë qartë obligimin institucional për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve me qëllim që të sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit

të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës. Avokati i Popullit vlerëson se obligimi institucional i institucioneve të Republikës së Kosovës shtrihet mbi të gjitha institucionet të cilat janë kompetente të organizojnë dhe të vendosin lidhur me të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të garantuara me kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare”.

79. *Më tej, Avokati i Popullit po ashtu specifikon se: “Avokati i Popullit duke pasur parasysh kompetencat e tij, nuk lëshohet në vlerësimin dhe komentimin e vendimeve të PZAP dhe GjS. Përkundër këtij fakti, Avokati i Popullit vlerëson se për raste të njëjta organet vendimmarrëse duhet të nxjerrin vendime të njëjta. Në këtë mënyrë garantohet realizimi pa dallim i të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare, në të kundërtën, nëse për raste të njëjta nxjerrën vendime të ndryshme, atëherë krijohet situatë e pabarazisë dhe standardeve të dyfishta të vendosura nga organet vendimmarrëse”.*
80. *Avokati i Popullit po ashtu vendos theksin në argumentet e paraqitura të parashtruesve të kërkesës në kërkesën e tyre në Gjykatë, duke theksuar se: “Në rastin e ankuesve, Avokati i Popullit vëren se PZAP dhe GjS kanë përdorur argumentet e paraqitura nga ankuesit, dhe në bazë të tyre kanë nxjerrë vendimet sipas të cilave disa janë aprovuar pjesërisht, ndërsa disa të tjera janë refuzuar. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka vërejtur se në të gjitha rastet e ankimuara nga ankuesit, argumentet kanë qenë të njëjta (mospërputhje në mes të numrit të votuesve dhe votave të fituara nga subjektet politike). Prandaj, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishëm vlerësimin e kësaj çështje nga Gjykata Kushtetuese”.*
81. *Në vazhdim, Avokati i Popullit: “[...] konsideron se është e nevojshme që Gjykata Kushtetuese të shqyrtoj kërkesën nga subjektet politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), dhe individët Veton Berisha nga komuniteti egjiptian dhe Albert Kinolli nga komuniteti rom dhe të vlerësoj nëse në rastin konkret janë cenuar apo jo të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.*
82. *Bazuar në ato si më sipër, Avokati i Popullit thekson se: “[...] po ashtu duke pasur parasysh faktin që Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë për vlerësimin e përputhshmërisë së akteve të tjera me Kushtetutën konsideron se është me rëndësi të vlerësohet se në rastin e ankuesve ka pasur apo jo cenim të të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, si dhe përgjegjësia e shtetit në këtë drejtim, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.*
83. *Në fund, Avokati i Popullit përmes Opinionit të tij konkludon: “[...] se institucionet e Republikës së Kosovës duhet të jenë përgjegjëse dhe garantues për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në tërësi duke respektuar plotësisht dhe pa dallim përcaktimet kushtetuese lidhur me të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes”.*

(i) Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 22

[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;*
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;*
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.*

Amendamenti nr. 26 [i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 25 shtator 2020, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 30 shtator 2020]

Në nenin 22, pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9), si në vijim:

- (9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.*

Neni 45

[Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

- 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.*
- 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.*
- 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.*

Neni 58

[Përgjegjësitë e Shtetit]

- 1. Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare.*

2. Republika e Kosovës do të promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektoj standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.

3. Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.

4. [i amandamentuar përmes Amandamentit nr. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të publikuar në Gazetën Zyrtare më 7 shtator 2012]

5. Republika e Kosovës do të promovoj ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet.

6. Republika e Kosovës ndërmerr veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Republika e Kosovës do të përmbahet nga politikat ose praktikrat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave që u përkasin komuniteteve, dhe do t'i mbrojë ata persona nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë.

7. Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me këtë Kushtetutë.

Neni 64 **[Struktura e Kuvendit]**

1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.

2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:

(1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

Neni 71
[Kualifikimet dhe Barazia Gjinore]

1. Secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet.
2. Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare.

Neni 73
[Pamundësia e Kandidimit]

1. Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:
 - (1) gjyqtarët dhe prokurorët;
 - (2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës;
 - (3) pjesëtarët e Policisë së Kosovës;
 - (4) pjesëtarët e Doganave të Kosovës;
 - (5) pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
 - (6) udhëheqësit e agjencive të pavarura;
 - (7) përfaqësuesit diplomatikë;
 - (8) kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Nuk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës.
3. Kryetarët dhe zyrtarët e tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre.

Neni 139
[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.
[...]

Marrëveshjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme sipas nenit 22 të Kushtetutës

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 21.

1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërsëdrejti ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Secili ka njësoj të drejtë të hyjë në shërbimet publike të vendit të vet.
3. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhjet e herëpashershme dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votë të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3 (E drejta për Zgjedhje të Lira)

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 25

Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;*
- (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;*
- (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.*

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Pjesa II

Neni 4

[...]

2. Palët angazhohen që të miratojnë, kurdoherë që është e nevojshme, masa të përshtatshme me qëllim që të nxisin, në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave Lista I - Marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme në... 70 që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës. Lidhur me këtë, ata do të marrin parasysh në mënyrën e duhur kushtet e veçanta të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

3. Masat e miratuara në përputhje me paragrafin 2 nuk do të konsiderohen se janë një akt diskriminimi.

Neni 15

Palët do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta.

Ligji 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës [publikuar në Gazetën Zyrtare më 16 nëntor 2012]

Neni 2

[i Ligjit nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës]

Në tërë tekstin e ligjit në fuqi “KZAP”- Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, zëvendësohet me “PZAP” –Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

KREU II E DREJTA PËR TË VOTUAR, LISTA E VOTUESVE DHE PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT PËR LISTËN SË VOTUESVE

Neni 5

E drejta për të votuar

5.1 Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese: a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo c) ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës;

5.2 Asnjë person nuk mund të votojë nëse:

- a) është duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“Tribunali”);*
- b) është i akuzuar nga Tribunali dhe ka dështuar t'i bindet urdhrorit për t'u paraqitur para Tribunalit; ose*
- c) është shpallur mentalisht i paaftë me vendim të prerë gjyqësor.*

Neni 7

Lista e Votuesve

7.1 KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban:

a) ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë; b) të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës.

7.2. Të gjithë votuesit me të drejtë vote, të shënuar në mënyrë të kërkuar nga KQZ-ja. Informatat personale të ofruara për secilin votues janë: emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar.

7.3 Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistra, të dhëna për vendbanim dhe të dhëna të tjera zyrtare.

7.4 Lista e Votuesve është në dispozicion për të pasur qasje në të ashtu siç parashihet me rregullat e KQZ-së.

7.5 Të gjitha aktivitetet dhe dokumentet e organeve shtetërore, të gjitha paraqitjet dhe të dhënat lidhura me qytetarët e regjistruar në Listën e Votuesve lirohen nga pagesa e tarifave dhe taksave.

7.6 Të dhënat personale të qytetarëve në Listën e Votuesve shënohen në gjuhët dhe alfabetet në të cilat shënimet origjinale mbahen në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë.

7.7 Gjykata kompetente duhet të dorëzoj të dhënat në KQZ për personat të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto të dhëna dorëzohen ashtu siç kërkohet nga KQZ-ja.

7.8 Regjistri Qendror Civil pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon për të mirëmbajtur Listën e Votuesve në pajtim me afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.

7.9 KQZ-ja u ofron Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (këtu e tutje: KKZ) një kopje elektronike të të gjithë LV-së dhe një kopje të shtypur të LV-së për komunën e tyre.

KREU III

REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE DHE CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE

[...]

Neni 12

Regjistrimi i Partive Politike

12.1 Aplikimet për regjistrimin e partive politike mund të dorëzohen në Zyrë në çdo kohë gjatë orëve të rregullta të punës.

12.2 Aplikimet e dorëzuara për regjistrim në Zyrë ndërmjet ditës së deklarimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës dhe datës së vendosur për tërheqjen e fletëvotimit do të shqyrtohen vetëm nëse aplikimet për certifikim si subjekt politik janë bërë në përputhje me këtë ligj.

12.3. Aplikimet për regjistrimin e partive politike dorëzohen në formën e vendosur nga rregullat e KQZ-së siç e kërkuar nga Zyra, dhe duhet të përfshijnë me sa vijon:

a) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të kryetarit të partisë;

b) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të autorizuar financiar të partisë;

c) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit të autorizuar për të komunikuar në emër të partisë me KQZ-në;

d) numrin e telefonit dhe adresën postare të zyrës qendrore të partisë;

e) deklaratën e nënshkruar nga kryetari i partisë për të respektuar dhe për t'iu përmbajtur Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike;

f) statutin e partisë;

g) çfarëdo shkurtese apo shenje të partisë;

h) deklaratën e fundit financiare të partisë;

i) datën e konventës më të fundit të partisë;

j) emrin dhe adresën e së paku 500 anëtarëve të partisë të cilët banojnë në Kosovë dhe të cilët gjenden në Listën e Votuesve të Kosovës.

Neni 106

Rezultatet zgjedhore

106.1 KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, neni 6).

[...]

106.3 Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja.

[...]

KREU XVIII

SISTEMI ZGJEDHOR PËR KUVENDIN E KOSOVËS

[...]

Neni 110

Dispozitat e përgjithshme

[plotësuar dhe ndryshuar me nenin 7 të Ligjit nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës]

110.1 Kosova konsiderohet një zonë e vetme zgjedhore.

110.2 Subjekti politik që nuk është kandidat i pavarur e paraqet listën e kandidatëve në përputhje me nenin 27, nenin 29 dhe rregullat e KQZ-së.

110.3 Secili subjekt politik i certifikuar paraqitet në votim me “listë të hapur”.

110.4 Votuesi pajiset më një fletëvotim të vetëm për zgjedhje dhe a) e shënjon atë me votën për një (1) subjekt politik, dhe b) mund që po ashtu të shënojë atë me vota për deri në pesë (5) kandidatë nga lista e subjektit politik për të cilin ka votuar votuesi.

110.5 Nëse një fletëvotim shënjohet për më shumë se pesë (5) kandidatë, atëherë numërohet vetëm vota e hedhur për subjektin politik.

Neni 111

Ndarja e vendeve

111.1 Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke ndarë:

a) njëqind (100) vende midis të gjitha subjekteve politike të certifikuara në raport me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë ato; dhe

b) njëzet (20) vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:

(i) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(ii) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1)

vend shtesë i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

[...]

111.3 Njëzet (20) vendet e rezervuara në Kuvend të përshkruara në pikën (b) të paragrafit 1 të këtij neni u ndahen subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë në Kosovë sipas mënyrës së njëjtë të përshkruar në nenin 112.2 të këtij ligji, në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik, pavarësisht nga numri i vendeve tashmë të ndara prej njëqind (100) vendeve.

[...]

Neni 117 **Procedurat e [PZAP-it]**

117.1 PZAP-i vendos rregullat dhe procedurat e tij.

117.2 Gjatë vendosjes për një ankesë ose apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se e konsideron këtë të nevojshme.

117.3 Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.

[...]

Neni 118 **Vendimet**

[...]

118.4 Mund të apeloher vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas paraqitjes së apelit. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, nenin 12 paragrafi 2).

118.5 Vendimi i PZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme përcakton ndryshe. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, nenin 12 paragrafi 3).

Neni 119 **Ankesat**

[Plotësuar dhe ndryshuar me nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës]

119.1 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa.

[...]

119.3 PZAP-i nuk merr parasysh një ankesë që ka të bëjë me vendim nga ana e KQZ-së, por do të mund të shqyrtojë një apel ndaj një vendimi të KQZ-së siç është saktësuar në nenin 122 të këtij ligji.
[...]

Neni 122

Apelimet Zgjedhore

[Plotësuar dhe ndryshuar me nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës]

122.1 Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda njëzetekatër (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli
[...]

RREGULLAT DHE PROCEDURAT nr. 02/2015 të PZAP-it, të 4 dhjetorit 2015

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:

[...]

2.1 “Ankesë” – do të thotë mjet i rregullt juridik i dorëzuar me shkrim nga një person që ka interes ligjor apo të drejtat e të cilit janë shkelur gjatë procesit zgjedhor.

2.2 “Apel” do të thotë mjet i rregullt juridik kundër vendimeve të shkallës së parë.

[...]

ANKESAT

Neni 5

Kushtet për dorëzimin e ankesave

[...]

5.5 Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejte me votimin dhe ri-numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda 24 orëve nga shkelja e supozuar.

[...]

RREGULLA NR. 01/2013 PËR REGJISTRIMIN DHE VEPRIMIN E PARTIVE POLITIKE TË KQZ-së [e shfuqizuar me RREGULLËN 01/2023 PËR REGJISTRIMIN DHE VEPRIMIN E PARTIVE POLITIKE]

Neni 3

Regjistrimi i partive politike

3.1 Partia politike mund të paraqitet për regjistrim duke ia dorëzuar zyrës:

[...]

3.1.6. deklaratën e përkatësisë etnike të themeluesit të iniciativës politike.

[...]

RREGULLA ZGJEDHORE NR. 06/2013 LIDHUR ME QENDRAT E NUMËRIMIT DHE E REZULTATEVE E KQZ-së

**Neni 7
Numërimi i fletëvotimeve në QNR**

[...]

7.2 Fletëvotimi duhet të konsiderohet i pavlefshëm, nëse:

- (a) në fletëvotim është shënuar më shumë se një subjekt politik;*
- (b) mënyra se si është shënuar fletëvotimi e bën qëllimin e votuesit të paqartë;*
- (c) nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve, përveç nëse është fletëvotim për votim përmes postës, i cili nuk kërkohet të vuloset;*
- (d) është fletëvotim për votim përmes postës që nuk është fletëvotim i pranueshëm siç përcaktohet në Rregullën e Zgjedhjeve nr. 03/2013, Votimi jashtë Kosovës.*

RREGULLA ZGJEDHORE NR. 09/2013 LIDHUR ME VOTIMIN, NUMËRIMIN NË VENDVOTIM DHE MENAXHIMIN E QENDRËS SË VOTIMIT E KQZ-së

**Neni 21
Procesi i numërimit në vendvotimet e rregullta**

21.10 Fletëvotimi për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, për Kuvendin e Komunës dhe për kryetar të Komunës do të konsiderohet i pavlefshëm, nëse:

- (a) në fletëvotim është shënuar më shumë se një subjekt politik;*
- (b) mënyra se si është shënuar fletëvotimi e bën qëllimin e votuesit të paqartë;*
- (c) nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve, kur është nxjerrë nga kutia e votimit;*

Përveç kësaj, fletëvotimi për Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendin e Komunës do të konsiderohet i pavlefshëm, nëse:

- (d) votuesi e shënon vetëm kandidatin(ët) dhe jo subjektin politik.*

RREGULLA 01/2023 PËR REGJISTRIMIN DHE VEPRIMIN E PARTIVE POLITIKE E KQZ-së

**Neni 2
Regjistrimi i partive politike**

[...]

1.5. Datën e konventës/kuvendit themelues të partisë. shtojca II, që përmban deklaratën e përkatësisë etnike të cilën e përfaqëson iniciativa politike në qoftë se garon për vendet e garantuara;

[...]

RREGULLORES NR. 04/2023 LIDHUR ME CERTIFIKIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE DHE KANDIDATËVE TË TYRE të KQZ-së

Neni 2

Aplikimi për certifikim i subjektit politik

[...]

5.12. subjekti politik në aplikimin e vet tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për Kuvendin e Kosovës, për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera jo shumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës.

(ii) Parimet e përgjithshme sipas Kodit të Praktikës së Mirë, opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias dhe dokumenteve tjera relevante të Këshillit të Evropës dhe të Rekomandimeve të LUND-it për Pjesëmarrje të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Kodi i Praktikës së Mirë i Çështjeve Zgjedhore (Udhëzime dhe Raporti Shpjegues) (CDL-AD (2002) 23 rev), miratuar nga Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit (“Komisioni i Venecias”) në mbledhjen e tij të 51-të dhe 52-të (5-6 korrik dhe 18-19 tetor 2002)

1. Krahës të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, demokracia është një nga tri shtyllat e trashëgimisë kushtetuese evropiane, si dhe të Këshillit të Evropës. Demokracia është e pakonceptueshme nëse zgjedhjet nuk zhvillohen në përputhje me disa parime, që garantojnë statusin e tyre demokratik.

2. Këto parime përfaqësojnë një aspekt të posaçëm të trashëgimisë kushtetuese evropiane, të cilat mund të përmbliken, në mënyrë legjitime, me termin “trashëgimia zgjedhore evropiane”. Kjo trashëgimi përfshin dy aspekte; e para, kryesorja, janë parimet kushtetuese të së drejtës zgjedhore, si votimi universal, i barabartë, i lirë, i fshehtë, dhe i drejtpërdrejtë, dhe, së dyti, parimi që zgjedhjet mund të jenë me të vërtetë demokratike vetëm në qoftë se plotësohen disa kushte themelore të një shteti demokratik të bazuar në sundimin e ligjit, si të drejtat themelore, qëndrueshmëria e ligjit zgjedhor, dhe garancitë efektive procedurale. Për këtë arsye, teksti, që paraqitet më poshtë, – ashtu si dhe udhëzimet e mëparshme – është në dy pjesë. Në të parën jepet përkufizimi dhe implikimet praktike të parimeve të trashëgimisë elektorale evropiane dhe, në të dytën, kushtet e nevojshme për aplikimin e tyre.

[...]

I. Parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane

Hyrje: parimet dhe baza e tyre ligjore

3. Për të qenë në përputhje me parimet e përbashkëta të trashëgimisë kushtetuese evropiane, të cilat përbëjnë bazën e çdo shoqërie të vërtetë demokratike, zgjedhjet duhet të respektojnë pesë rregullat bazë themelore: votimi duhet të jetë universal, i barabartë, i lirë, i fshehtë, dhe i drejtpërdrejtë. Përveç kësaj, zgjedhjet duhet të zhvillohen në mënyrë periodike. Të gjitha këto parime së bashku përbëjnë trashëgiminë zgjedhore evropiane.

4. Edhe pse këto parime janë të një natyre konvencionale, zbatimi i tyre është i lidhur me një sërë çështjesh, të cilat duhet t'i nënshtrohen një analizë të thellë. Është mirë që të

identifikojmë “thelbin” e këtyre parimeve, të cilat duhet të respektohen me përpikëri nga të gjitha vendet evropiane.

5. Thelbi i trashëgimisë zgjedhore evropiane përbëhet para së gjithash nga rregullat ndërkombëtare. Rregulli relevant universal është Neni 25 (b) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili parasheh shprehimisht të gjitha këto parime, me përjashtim të votimit të drejtpërdrejtë, megjithëse edhe ky i fundit nënkuptohet.

Rregulli i përbashkët evropian është Neni 3 i Protokollit Shtesë i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili parasheh shprehimisht të drejtën për zgjedhje periodike me votim të lirë dhe të fshehtë; 3. parimet e tjera janë gjithashtu të pranuar në praktikën gjyqësore për të drejtat e njeriut. E drejta për zgjedhje të drejtpërdrejta është pranuar gjithashtu nga Gjykata e Strasburgut, të paktën në mënyrë implicite. Megjithatë, parimet kushtetuese, të përbashkëta për gjithë kontinentin, nuk figurojnë vetëm në dokumentet ndërkombëtare: përkundrazi, ato përmenden shpesh më hollësisht në kushtetutat kombëtare. 6. Aty ku legjislacioni dhe praktika e vendeve të ndryshme konvergjojnë, përmbajtja e parimeve mund të përcaktohet më saktë.

1. Votimi universal

1.1. Rregulli dhe përjashtimet

6. Votimi universal konsiston në të drejtën zgjedhore aktive (e drejta për të votuar) si dhe pasive (e drejta për t'u zgjedhur). E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur mund t'i nënshtrohet një numri kushtesh, të cilat jepen më poshtë. Kushtet më të zakonshme janë ato që kanë të bëjnë me moshën dhe shtetësinë.

[...]

2.4. Barazia dhe pakicat kombëtare

“a. Duhet të lejohen partitë që përfaqësojnë pakicat kombëtare.

b. Rregulla të veçanta, të cilat u rezervojnë një numër të caktuar të vendeve ose që parashikojnë përjashtime për partitë përfaqësuese të pakicave kombëtare në kriteret normale të ndarjes së vendeve (për shembull, përjashtimi nga kërkesa për kuorum), parimisht nuk bien ndesh me të drejtën për votim të barabartë.

c. Asnjë kandidat dhe asnjë votues nuk duhet të detyrohet të tregojnë përkatësinë e tyre në një pakicë kombëtare.”

[...]

II. Kushtet për zbatimin e këtyre parimeve

...

3. Garancitë procedurale

[...]

3.3. Një sistem i efektiv i ankesës

a. Organi i ankimit për çështje elektorale duhet të jetë ose komisioni zgjedhor ose gjykata. Për zgjedhjet parlamentare, si shkallë e parë mund të parashikohet ankimi në parlament. Në çdo rast, duhet të jetë i mundur ankimi përfundimtar në gjykatë.

b. Procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe pa formalitete, veçanërisht për sa i përket pranueshmërisë së ankesave.

c. Procedura e ankimit dhe, në veçanti, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të ndryshme duhet të rregullohen qartë me ligj, në mënyrë që të shmangen konfliktet e juridiksionit (pavarësisht nëse janë të karakterit pozitiv apo negativ). As pala ankuese dhe as autoritetet nuk duhet të kenë të drejtën të zgjedhin organin e ankimit.

d. Organi i ankimit duhet të ketë veçanërisht kompetenca për të gjykuar çështje si e drejta e votës – duke përfshirë listat zgjedhore – dhe e drejta për t'u zgjedhur, vlefshmërinë e kandidaturave, respektimin e rregullave të fushatës zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve.

e. Organi i ankimit duhet të ketë kompetencë të anulojë zgjedhjet kur parregullsitë kanë mundur të ndikojnë në rezultat. Është e mundshme të anulohen zgjedhjet në tërësi ose vetëm rezultatet në një zonë zgjedhore ose në një qendër votimi. Në rastin e anulimit, në zonën përkatëse duhet të organizohen zgjedhje të reja.

f. Të gjithë kandidatët dhe votuesit e regjistruar në zonën përkatëse zgjedhore duhet të kenë të drejtën e ankesës. Në rastin e ankimit nga votuesit për rezultatet e zgjedhjeve mund të aplikohet një kuorum i arsyeshëm.

g. Afatet kohore për ankesë dhe marrjen e vendimeve për ankesa duhet të jenë të shkurtra (tre deri në pesë ditë për çdo ankesë në shkallë të parë).

h. Duhet të mbrohet e drejta e parashtruesit të ankesës për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të të dy palëve.

i. Në rast se organi i ankesës është një komision më i lartë zgjedhor, ai duhet të ketë ex officio të drejtën për të korrigjuar ose anuluar vendimet e marra nga komisionet më të ulëta zgjedhore.

Raporti Shpjegues i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore

[...]

2.4. Barazia dhe pakicat kombëtare

“22. Në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare, ligji elektoral duhet të garantojë barazinë për personat që i përkasin pakicave kombëtare, duke përfshirë parandalimin e çdo lloj diskriminimi ndaj tyre. Në veçanti, pakicat kombëtare duhet të lejohen të krijojnë partitë e tyre politike. Përcaktimi i kufijve të zonave elektorale dhe rregullat e kuorumit nuk duhet të jenë të tilla që të përbëjnë pengesë për pjesëmarrjen e pjesëtarëve të pakicave në organet e zgjedhura.

23. Disa masa që merren për të siguruar përfaqësim minimal të pakicave, qoftë rezervuar vende për to ose duke siguruar përjashtime nga kriteret e zakonshme për shpërndarjen e vendeve, për shembull, duke hequr kuorumin për partitë e pakicave kombëtare, nuk cenojnë parimin e barazisë. Mud të parashikohet gjithashtu që pjesëtarët e pakicave kombëtare të kenë të drejtë për të votuar si për listat e përgjithshme ashtu dhe për ato të pakicave kombëtare. Megjithatë, as kandidatëve dhe as zgjedhësve nuk duhet t'u kërkohet të tregojnë përkatësinë e tyre në një pakice kombëtare.”

4. Votimi i fshehtë

“52. Fshehtësia e votës është një aspekt i lirisë së votuesve, qëllimi i së cilës është të mbrojë votuesit nga presioni me të cilin ata mund të ballafaqohen në rast se të tjerët mësojnë se për kë kanë votuar. Fshehtësia duhet të aplikohet për tërë procedurën – dhe veçanërisht ne hedhjen e fletëve të votimit dhe numërimin e votave. Zgjedhësit kanë të drejtë për ta pasur atë, por duhet ta respektojnë edhe vetë dhe mosrespektimi i kësaj fshehtësie duhet të ndëshkohet duke shpallur të pavlefshme çdo fletë votimi, përmbajtja e së cilës është zbuluar [fusnota e hequr].

53. Votimi duhet të jetë individual. Votimi familjar, ku një anëtar i familjes mbikëqyr votat e hedhura nga anëtarët e tjerë, shkel fshehtësinë e votimit; kjo është një shkelje e zakonshme e ligjit për zgjedhje. Të gjitha format e tjerat të kontrollit nga një votues ndaj votës së një tjetri duhet të ndalohen. Votimi me prokurë, i cili i nënshtrohet kushteve të rrepta, është një çështje e veçantë.

54. Përveç kësaj, meqë abstenimi mund të pasqyrojë një zgjedhje politike, lista e personave që ka votuar nuk duhet të publikohet.

55. Shkelja e fshehtësisë së votës duhet të ndëshkohet ashtu si shkeljet e aspekteve të tjera të lirisë së votuesit.

[...]

3.3. Një sistem efektiv i ankesës

92. Në mënyrë që dispozitat e ligjit zgjedhor të mos mbeten vetëm fjalë në letër, duhet siguruar mundësia e kundërshtimit në një organ apelimi për rastet e moszbatimit të ligjit zgjedhor. Kjo ka të bëjë veçanërisht për rezultatet e zgjedhjeve: qytetarët mund t'i kundërshtojnë ato për parregullsi në procedurat e votimit. Ankesa mund të zbatohet gjithashtu për vendimet e marra para zgjedhjeve, veçanërisht lidhur me të drejtën për të votuar, listat zgjedhore dhe e drejta për të kandiduar në zgjedhje, vlefshmëria e kandidaturave, zbatimin e rregullave të fushatës zgjedhore, mbulimin nga media dhe mundësia për të marrë financime për partitë.

93. Ka dy zgjidhje të mundshme:

- ankesat mund të paraqiten në gjykata të rregullta, një gjykatë e posaçme, ose në gjykatën kushtetuese;

- ankesat mund t'i paraqiten një komisioni zgjedhor.

Për sa i përket këtij sistemi, duhet thënë se komisionet janë shumë të specializuara, ndërsa gjykatat janë me më pak përvojë në çështjet elektorale. Megjithatë, si masë paraprake, është e dëshirueshme që të ketë një sistem kontrolli gjyqësor, në të cilin niveli i parë i apelimit të jetë komisioni, dhe gjykata kompetente të jetë niveli i dytë i apelimit.

95. Procedura ankimore duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur, dhe kjo vlen veçanërisht për vendimet e marra para zgjedhjeve. Lidhur me këtë, duhen parandaluar dy gracka: së pari, procedurat e apelimit të mos vonojnë procesin elektoral dhe, së dyti, për shkak të mungesës së efektit pezullues, vendimet për ankesa, që mund të ishin marrë para zgjedhjeve, merren pas zgjedhjeve. Përveç kësaj, vendimet për rezultatet e zgjedhjeve

nuk duhet te vonohen, veçanërisht nëse klima politika është e tendosur. Kjo do të thotë që afatet kohore për ankesa të jenë shumë të shkurtra dhe që organi i apelit duhet ta marrë vendimin e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, këto afate kohore duhet të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e së drejtës së ankesës si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë paraqitjen e ankesës dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm për vendime që merren para zgjedhjeve. Megjithatë, është e lejueshme që t'i jepet pak më shumë kohë Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese për të marrë vendimet e tyre.

96. Procedura duhet të jetë gjithashtu e thjeshtë dhe për këtë ndihmon edhe pajisja e votuesve me formularë të veçantë për ankesa. Është e nevojshme të eliminohet formalizmi në mënyrë që të shmangen vendimet për papranueshmëri, veçanërisht për rastet me ndjeshmëri politike.

97. Është gjithashtu e rëndësishme që procedura e apelimit, veçanërisht kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të ndryshme që përfshihen në të, të rregullohen qartësisht me ligj në mënyrë që të shmangen konfliktet e juridiksionit pozitiv apo negativ. As ankuesit dhe as autoritetet nuk duhet të lejohen të zgjedhin organin e apelimit. Rreziku që organet e apelimit të refuzojnë të marrin vendim rritet shumë në rastet kur është teorikisht e mundur të apelohej si në gjykata ashtu dhe në komisionin elektorale, ose kur kompetencat e gjykatave të ndryshme – p.sh. gjykatave të rregullta dhe gjykatës kushtetuese – nuk janë të përcaktuara në mënyrë të qartë.

[...]

99. E drejta për ankesa të tilla duhet të jetë sa më e gjerë që të jetë e mundur. Çdo votues në zonën zgjedhore dhe çdo kandidat në zgjedhje duhet të jetë në gjendje të parashtojë një ankesë. Megjithatë, për ankesa nga votues lidhur me rezultatet e zgjedhjeve mund të vendoset një kuorum i arsyeshëm.

100. Procedura e ankesës duhet të jetë e natyrës gjyqësore, në kuptimin që të garantohet e drejta e ankuesve për procedura në të cilat të dy palët dëgjohen.

101. Kompetencat e organeve për ankesa janë gjithashtu të rëndësishme. Ato duhet të kenë kompetencë të anulojnë zgjedhjet në qoftë se parregullsitë kanë ndikuar në rezultat, p.sh. kanë ndikuar në shpërndarjen e vendeve. Ky është parimi kryesor, por ai duhet të jetë i hapur për përshtatje, përkatësisht nuk është e nevojshme që anulimi të ndikojë në rezultatet e të gjithë vendit ose të zonës zgjedhore – pra, po të jetë e mundur, të anulohen rezultatet vetëm në një qendër votimi. Kjo bën të mundur që të shmangen dy ekstreme – anulimi i të gjitha zgjedhjeve, edhe pse parregullsitë kanë prekur vetëm një zonë, dhe refuzimi për anulim, sepse zona e prekur është shumë e vogël. Në zona ku rezultatet janë anuluar, zgjedhjet duhet të përsëriten.

102. Atje ku komisionet e nivelit më të lartë janë organe për ankesa, ato duhet të kenë mundësi të korrigjojnë ose të anulojnë sipas detyrës zyrtare vendimet e komisioneve më të ulëta zgjedhore.”

Raporti për rregullat zgjedhore dhe veprimet afirmative për pjesëmarrjen e minoriteteve në procesin e vendimmarrjes në shtetet evropiane [CDL-AD(2005)009], miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike, më 10 mars 2005 dhe Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij plenare të 11-12 marsit 2005

[...]

7. Në bazë të këtyre supozimeve, veprimi afirmativ përkufizohet si një grup i “politikave dhe praktikave që favorizojnë grupet (kryesisht grupet etnike dhe gratë) që kanë qenë historikisht në pozitë të pafavorshme”.

Ky përkufizim nuk lë pas dore rëndësinë e funksionit dhe, në veçanti, të qëllimit praktik të politikave dhe praktikave të nënkuptuara. Theksi vihet më tepër në bazat politike dhe ligjore mbi të cilat zhvillohen dhe justifikohen politikat. Mbi këto baza, përkufizimi tejkalon dallimin midis konceptit të ngushtë të “veprimit afirmativ” strikto sensu dhe konceptit të “masave të veçanta”.

8. Në një mënyrë, arenat tradicionale të politikave dhe praktikave të veprimit afirmativ kanë qenë arsimi dhe punësimi. Megjithatë, në dy dekadat e fundit, veprimi afirmativ është futur në fushën e menaxhimit dhe parandalimit të konflikteve, dhe veçanërisht në fushën e mbrojtjes dhe zhvillimit të pakicave kombëtare. Ndër përpjekjet e reja në këtë fushë duhet të merren parasysh opinionet e Komitetit Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në lidhje me nenin 15 të Konventës. Këtu do të përmendim edhe Rekomandimin 1623 (2003) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Kuvendi u rekomandon “...partive shtetërore t'i kushtojnë vëmendje të veçantë...për të siguruar përfaqësimin parlamentar të pakicave”.

9. Në këtë drejtim raporti ynë fokusohet në arritjet e një prej zhvillimeve më të fundit të veprimit afirmativ në sferën e rregullave zgjedhore si mekanizëm për pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në proceset vendimmarrëse.

[...]

2. Veprimi Afirmativ dhe rregullat zgjedhore

12. Siç u përmend më sipër, zgjerimi i interesit për mbrojtjen e pakicave kombëtare në fushën e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje është një zhvillim relativisht i vonshëm. Por rëndësia e tij tashmë ka tërhequr vëmendjen e organizatave dhe organeve përkatëse ndërkombëtare. Ndër më të spikaturat në këtë fushë, duhen përmendur përpjekjet dhe arritjet e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare (KLPK) dhe Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).⁶ Komisioni i Venecias gjithashtu ka pranuar sfidën dhe ka kryer studimin e tij për ligjin zgjedhor dhe pakicat kombëtare.

13. Të dy studimet janë fokusuar në çështjen më të përgjithshme të “rëndësisë së procesit zgjedhor për lehtësimin e pjesëmarrjes së pakicave në sferën politike”. Në këtë aspekt, Rekomandimi i Lundit për zgjedhjet: Nr. 7 apelon që “Shtetet do të garantojnë të drejtën e personave që u përkasin pakicave kombëtare për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike, duke përfshirë të drejtën për të votuar dhe për të kandiduar për poste pa diskriminim.”

14. Studimi i Komisionit të Venecias për Ligjin Zgjedhor dhe Pakicat Kombëtare, përfshin konkluzione të përgjithshme të rëndësishme të cilat ofrojnë një bazë solide fillestare për përpjekjet e ardhshme për zhvillimin e diskutimit mbi veprimin afirmativ në fushën e rregullave zgjedhore për pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në vendimmarrje.

KONKLuzion

65. Shqyrtimet nga vendi në vend tregojnë se tashmë ekzistojnë rregulla zgjedhore interesante që kanë qëllime afirmative të veprimit, në kuptimin më të gjerë të konceptit të pranuar këtu. Natyrisht, këto nuk janë rregullat e vetme të ligjit zgjedhor që lejojnë përfaqësimin e pakicave (shih shtojcën). Në shumicën e vendeve, rregulla të tilla futen si elementë të izoluar, ndërsa në disa vende ato futen në mënyrë më sistematike. Në rastin e parë, rregullat zgjedhore të veprimit afirmativ futen drejtpërdrejt në ligj. Në rastin e dytë, rregulla të tilla hiqen nga dispozitat më të përgjithshme kushtetuese. Modeli i dytë është më i zakonshëm në mesin e vendeve të sapo demokratizuara.

66. Në përgjithësi, rregullat zgjedhore që favorizojnë veprimin afirmativ kanë një shtrirje të kufizuar. Numri i përfituesve të rregullave të tilla zgjedhore përcaktohet qartë dhe prerë ose me Kushtetutë ose me Ligj ose me akte të tjera legjislative shoqëruese. Për shembull, numri i mandateve parlamentare të garantuara për pakicat është pothuajse gjithmonë më i ulët se numri i minoriteteve të pranishme në vend. Veprimi afirmativ mund të zbatohet vetëm në nivel kombëtar, rajonal, lokal apo edhe evropian dhe/ose vetëm në një pjesë të vendit. Kjo do të thotë se frymëzimi origjinal për rregulla të tilla zgjedhore nuk është thjesht i bazuar ligjërisht, por ndoshta politik. Ligjvënësit janë të detyruar të përdorin kriteret politike për klasifikimin dhe trajtimin e një numri të pakicave kombëtare si një grup me qëllim të zgjedhjes së një përfaqësuesi të përbashkët. Dallimet e mëdha në numrin e anëtarëve të pakicave të veçanta zvogëlojnë mundësitë zgjedhore të disa pakicave, sepse mandatet i shkojnë kandidatit të pakicës me numrin më të madh të votuesve. Ky është një problem veçanërisht i rëndësishëm i veprimit afirmativ duke pasur parasysh se përkufizimet e pakicave kombëtare të aplikuara në çdo vend janë ad hoc, të paqarta dhe ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme.

[...]

68. Veprimi afirmativ në sferën e rregullave zgjedhore hap çështje të tjera relevante juridike. Kjo përsëri dëshmon natyrën kontroverze të veprimit afirmativ në përgjithësi. Megjithatë, arsyetimi i tij është i fortë dhe mbi bazën e tij vendet do të zhvillojnë një larmi të gjerë mekanizmesh në përpunje me traditat e tyre historike dhe ligjore dhe me sistemin politik. Në këtë drejtim, Kodi i praktikës së mirë të Komisionit të Venecias në çështjet zgjedhore ofron disa nga parimet bazë për zhvillimin e rregullave të veprimit afirmativ zgjedhor në përpunje me trashëgiminë zgjedhore evropiane. Midis tyre do të theksojmë këtu parimet e mëposhtme:

a. Duhet të lejohen partitë që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Megjithatë, pjesëmarrja e pakicave kombëtare në partitë politike nuk është dhe nuk do të kufizohet në të ashtuquajturat parti me bazë etnike.

b. Rregullat e posaçme që u garantojnë pakicave kombëtare vendet e rezervuara ose parashikojnë përjashtime nga kriteret normale të ndarjes së vendeve për partitë që përfaqësojnë pakicat kombëtare (për shembull, përjashtimi nga kërkesa e kuorumit) në parim nuk bien ndesh me të drejtën e barabartë të votës.

c. As kandidatët dhe as votuesit nuk duhet të jenë të detyruar të zbulojnë anëtarësimin e tyre në një pakicë kombëtare.

d. Pragjet zgjedhore nuk duhet të ndikojnë në mundësitë e përfaqësimit të pakicave kombëtare.

e. Njësitë zgjedhore (numri i tyre, madhësia dhe forma, magnituda) mund të projektohen me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së pakicave në proceset vendimmarrëse.

Komentar për Pjesëmarrje Efektive të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, social dhe ekonomike dhe në çështjet publike [miratuar nga Komitetit Këshillëdhënës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave, të miratuar më 27 shkurt 2008]

5. Mbrojtja e pakicave kombëtare dhe e të drejtave dhe lirive të personave që u përkasin pakicave kombëtare, siç parashikohet në Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, është pjesë përbërëse e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Si rezultat, e drejta e pjesëmarrjes efektive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe në çështjet e brendshme, siç parashikohet në Nenin 15 të Konventës Kornizë, është gjithashtu pjesë e mbrojtjes ndërkombëtare e të drejtave të njeriut.

6. Megjithëse Konventa Kuadër mbron të drejtat e individëve që i përkasin pakicave kombëtare, gëzimi i disa të drejtave, duke përfshirë dhe të drejtën për pjesëmarrje efektive, ka një dimension kolektiv. Kjo do të thotë se ca të drejta mund të gëzohen në mënyrë efektive vetëm në komunitet me persona të tjerë që i përkasin pakicave kombëtare.

[...]

10. Neni 15, ashtu si edhe dispozita të tjera të Konventës Kornizë, parashikon një detyrim që duhet të përmbushet nga shtetet palë: ata duhet të sigurojnë se ekzistojnë kushtet për pjesëmarrje efektive, por mjetet më të përshtatshme për të arritur këtë qëllim lidhen në vlerësimin e tyre.

[...]

80. Pjesëmarrja e personave që i përkasin pakicave kombëtare në proceset zgjedhore është shumë e rëndësishme për t'u bërë të mundur minoriteteve të shprehin pikëpamjet e tyre kur hartohen masa legislative dhe politika publike me rëndësi për ta.

81. Duke pasur parasysh se shtetet palë janë sovranë për të vendosur për sistemet e tyre zgjedhore, Komiteti Këshillimor ka theksuar se është e rëndësishme t'i jepen mundësi pakicave në fjalë të përfshihen në axhendat publike. Kjo mund të arrihet ose nëpërmjet pranisë së përfaqësuesve të pakicave në organet e zgjedhura dhe/ose nëpërmjet përfshirjes së shqetësimeve të tyre në axhendën e organeve të zgjedhura.

82. Komiteti Këshillimor ka vënë re se kur ligjet zgjedhore parashikojnë kërkesën e pragut, duhet të merret parasysh ndikimi i tyre i mundshëm negativ mbi pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në procesin zgjedhor. Përgjashtimet nga kërkesat e pragut kanë rezultuar të dobishme për të rritur pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në organet e zgjedhura.

83. Garancitë kushtetuese për përfaqësimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare në organet e zgjedhura duhet të shoqërohen me legjislacion efektiv të zbatueshëm dhe masa shoqëruese brenda një kohe të arsyeshme. Komiteti Këshillimor e konsideron thelbësore që personat që i përkasin pakicave kombëtare të marrin pjesë ose të konsultohen në procesin e hartimit të një legjislacioni të tillë dhe në monitorimin e zbatimit të tij.

[...]

iv. Sistemi i vendeve të rezervuara

91. Zgjidhjet që përfshijnë vendet e rezervuara dhe/ose të ndara për përfaqësuesit e pakicave kombëtare në disa raste kanë rezultuar të dobishme për të rritur pjesëmarrjen e personave që i përkasin pakicave kombëtare në vendimmarrje. Ofrimi i vendeve të rezervuara, pavarësisht nëse janë të ndara ndërmjet pakicave të ndryshme kombëtare ose të përcaktuara për një grup, është një ndër mënyrat për të siguruar përfaqësimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare në organet e zgjedhura.

92. Sistemi i 'vendeve të ndara' është hartuar në veçanti për nevojat e pakicave numerikisht të vogla. Në mënyrë që një zgjidhje e tillë të ketë ndikim domethënës në pjesëmarrjen e të gjitha pakicave kombëtare të përfaqësuara nëpërmjet vendit (vendeve) të ndara, është e rëndësishme që pakicat në fjalë të bien dakord për arritjen e një strategjie dhe objektivave të përbashkët nëpërmjet përfaqësimit në organin zgjedhor në fjalë. Përfaqësuesit zgjedhorë që zënë vendet e ndara duhet të kushtojnë kujdesin e duhur për të përfaqësuar shqetësimet e të gjithë personave që i përkasin pakicave kombëtare në zonë zgjedhore. Rotacioni i përfaqësuesve të pakicave të ndryshme kombëtare mund të ndihmojë në krijimin e kuptimit të një vendi të ndarë.

93. Në mënyrë që një zgjidhje për vend të garantuar të kontribuojë thellësisht për pjesëmarrjen efektive, është shumë e rëndësishme që përfaqësuesit e zgjedhur të pakicave të përfshihen në mënyrë efektive në proceset vendimmarrëse. Për më tepër, ata duhet të kenë mundësi të vërtetë për të pasur ndikim mbi organet e zgjedhura, përfshirë dhe ato organe që lidhen në mënyrë strikte me pakicat kombëtare. Si rezultat, është shumë e rëndësishme që ata të kenë të drejta për të folur dhe për të votuar në organin e zgjedhur dhe që roli i tyre të mos kufizohet vetëm në statusin e një vëzhguesi.

94. Gjithsesi, Komiteti Këshillimor është i mendimit se vetëm përcaktimi i zgjidhjeve të tilla nuk siguron automatikisht persona që i përkasin pakicave kombëtare me ndikim të vërtetë dhe të rëndësishëm në vendimmarrje.

REKOMANDIMET E LUNDIT PËR PJESËMARRJE EFEKTIVE TË PAKICAVE KOMBËTARE NË JETËN PUBLIKE, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) [1 shtator 1999]

II. Pjesëmarrja në sjelljen e vendimeve [...]

B. Zgjedhjet

7) Përvoja në Evropë dhe më gjërë tregon rëndësinë e procesit zgjedhor për sigurimin e pjesëmarrjes së pakicave në sferën politike. Shtetet duhet të garantojnë të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare për pjesëmarrje në jetën publike duke përfshirë të drejtën për votim dhe kandidim për funksion publik pa asnjë diskriminim.

8) Rregullimi i formimit dhe aktivitetit të partive politike duhet të përpulhet me parimet e ligjit ndërkombëtar për lirinë e asociimit. Ky parim përfshin lirinë e formimit të partive politike të bazuara në identitetet e bashkësive si dhe të atyre që nuk identifikohen vetëm me interesat e ndonjë komuniteti.

9) Sistemi zgjedhor duhet të mundësojë përfaqësimin dhe ndikimin e pakicave.

* Në territoret ku janë të koncentruara pakicat, njësitë zgjedhore njëanëtarëshe mund të sigurojnë përfaqësim të mjaftueshëm të pakicës.

* Sistemi proporcional ku pjesëmarrja e partisë politike në votën kombëtare reflektohet në pjesëmarrjen e saj në trupat legjislativ, mund të ndihmojë në përfaqësimin e pakicave.

* Disa forma të votimit të preferuar, ku votuesit i rangojnë kandidatët sipas zgjedhjes së tyre, mund t'a ndihmojnë përfaqësimin e pakicës dhe t'a promovojë bashkëpunimin ndërkomunal.

** Pragu më i vogël për përfaqësim në trupat ligjdhënës mund të zmadhojë përfaqësimin e pakicave në qeverisje me shtetin.*

10) Kufijtë gjeografik të njësive zgjedhore duhet të mundësojnë përfaqësim të barabartë të pakicave kombëtare.

SQARIME RRETH REKOMANDIMEVE TË LUND-it PËR PJESËMARRJE EFEKTIVE TË PAKICAVE KOMBËTARE NË JETËN PUBLIKE

B. Zgjedhjet

7) Përfaqësimi qeveritar nëpërmjet zgjedhjeve të lira, fer dhe periodike është gurthemel i demokracisë bashkëkohore. Qëllimi kryesor sipas fjalëve të nenit 21(3) të Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut është se “vullneti i njerëzve do të jetë baza për kryerjen e qeverisjes”. Ky standard kryesor artikullohet në marrëveshjet univezale dhe evropiane, respektivisht në nenin 25 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe neni 3 i Protokolit I, shtojcë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për shtetet e OSBE-së, paragrafët 5 dhe 6 të Dokumentit të Kopenhagës vërtetohet se “përmes elementeve të drejtësisë që janë qenësore për shprehjen e dinjitetit dhe për të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjitha qenieve njerëzore”, “vullneti i njerëzve i shprehur lirë dhe fer nëpërmjet zgjedhjeve periodike dhe të vërteta, është baza e autoritetit dhe legjitimitetit të çdo qeverisjeje”.

Përderisa shtetet kanë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mënyrave për t'i përmbushur këto obligime, ato janë të detyruara ta bëjnë këtë pa asnjë diskriminim dhe për qëllim kryesor duhet ta kenë përfaqësimin sa më të madh të mundshëm. Me të vërtetë Komisioni për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara ka sqaruar në paragrafin 12 të Komentit të Përgjithshëm 25 në nenin 25 (në mbledhjen e 57 në 1996) se “liria e të shprehurit, tubimit dhe asociacionit janë kushte esenciale për ushtrim efektiv të së drejtës për votim dhe e njëjta duhet të jetë plotësisht e mbrojtur. [...] Informacionet dhe materialet rreth votimit duhet të jenë në dispozicion në gjuhën e pakicave”. Përveç kësaj, paragrafi 5 i Komentit të Përgjithshëm 25 qartëson se “kryerja e çështjeve publike [...] është koncept i gjërë i cili lidhet me ushtrimin e forcës politike, në veçanti me ushtrimin e forcave legjislative, egzekutive dhe administrative. Ky koncept i mbulon të gjitha aspektet e administrimit publik si dhe formulimin dhe implementimin e politikës në nivele ndërkombëtare, nacionale, regjionale dhe lokale”.

Meqenëse asnjë sistem zgjedhor nuk është i lirë nga mundësia e ndërrimit të qëndrimeve dhe interesave, shteti duhet të përvetësojë sistem i cili do të përfshinte pjesëmarrjen më të madhe të popullatës në qeverisje në situatë të caktuar. Kjo është sidomos e rëndësishme për persona që u takojnë pakicave kombëtare të cilët përndryshe nuk do të kishin qenë të përfaqësuar në mënyrë adekuate.

8) Në parim shtetet demokratike nuk duhet të përzihen në mënyrën në të cilën njerëzit organizohen politikisht—në qoftë se mënyrat e tyre janë paqësore dhe i respektojnë të drejtat e të tjerëve. Parimisht, këtu bëhet fjalë për lirinë e asociacionit siç është artikuluar në një shumëllojshmëri të instrumenteve ndërkombëtar duke përfshirë nenin 20 të Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut, neni 22 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike; neni 11 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; dhe paragrafi 6 i Dokumentit të Kopenhagës. Liria për asociacion u është garantuar personave që u takojnë pakicave kombëtare me paragrafin 32.6 të Dokumentit të Kopenhagës dhe neni 7 i Konventës Kornizë. Në mënyrë të veçantë paragrafi 24 i Pjesës VI i Dokumentit të

Helsinki i obligon shtetet e OSBE-së “të sigurojnë personave që u takojnë pakicave kombëtare në menyrë individuale ose së bashku me të tjerët t’i gëzojnë të drejtat e tyre të njeriut dhe të drejtat themelore, duke përfshirë pjesëmarrjen e plotë të tyre, [...] në jetën politike [...] të shteteve të tyre nëpërmjet [...] partive politike dhe asociacioneve”.

Përderisa respektimi i plotë i të drejtave të barabarta dhe jodiskriminimit do ta zvogëlojnë ose eliminojnë kërkesën dhe nevojat që partitë politike të formohen në baza etnike, në disa situata të caktuara këto parti lokale mund të jenë e vetmja shpresë për të përfaqësuar interesat specifike dhe kështu për pjesëmarrje efektive. Nënkuptohet partitë mund të formohen edhe në baza të tjera si p.sh. duke u bazuar në interesat regjionale. Në raste ideale partitë duhet të jenë të hapura dhe t’i tejkalojnë çështjet e ngushta etnike; kështu partitë kryesore duhet të përfshijnë anëtarë të pakicave për të reduktuar nevojën dhe dëshirën për parti etnike. Në këtë aspekt është e rëndësishme zgjedhja e sistemit zgjedhor. Për çdo rast, asnjë parti politike ose asociacion tjetër nuk guxon të krijojë urejtje racore, e cila është e ndaluar me nenin 20 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike dhe neni 4 i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

9) Sistemi zgjedhor mund të përdoret për zgjedhjen e legjislaturës dhe trupa dhe institucione të tjera duke përfshirë edhe zgjedhjen e përfaqësuesve të tjerë zyrtarë. Përderisa zgjedhja e një anëtarë mund të sigurojë nivel të mjaftueshëm të përfaqësimit të pakicave, varësisht nga rregullimi i modelit zgjedhor dhe nga koncentrimi i pakicave në komunat e caktuara, modeli zgjedhor proporcional mund të ndihmojë në sigurimin e garancive për pjesëmarrjen e pakicave. Në shtetet e OSBE-së praktikohen forma të ndryshme të pjesëmarrjes proporcionale, duke i përfshirë edhe vijueset: „votim preferencial“, ku votuesit i rangojnë kandidatët sipas zgjedhjes së tyre; „sistemi i listës së hapur“, ku elektorati shpreh preferencë për kandidat në listën partiake, si dhe votim për partinë; „panachage“, ku votuesi mund të votojë për më shumë se një kandidat në listat e ndryshme partiake; dhe „cumulation“, ku votuesi mund të jep më shumë se një votë për kandidatin. Hapësirat për kandidatët nuk duhet të jenë aq të larta për t’a ndaluar përfaqësimin e pakicave.

10) Gjatë kufizimit të rretheve zgjedhore, interesat dhe çështjet e pakicave kombëtare duhet të merren parasysh me mundësi që ato të përfaqësohen në trupat që sjellin vendime. Nocioni „barazi“ don të thotë se askush nuk duhet të ketë paragjykime rreth metodës së zgjedhur dhe çdo interesi dhe çështjeje është konsideruar në mënyrë të duhur. Do të kishte qenë ideale që trupat udhëheqës të përcaktohen nga ndonjë trup i pavarur dhe neutral për të siguruar respekt për të gjitha të drejtat e pakicave. Kjo shpesh arrihet në shtetet e OSBE-së me themelimin e komisioneve zgjedhore profesionale.

Në çdo rast shtetet nuk duhet t’i ndërrojnë kufijtë zgjedhore ose t’a ndryshojnë proporcionin e popullatës në ndonjë hapsirë për t’a zvogëluar ose zmadhuar përfaqësimin e pakicave. Kjo gjë është rreptë e ndaluar me nenin 16 të Konventës Kornizë, gjersa neni 5 i Marrëveshjes Evropiane për Vetëqeverisje Lokale thekson se „ndryshimet në njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk mund të bëhen pa konsultim paraprak të bashkësive lokale në fjalë, mundësisht me ndihmë të referendumit kur kjo është e lejuar me statut“ (shih rekomandimin 19 në lidhje me aranzhmanet territoriale).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

84. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
85. Ashtu siç është cekur edhe më lart, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim (i) me paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë; si dhe (ii) nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
86. Bazuar në pretendimet e lartcekura të parashtruesve të kërkesës, Gjykata në vijim do të shqyrtojë dhe elaborojë secilin pretendim specifik të tyre në kuptim të përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës.
87. Në këtë drejtim, Gjykata, duke aplikuar nenin 113 të Kushtetutës, dispozitat relevante të Ligjit për sa i përket procedurës në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafin 7 të Kushtetutës; nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit; dhe rregullat 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] dhe 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës, do të shqyrtojë nëse: (i) kërkesa është dorëzuar nga palë të autorizuar; (ii) kontestohen vendime të autoriteteve publike; (iii) janë shteruar të gjitha mjetet juridike; (iv) kërkesa është dorëzuar brenda afatit kohor të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës; (v) janë saktësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendohet se janë shkelur; (vi) kërkesa është qartazi e pabazuar; dhe (vii) nëse ka ndonjë kriter shtesë të pranueshmërisë, që sipas rregullit 39 (3) të Rregullores së punës nuk është plotësuar.

(i) Lidhur me palën e autorizuar

88. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

89. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

90. Gjykata në fund i referohet edhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës i cili përcakton:

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.

91. Për sa i përket përmbushjes së kërkesës për palën e autorizuar, Gjykata vëren se para Gjykatës paraqiten Partia Liberale Egjiptiane (PLE) dhe Partia e Bashkuar e Romëve të Kosovës (PREBK), të cilat janë regjistruar në KQZ si subjekte politike për të garuar në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021 për Kuvend. Parashtruesit e kërkesës në Gjykatë përfaqësohen nga të autorizuarit e partive, sipas autorizimit të dhënë nga Kryetari i Partisë së PLE dhe Kryetari i Partisë së PREBK, respektivisht Veton Berisha dhe Albert Kinolli.
92. Gjykata vëren se, në bazë të paragrafit 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës kanë të drejtë të parashtrojë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në të drejtat kushtetuese që vlejnë për personat juridikë, për aq sa ato janë të zbatueshme (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese KI48/18 me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 21 janarit 2019, paragrafi 101; dhe KI207/19, me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim, i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 206 dhe shih po ashtu, rastin e GJEDNJ-së, *Partia për një Shoqëri Demokratike dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 3840/10, Aktgjykim i 12 janarit 2016).
93. Për më tepër, dhe në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu thekson se GJEDNJ, nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore, ka konstatuar se e drejta për t'u zgjedhur në kuadër të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është e drejtë që u garantohet edhe partive politike, si subjekte juridike, dhe se ato mund të ankohen pavarësisht nga kandidatët e tyre (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, *Partia e Punës së Gjeorgjisë kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 8 korrikut 2008, paragrafët 72-74, dhe referencat e tjera të përmendura në atë vendim).
94. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [AA.nr.29/2021] e 12 marsit 2021 të Gjykatës Supreme në lidhje me Vendimin [A.nr.736/2021] e 7 marsit 2021 të PZAP-së. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është dorëzuar nga një palë e autorizuar që ka interes të drejtpërdrejtë në kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme në aspekt të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ dhe se parashtruesit e kërkesës kontestojnë akte të autoriteteve publike.

(ii) Lidhur me aktin e autoritetit publik

95. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart dhe nenit 47 (Kërkesat individuale) të Ligjit, i cili përcakton se "*Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. [...]".*
96. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit (2) të rregullit 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës i cili, *inter alia*, përcakton se "*(2) Kërkesa, e bërë sipas këtij rregulli duhet të qartësojë saktësisht [...] cili është akti konkret i autoriteti publik i cili kontestohet*".
97. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [AA.nr.29/2021] e 12 marsit 2021 të Gjykatës Supreme në lidhje me Vendimin [A.nr.736/2021] e 7 marsit 2021 të PZAP-së.
98. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë akte të një autoriteti publik.

(iii) Lidhur me shterimin e mjeteve juridike

99. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart; paragrafit 2 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit; dhe pikës (b), paragrafit (1), të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

(...)

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.

100. Gjykata vëren që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton detyrimin e shterimit të “*të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj*”. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me nenin 47 të Ligjit dhe me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe vlen, si për personat fizikë ashtu edhe për personat juridikë, për aq sa është e aplikueshme.
101. Në këtë kontekst, Gjykata duke u bazuar edhe në praktikën e saj gjyqësore rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon parashtruesit e kërkesave, që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një akti apo vendimi të kontestuar të autoritetit publik apo të gjykatës së rregullt.
102. Në kuptim të plotësimit të kriterit për shterimin e mjeteve juridike në kuptim formalo-procedural, Gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës, të dorëzuara nga parashtruesit e kërkesës, vëren që kundër Vendimi të PZAP-së, të 7 marsit 2021 në Gjykatën Supreme, ankesë kishte dorëzuar vetëm parashtruesi i kërkesës, gjegjësisht subjekti politik PLE. Ky i fundit, megjithatë, nuk kishte dorëzuar ankesë në Gjykatën Supreme kundër Vendimit plotësues të PZAP-it të 10 marsit 2021.
103. Thënë këtë, nga shkresat e lëndës po ashtu rezulton që subjekti politik PREBK, në cilësinë e parashtruesit të kërkesës në këtë Gjykatë, në Gjykatën Supreme nuk kishte dorëzuar ankesë kundër Vendimit të lartcekur të PZAP-it, të 7 marsit 2021 dhe as atij plotësues, të 10 marsit 2021.
104. Gjykata duke iu referuar dispozitave përkatëse ligjore, përkatësisht paragrafit 4 të nenit 118 të Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme [të ndryshuar dhe plotësuar me paragrafin

2 të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-256], vëren se parashtuesi i kërkesës përkatësisht subjekti politik PREBK si mjet të rregullt juridik kishte në dispozicion edhe ankesën në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-it. Megjithatë, Gjykata rithekson se parashtuesi i kërkesës, përkatësisht subjekti politik PREBK, kundër Vendimit të KQZ-së kishte parashtuar apel vetëm në PZAP, por jo edhe në Gjykatën Supreme.

105. Në kontekst të plotësimit të kriterit për shterimin e mjeteve juridike, Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se respekton parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtuesit e kërkesave duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat para gjykatave të rregullta, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korrigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore të garantuar me Kushtetutë. Gjykata po ashtu ka pohuar në vazhdimësi se parashtuesit e kërkesës janë përgjegjës kur rastet e tyre përkatëse shpallen të papranueshme nga Gjykata, nëse nuk kanë shfrytëzuar procedurën e rregullt ose nuk kanë raportuar shkelje të Kushtetutës në procedurat e rregullta (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI139/12, parashtues *Besnik Asllani*, Vendim për Kërkesën për Masë të Përkohshme dhe Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2013, paragrafi 45; KI07/09, parashtues *Demë Kurboqaj dhe Besnik Kurboqaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 18-19; KI89/15, parashtues *Fatmir Koçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2016, paragrafi 35; KI24/16, parashtues *Audi Haziri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, paragrafi 39; dhe KI30/17, parashtues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafët 35-37).
106. Vetëm në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 [e Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, ndër të tjera, rastin e GJENDJ-së, *Aksoy kundër Turqisë*, Aktgjykim, i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
107. Prandaj, Gjykata duke u bazuar në si më sipër, konstaton se parashtuesi i kërkesës, përkatësisht subjekti politik PLE i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për të kontestuar në Gjykatë edhe Aktgjykimin [AA.nr.29/2021] e 12 marsit 2021 të Gjykatës Supreme në lidhje me Vendimin e PZAP-së të 7 marsit 2021, por vetëm sa i përket refuzimit të apelit të tij në lidhje me Komunën e Kamenicës dhe Graçanicës, për arsye se i njëjti nuk kishte parashtuar ankesë kundër Vendimit plotësues të PZAP-it, të 10 marsit 2021, i cili vendim kishte vendosur përkitazi me refuzimin e anulimit të fletëvotimeve të subjektit politik Romani Iniciativa në Komunën e Mitrovicës së Veriut.
108. Ndërsa, parashtuesi i kërkesës, gjegjësisht subjekti politik PREBK në kuptim të shterimit të mjeteve juridike në kuptim formalo-procedural, nuk i ka shteruar mjetet juridike, ashtu siç është specifikuar me nenin 113, paragrafin 7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së Punës.
109. Rrjedhimisht, dhe marrë për bazë atë si më sipër, Gjykata do të vazhdojë me shqyrtimin dhe vlerësimin e plotësimit të kriterëve të mëtejme të pranueshmërisë së kërkesës vetëm përkitazi me parashtuesin e kërkesës, përkatësisht subjektin politik PLE.

(iv) Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe afatin përkitazi me subjektin politik PLE

110. Në vazhdim, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës, përkatësisht subjekti politik PLE, i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë, të përcaktuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. (...)

111. Gjykata rikujton që të njëjtat kriteret janë të specifikuar më tej në pikat (c) dhe (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] dhe paragrafët (2) dhe (4) të rregullit 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës.
112. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës (PLE) ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ pretendon se i janë cenuar dhe i ka specifikuar aktet konkrete të autoritetit publik të cilët i konteston në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës dhe e ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës.
113. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës (PLE) e ka saktësuar kërkesën e tij dhe të njëjtën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor.

(v) Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës përkitazi me parashtruesin e kërkesës (PLE)

114. Gjykata arrin në përfundimin se parashtruesi i kërkesës (PLE), (i) në kuptim të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, të 12 marsit 2021 në lidhje me Vendimin e PZAP-së, të 7 marsit 2021 është palë e autorizuar; (ii) konteston dy vendime të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të 12 marsit 2021 në lidhje me Vendimin e PZAP-së, të 7 marsit 2021; (iii) ka shteruar mjetet juridike në kuptimin formalo-procedural ashtu siç është elaboruar specifikisht më lart; (vi) ka saktësuar të drejtat dhe liritë, të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, të cilat pretendon se i janë shkelur; dhe (v) ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me Ligj dhe me Rregullore të Punës.
115. Rrjedhimisht, Gjykata e shpall kërkesën e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht subjektit politik, PLE të pranueshme dhe në vijim do të vazhdojë me shqyrtimin e meritave të kërkesës së parashtruesit të kërkesës.

Meritat

116. Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me pjesëmarrjen e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht subjektit politik PLE, në zgjedhjet për Kuvend të mbajtura më 14 shkurt 2021. Në këto zgjedhje, si rezultat i certifikimit nga ana e KQZ-së, ndër tjerash, kishin garuar parashtruesi i kërkesës, përkatësisht PLE dhe subjekti politik Romani Iniciyativa. Më 4 mars 2021, KQZ përmes Vendimit [nr. 860-2021] kishte shpallur rezultatet e zgjedhjeve dhe sipas rezultateve të KQZ-së (i) subjekti politik Romani Iniciyativa kishte fituar 4.049 vota, ndërsa (ii) subjekti politik PLE kishte fituar 2.430 vota. Më 5 mars 2021, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht PLE dhe (4) subjekte politike, që përfaqësonin komunitetin jo-shumicë rom, ashkali dhe egjiptian, përkatësisht PREBK, PAI, PDAK dhe LPRK, kishin dorëzuar ankesa/apete të përbashkëta në PZAP duke kontestuar *“votat e fituara në mënyrë kundër kushtetuese dhe kundërligjore nga Subjekti Politik “Romani Iniciyativa” duke kërkuar anulimin e fletëvotimeve të këtij subjekti në 107 vendvotime.”* Për pasojë, dhe më 7 mars 2021, fillimisht PZAP përmes Vendimit [A.nr.736/2021] vendosi që (i) të pranohen pjesërisht apelet e parashtruesit të kërkesës dhe subjekteve tjera politike, duke vendosur që të anulohen fletëvotimet e specifikuar në pikën I të dispozitivit përkatës për subjektin politik Romani Iniciyativa, në dyzet e një (41) vendvotimet e specifikuar në këtë vendim në pesë (5) komuna, përkatësisht komunat e Leposaviqit, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit dhe Klllokotit; (ii) të urdhërohet KQZ që fletëvotimet e anuluar sipas pikës I të dispozitivit të vendimit t'i largojë nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve siç ishin publikuar përmes Vendimit të KQZ-së [nr. 860-2021] të 4 marsit 2021; dhe (iii) të refuzohen si pjesërisht të pabazuara apelet e lartcekura për anulimin e fletëvotimeve për subjektin Romani Iniciyativa në vendvotimet e specifikuar [50 vendvotimet e specifikuar në këtë pikë të dispozitivit, faqe 2 e Vendimit të PZAP-it]. PZAP përmes Vendimit të 7 marsit 2021, nuk kishte vendosur përkitazi me kërkesën e parashtruar në apel për anulimin e fletëvotimeve edhe në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Për pasojë, më 9 mars 2021, kundër vendimit të lartcekur të 7 marsit 2021 të PZAP-së, në Gjykatën Supreme, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht PLE parashtroi ankesë. Përmes të njëjtës ishte kontestuar ligjshmëria e pikës së Vendimit të 7 marsit 2021 të PZAP-së përmes së cilit pjesërisht ishte refuzuar apeli i tyre, duke specifikuar gjithashtu që PZAP nuk kishte vendosur përkitazi me ankesën/apelin lidhur me komunën e Mitrovicës së Veriut. Më 10 mars 2021, PZAP kishte nxjerrë Vendimin plotësues, përkatësisht Vendimin [A.nr.736/2021], përmes së cilit kishte plotësuar vendimin paraprak të 7 marsit 2021, si në vijim: (i) pranohen pjesërisht të bazuara apelet e parashtruara nga subjektet politike PLE dhe subjektet tjera përkatëse dhe anulohen edhe katërdhjetë (40) fletëvotime në vendvotimin 3502/01R në Komunën Ranillug e të cilat, sipas rezultatit zgjedhor i përkasin subjektit politik Romani Iniciyativa; dhe (ii) refuzohen si të pabazuara apelet e parashtruara nga subjektet politike PLE dhe subjekteve tjera përkatëse përmes së cilave është kërkuar që të anulohen edhe fletëvotimet në pesëmbëdhjetë (15) vendvotimet e specifikuar që i përkasin subjektit politik Romani Iniciyativa, përkatësisht në vendvotimet në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Kundër këtij Vendimi plotësues të PZAP-së, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht subjekti politik PLE, nuk kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Në këtë të fundit, ankesa e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht PLE ishte dorëzuar vetëm sa i përket Vendimit të 7 marsit 2021. Ndërsa, ankesë kundër dy Vendimeve të PZAP-së, përkatësisht atij të 7 marsit 2021 dhe 10 marsit 2021, kishte paraqitur edhe subjekti politik Romani Iniciyativa. Më 12 mars 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [AA.nr.29/2021] vendosi që të refuzojë si të pabazuar (i) ankesën e subjektit politik Romani Iniciyativa kundër Vendimit të PZAP-se të 7 marsit 2021 dhe Vendimit plotësues të PZAP-së të 10 marsit 2021; dhe (ii) ankesën e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht PLE dhe subjekteve tjera politike kundër Vendimit të PZAP-së të 7 marsit 2021, duke konfirmuar për pasojë, vendimmarrjen e PZAP-së.

117. Gjykata rikujton që parashtuesi i kërkesës (PLE) e konteston pjesërisht vendimin e Gjykatës Supreme para Gjykatës, duke pretenduar në esencë, që Gjykata Supreme do të duhej të kishte konfirmuar anulimin/shpalljen e pavlefshme të votave edhe në tri (3) komuna tjera, përkatësisht Graçanicë, Kamenicë dhe Mitrovicë të Veriut, me sqarimin se, si rezultat i votave të marra nga subjektit politik Romani Iniciyativa në komunat e lartcekura dhe të cilat sipas parashtuesit të kërkesës, nuk përfaqësojnë votat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, por votat e komunitetin serb, atij i është mohuar e drejta e tij për tu zgjedhur apo për të pasur përfaqësues në Kuvendin e Kosovës në kundërshtim me garancitë kushtetuese. Thënë këtë, parashtuesi i kërkesës, vet thekson që në Republikën e Kosovës, mungon baza kushtetuese dhe ligjore, duke theksuar gjithashtu që *“nuk ka praktika dhe norma precize ndërkombëtare”* dhe të cilat në mënyrë shprehimore përcaktojnë që ulëset e garantuara për pakicat kombëtare mund të fitohen vetëm nëse votohen nga po i njëjti komunitet të cilin ata deklarohen që e përfaqësojnë. Në mungesë të kësaj baze kushtetuese dhe ligjore, parashtuesi i kërkesës pretendon që bazuar në paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës, Gjykata duhet të detyrojë Kuvendin që të ndërmerr masa adekuate, përmes nxjerrjes së ligjeve, përmes të cilave, do të sigurohej pjesëmarrja efektive e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, ashtu që dhe ndër tjerash, vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës do të fitoheshin vetëm nëse votohen nga anëtarët e të njëjtit komunitet të cilin ata deklarohen që e përfaqësojnë.
118. Në kontekst të pretendimeve të parashtuesit të kërkesës, Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës përmes apelit të parashtuar në PZAP kishte pretenduar se vendimi i KQZ-së përbënte shkelje të paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë. Bazuar në këto pretendime, PZAP përmes Vendimit të tij të 7 marsit 2021, kishte anuluar fletëvotime të subjektit politik Romani Iniciyativa në vendvotime në pesë (5) komuna të Republikës së Kosovës, gjegjësisht të Leposaviqit, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit dhe Kllokotit, duke vënë theks, ndër tjerash, në *“mungesën e lidhjes objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar”*. Ky vendim i PZAP-së, siç është sqaruar më lart, nuk kishte vendosur lidhur me apelet përkitazi me Komunën e Mitrovicës së Veriut, dhe këtë komunë e kishte adresuar përmes Vendimit plotësues të 10 marsit 2021, duke e refuzuar ankesën përkatëse. Siç është sqaruar më lart, parashtuesi i kërkesës nuk kishte paraqitur ankesë kundër vendimit plotësues.
119. Gjykata rikujton që pretendimet e njëjta parashtuesi i kërkesës i kishte paraqitur edhe në Gjykatën Supreme kur kishte kontestuar vendimin e PZAP-së të 7 marsit 2021, duke kërkuar në esencë që të anuloheshin/shpalleshin të pavlefshme edhe votat në komunat e Graçanicës dhe Kamenicës. Përmes ankesës në Gjykatën Supreme, i njëjti, ndër tjerash, kishte theksuar që (i) kishte *“një disproporcion mes votës së dhënë për subjektin Romani Iniciativa dhe numrin e popullsisë rome në Komunat e Kamenicës, Graçanicës dhe Mitrovicës së Veriut, duke shtuar që “në Graçanicë, ku RI [Romani Iniciativa] ka fituar 1773 vota ndërkaq numri i votuesve potenciale të popullsisë rome është 745, të anulohen 1028 vota për RI; në Kamenicë, ku RI ka fituar 283 vota ndërkaq numri i votuesve potenciale të popullsisë rome është 240, të anulohen 43 vota për RI; si dhe në Mitrovicë Veriore, ku RI ka fituar 198 vota ndërkaq numri i votuesve potenciale të popullsisë rome është 40, të anulohen 158 vota për RI.”*; dhe që për pasojë, (ii) refuzimi i PZAP-it për të anuluar fletëvotimet e subjektit Romani Iniciativa edhe në komunat e Kamenicës, Graçanicës dhe Mitrovicës së Veriut, përbënte shkelje të paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të Konventës Kornizë. Gjykata rikujton që Gjykata Supreme kishte konfirmuar vendimmarrjen e PZAP-së, përkatësisht (i) kishte miratuar interpretimin e PZAP-së bazuar në të cilin fletëvotimet në një numër vendvotimesh janë shpallur të pavlefshme; dhe (ii) kishte konfirmuar që kërkesa

e parashtruesit të kërkesës që fletëvotimet e caktuara të shpalleshin të pavlefshme edhe në komunën e Graçanicës dhe të Kamenicës, të refuzoheshin.

120. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës (PLE) para Gjykatës, konteston Aktgjykimin e Gjykatës, në esencë, pikërisht sepse ishte refuzuar kërkesa tij që të shpalleshin të pavlefshme edhe votat në vendvotimet e caktuara në komunën e Graçanicës dhe të Kamenicës, respektivisht. Parashtruesi i kërkesës, ngrit pretendimet e njëjta që kishte ngritur edhe para PZAP-së dhe Gjykatës Supreme, sipas të cilave, në esencë, e drejta e tij për tu zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës është shkelur sepse numër më i madh fletëvotimesh ishte dashur të anuloheshin/shpalleshin të pavlefshme. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës, ndër tjerash, thekson që *“në rastin konkret të zgjedhjeve të datës 14 shkurt 2021, përfaqësuesit e Romani Inicijativas që momentalisht ka zënë ulësen në Kuvend i mungon lidhja objektive me komunitetin rom, duke qenë se votat që ky subjekt politik ka marrë në komunën e Graçanicës, Kamenicës dhe Mitrovicës së Veriut janë gjithashtu në numër më të madh sesa banorët e komunitetit rom në këto komuna, ndaj ato vota janë marrë nga votuesit e komuniteteve tjera. Pa këto vota të parregullta ky përfaqësues nuk do të ushtronte këtë funksion aktualisht në Kuvend. Përfaqësuesi nga komuniteti rom ka arritur të zgjedhet deputet në ulëse të garantuara si rezultat i votave të një komuniteti tjetër, për faktin e thjeshtë që ai komunitet është numerikisht më i madh sesa ai rom. Rrjedhimisht, ekziston një shpërndarje mes përfaqësuesit dhe elektoratit të këtij komuniteti që sipas Kushtetutës supozohet t'i japë legjitimitetin përfaqësues deputetit në rend të parë. Një deformim i tillë i këtij mekanizmi përfaqësues mbron përfaqësimin efektiv të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe pjesëtarëve të tyre në Kosove dhe bie ndesh me nenin 58(4) dhe 64(2) të Kushtetutës së Kosovës”*.
121. Bazuar në përmbajtjen e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij para Gjykatës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në argumentimin e shkeljes së paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë, përdorë arsyetimin e dhënë nga ana e PZAP-së dhe Gjykatës Supreme, përmes vendimeve të të cilave ishte konstatuar që duhet të anuloheshin/shpalleshin të pavlefshme votat e fituara nga subjekti politik Romani Inicijativa në pesë (5) komuna të lartcekura, në esencë sepse marrë parasysh dallimin e numrit të qytetarëve rom, ashkali dhe egjiptian në komuna të përkatëse dhe votat e fituara nga Romani Inicijativa, *“mungonte lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar”*.
122. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se bazuar në interpretimin e PZAP-së dhe të Gjykatës Supreme, sipas paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, duhet të ketë *“lidhje objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar”*, përkatësisht ushtrimi i të drejtës aktive dhe pasive të votës në Republikën e Kosovës, kushtëzohet nga përkatësia etnike dhe se, në esencë, çdo votë që tejkalon numrin e popullsisë së caktuar në një vendvotim, duhet për pasojë të anulohet/shpallet e pavlefshme. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, këtë interpretim të Kushtetutës duhet ta konfirmojë edhe Gjykata Kushtetuese dhe rrjedhimisht të konfirmoj që votat të përkatëse duhet të ishin shpallur të pavlefshme edhe në vendvotimet e caktuara në të paktën dy komuna tjera, përkatësisht Graçanicë dhe Kamenicë.
123. Bazuar në këto pretendime dhe ashtu siç është cekur më lart, Gjykata fillimisht (i) do të elaborojë parimet e përgjithshme që ndërlidhen me të drejtat zgjedhore të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke përfshirë edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e vet Gjykatës, GJEDNJ-së dhe instrumenteve ndërkombëtare, përfshirë edhe opinionet dhe raportet e mekanizmave

relevante ndërkombëtare në lidhje me të drejtat zgjedhore; dhe më pas (ii) do të i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

I. Parime të përgjithshme

124. Në vijim dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të paraqet në mënyrë të përmbledhur, (i) parimet e përgjithshme për të drejtat zgjedhore sipas Kushtetutës; (ii) parimet e përgjithshme për përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë sipas Kushtetutës dhe Konventës Kornizë; (iii) parimet e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së; (iv) praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me të drejtat zgjedhore të pakicave kombëtare; dhe (v) parimet e përgjithshme sipas Kodit të Praktikës së Mirë, opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias dhe dokumenteve tjera relevante të Këshillit të Evropës dhe të Rekomandimeve të LUND-it për Pjesëmarrje të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

(i) Parimet e përgjithshme për të drejtat zgjedhore sipas Kushtetutës

125. Gjykata fillimisht i referohet nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”

126. Në lidhje me të drejtat zgjedhore, Gjykata i referohet edhe Instrumenteve dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës e që janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës (shih, në mes tjerash, rastin nr. KO162/18, parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018, paragrafi 36 dhe KI207/19, parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, të cituar më lart, paragrafi 107).

127. Protokollin nr. 1 i KEDNJ-së përmes nenit 3 (E drejta për Zgjedhje të Lira), ka përcaktuar që: *“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”*

128. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet edhe nenit 21 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, përmes të cilit përcaktohet që:

“1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

2. Gjithkush ka njëllë të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.

3. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.”

129. Gjykata po ashtu i referohet edhe nenit 25 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike përcakton që:

“Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

(a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;

(b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;

(c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.”

(ii) Parimet e përgjithshme për përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë sipas Kushtetutës dhe Konventës Kornizë

130. Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 4 [të amendamentuar sipas amendamentit nr. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të publikuar në Gazetën Zyrtare më 7 shtator 2012] të nenit 58 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratoj masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit”.

131. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet nenit 15 të Konventës Kornizë, i cili përcakton që:

“Palët do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta”.

132. Gjykata gjithashtu rikujton që neni 64 [Struktura e Kuvendit] i Kushtetutës përcakton që:

“1.Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.

2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:

(1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që

ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

(iii) Parimet e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së

133. Gjykata duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore, ndër tjerash, të shtjelluar në Aktgjykimin KI48/18, fillimisht thekson se “neni 45 i Kushtetutës përbëhet nga 3 paragrafë të veçantë dhe secili prej tyre ka elementet dhe rregullat përkatëse. [...] Paragrafi i parë i nenit 45 të Kushtetutës përcakton të drejtën për të zgjedhur (të drejtën aktive të votës), si dhe të drejtën për t’u zgjedhur (të drejtën pasive të votës). E drejta e parë, pra ajo aktive e votës, i takon vetëm individëve, pra personave fizikë që janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe që kanë arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e votimit dhe në rast se e drejta e tyre nuk është e kufizuar me një vendim gjyqësor. E drejta tjetër, ajo pasive e votës, i takon kandidatëve si individë, përkatësisht si persona fizikë, të cilët garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror, si dhe subjekteve politike, përkatësisht personave juridikë që garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror. Edhe për të drejtën pasive të votës vlen kushti që të njëjtëve të mos i jetë kufizuar ushtrimi i kësaj të drejte me një vendim gjyqësor.” (shih, paragrafin 225 të Aktgjykimit në rastin KI48/18).
134. Po në të njëjtin rast, Gjykata më tej kishte theksuar se: “[...] paragrafi i dytë i nenit 45 të Kushtetutës garanton që vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Të njëjtat garanci janë të përcaktuara edhe në kuptimin e vetëqeverisjes lokale e cila sipas nenit 123 të Kushtetutës ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Këto garanci kushtetuese janë po ashtu të përcaktuara më tej nëpërmjet LZP-së, Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së edhe Ligjit nr. 03/l-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Për më tepër që të njëjtat janë në harmoni me pesë parimet themelore të trashëgimisë evropiane zgjedhore e të përmbledhura në Kodin e Praktikës së Mirë dhe në Raportin përkatës Shpjegues e të cilat, siç është përmbledhur më lart, përfshijnë votën universale, të barabartë, të lirë, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë.”
135. Gjykata në interpretimin e garancive të mishëruara në nenin 45 të Kushtetutës i referohet edhe praktikës së GJEDNJ-së e cila gjithashtu ka interpretuar nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së si garanci për “të drejtën aktive të votës” dhe “të drejtën pasive të votës”. Të dyja ngërthejnë në vetvete garanci substanciale dhe procedurale. Megjithatë, Gjykata vëren që, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të drejtat pasive, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret, janë pajisur me më pak mbrojtje sesa të drejtat aktive (shih, ndër tjerash, rastin KI48/18, të cituar më lart, paragrafi 226 dhe referencat e përdorura aty si rastet e GJEDNJ-së, *Zdanoka kundër Letonisë*, nr. 58278/00, Aktgjykim i 16 marsit 2006, paragrafët 105-106). Praktika e GJEDNJ-së, në parim dhe në raport me të drejtat pasive është fokusuar dukshëm vetëm në verifikimin e mungesës së arbitraritetit në procedurat vendëse e që mund të kenë rezultuar në diskualifikimin e një personi fizik apo juridik për të kandiduar në zgjedhje (shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së: *Zdanoka kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 115; dhe *Melnitchenko kundër Ukrainës*, nr. 17707/02, Aktgjykim i 19 tetorit 2004, paragrafi 57).
136. Gjykata më tej thekson që, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të drejtat e garantuara sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së janë thelbësore për krijimin dhe për mbajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë të qeverisur nga sundimi i ligjit (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2)

[DHM], nr. 74025/01, Aktgjykim i 6 tetorit 2005, paragrafi 58). Megjithatë sipas GJEDNJ-së, këto të drejta nuk janë absolute. Ato kanë hapësirë për “kufizime të nënkuptuara” dhe shteteve kontraktuese u jepet hapësirë e vlerësimit në këtë sferë (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*, cituar më lart, paragrafi 52; *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24883/94, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 63, *Labita kundër Italisë*, nr. 26772/95, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 201; *Podkolzina kundër Letonisë*, nr. 46726/99, paragrafi 33; dhe *Partei der Friesen kundër Gjermanisë*, nr.65480/10, Aktgjykimi 28 janarit 201, paragrafët 43-44).

137. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se garancitë e nenit 3 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së dallojnë nga të drejtat e tjera të garantuara përmes KEDNJ-së dhe kjo reflektohet nga formulimi i vetë nenit i cili fokusohet në përcaktimin e detyrimit për shtetet kontraktuese që të mbajnë zgjedhje që sigurojnë shprehjen e lirë të opinionit të votuesve dhe nuk formulohet në pikëpamje të një të drejte apo lirie individuale të veçantë. Rrjedhimisht, fokusi i nenit 3 të Protokollit nr.1 është te detyrimi që ka shteti kontraktues dhe jo tek të drejtat dhe liritë e personave fizikë apo juridikë, ndonëse ato nuk përjashtohen, siç edhe tregon jurisprudenca e GJEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*, nr. 9267/81, Aktgjykim i 2 marsit 1987, paragrafët 46-51, dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI48/18, të cituar më lart, paragrafët 219-220).
138. GJEDNJ në rastin e saj *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*, ka specifikuar se e drejta e votës universale dhe e barabartë përfshihet në këtë të drejtë. GJEDNJ në këtë rast ka specifikuar se ky nen shtrihet në trajtimin e barabartë për të gjithë qytetarët (paragrafi 54 i Aktgjykimit në rastin *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*). Përveç kësaj garancie, GJEDNJ po ashtu ka specifikuar se neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së garanton të drejtën e votës së lirë dhe të fshehtë, përkatësisht zgjedhjet duhet të organizohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë alternativë për zgjedhje të lira dhe të zhvillohen edhe në rrethana që sigurojnë fshehtësinë e votimit.

(iv) Praktika relevante gjyqësore e GJEDNJ-së në lidhje me të drejtat zgjedhore të pakicave kombëtare

139. Gjykata në vijim, do ti referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që ndërlidhet me të drejtat zgjedhore të pakicave kombëtare si në kuptim të së drejtës për tu zgjedhur dhe të drejtës për të zgjedhur, përkatësisht të drejtës aktive dhe pasive të votës.
140. Në kontekst të së drejtës aktive të votës, Gjykata fillimisht i referohet rastit të GJEDNJ-së *Aziz kundër Qipros* (nr. 69949/01, Aktgjykim, i 22 qershorit 2004), rrethanat e të cilit ndërlidhen me atë se parashtuesi i kërkesës ishte ankuar se atij iu refuzua kërkesa për t’u regjistruar në listën zgjedhore, me qëllim që të votonte në zgjedhjet parlamentare të 27 majit 2001, pasi ai ishte anëtar i komunitetit turko-qipriot. Kërkesa e tij u refuzua me arsyetimin se, sipas nenit 63 të Kushtetutës, anëtarët e komunitetit turko-qipriot, nuk mund të regjistroheshin në listën zgjedhore greko-qipriote. GJEDNJ, konstatoi se e drejta e parashtuesit e garantuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së ishte cenuar për arsye se si rezultat i rrethanave në Qipro që nga viti 1963 dhe vakumit legjislativ, ai, si pjesëtar i komunitetit turko-qipriot që jetonte në Republikën e Qipros, ishte plotësisht i privuar nga çdo mundësi për të shprehur mendimin lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve. GJEDNJ po ashtu konstatoi shkelje të nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së në ndërlidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke konstatuar dallim në trajtim lidhur me gëzimin e të drejtës në fjalë, ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit turko-qipriot dhe atyre të komunitetit greko-qipriot. Në këtë kontekst, GJEDNJ theksoi se

shtetet kishin liri të konsiderueshme për të vendosur rregullat për zgjedhjet parlamentare, por rregulla të tilla duhej të justifikoheshin mbi baza të arsyeshme dhe objektive.

141. Në anën tjetër, në rastin më aktual të GJEDNJ-së, përkatësisht rastin *Bakirdzi dhe E.C. kundër Hungarisë* (kërkesat nr. 49636/14 dhe 65678/14, Aktgjykim i 3 prillit 2023, i cili ka marrë formë të prerë më 3 prill 2023) rrethanat e të cilit rast kanë të bëjnë me dy parashtresues që i përkasin pakicave kombëtare në Hungari, të cilët janë regjistruar për të votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 në Hungari. Bazuar në ligjin zgjedhor përkatës hungarez, (i) anëtarët e pakicave kombëtare mund të regjistrohen si votues të pakicave kombëtare në bazë të vetë-identifikimit; (ii) votuesit e pakicave kombëtare mund të votojnë vetëm për listën e pakicës kombëtare të cilës i përkasin; (iii) për votimin e pakicave kombëtare, çdo pakicë kombëtare ka një listë të veçantë të mbyllur të kandidatëve që figuron në një fletëvotim të veçantë; dhe (iv) mundësia e vetme e votuesve të pakicave përkatëse kombëtare është të votojë ose të mos votojë për listën e mbyllur të paraqitur në lidhje me pakicën e tij/saj kombëtare. Ligji përkatës zgjedhor, në mënyrë specifike bën dallimin ndërmjet të gjithë votuesve me vendbanim në Hungari dhe të votuesve me vendbanim në Hungari, të cilët janë të regjistruar në regjistrin zgjedhor si votues të pakicave kombëtare.
142. Duke u bazuar në nenin 3 të Protokollit Nr. 1 të Konventës në lidhje me nenin 14 të Konventës, parashtresuesit u ankuan se sistemi i votimit të pakicave kombëtare përbënte një ndërhyrje diskriminuese në të drejtat e tyre aktive zgjedhore. Parashtresuesit përkatës, ndër të tjera, u ankuan se elementi themelor i zgjedhjeve të lira ishte një zgjedhje reale midis konkurrentëve të garës politike. Megjithatë, ata nuk kishin një zgjedhje të vërtetë sepse (i) së pari, votuesit e pakicave kombëtare nuk kishin mundësinë të votonin për listat e partive politike; (ii) së dyti, ata nuk mund të votonin për askënd tjetër përveç kandidatëve të grupit të tyre të pakicës kombëtare. Të njëjtit para GJEDNJ-së pretenduan se të pasurit e një origjine identike etnike nuk rezulton në të pasurit e pikëpamjeve identike politike. Parashtresuesit përkatës më tej pohuan se duke kufizuar zgjedhjen e tyre në hedhjen e votës për listën e mbyllur të pakicave kombëtare, gjithashtu ishte shkelur edhe e drejta e tyre lidhur me fshehtësinë e votës, sepse pasi u identifikuan si votues të pakicave kombëtare, ishte e ditur menjëherë se si kishin votuar. Në fund, dhe sipas mendimit të parashtresuesve përkatës, masa ishte diskriminuese pasi - për shkak të statusit të tyre të përkatësisë në një pakicë kombëtare - ata ishin trajtuar ndryshe nga votuesit e tjerë.
143. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtresuesve të lartcekur, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së. Në arsyetimin e shkeljes përkatëse, GJEDNJ, ndër tjerash, detajisht adresoi pretendimet lidhur me (i) mungesën e pretenduar të një zgjedhje të lirë për votuesit e pakicave kombëtare; dhe (ii) shkeljen e pretenduar të fshehtësisë së votimit.
144. Lidhur me të parën, përkatësisht mungesën e pretenduar të zgjedhjes së lirë për votuesit e pakicave kombëtare, GJEDNJ-ja vuri në dukje se si pasojë e regjistrimit si votues të pakicave kombëtare, parashtresuesit e kërkesës mund të votonin vetëm për listat e tyre përkatëse të pakicave kombëtare ose të abstenonin nga votimi për listën e pakicave kombëtare. Për pasojë, ata nuk kishin zgjedhje midis listave të ndryshme partiake dhe as ndonjë ndikim në radhën e zgjedhjes së kandidatëve nga listat e pakicave kombëtare. Në vijim dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, GJEDNJ theksoi që e drejta për të votuar përfshin mundësinë që votuesit të zgjedhin kandidatët ose listat e partive që pasqyrojnë më së miri pikëpamjet e tyre politike dhe rregulloret zgjedhore nuk duhet t'u kërkojnë votuesve që të përkrahin pozita politike që ata nuk i mbështesin. Sipas GJEDNJ-së, ndërkohë që sistemi i krijuar për votuesit e pakicave kombëtare nuk u bëri presion parashtresuesve të

kërkesës në zgjedhjen e një ose më shumë kandidatëve, ai nuk i lejonte ata të pasqyronin sinqerisht vullnetin e tyre si zgjedhës ose të hidhnin votën e tyre në promovimin e ideve dhe programeve politike të veprimit politik, ose për t'u shoqëruar për qëllime politike përmes votës. Me fjalë të tjera, parashtruesit e kërkesës, si votues të pakicave kombëtare, nuk mund të shprehnin pikëpamjet apo zgjedhjen e tyre politike në kutinë e votimit, por vetëm faktin se ata kërkonin përfaqësim në vendimmarrje politike si anëtarë të një grupi të pakicës kombëtare. GJEDNJ theksoi se ka dyshime se një sistem në të cilin vota mund të hidhet vetëm për një listë specifike të mbyllur të kandidatëve dhe që kërkon nga votuesit të braktisin përkatësitë e tyre partiake në mënyrë që të kenë përfaqësim si anëtar i një pakice, siguron “*shprehje të lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e legjislativit*” (paragrafët 64-66 të Aktgjykimit në rastin *Bakirdzi dhe E.C kundër Hungarisë*).

145. Ndërsa në lidhje me çështjen e dytë, përkatësisht shkeljen e pretenduar të fshehtësisë së votës, GJEDNJ-ja vuri në dukje se një sistem votimi duhet të sigurojë që votimi të kryhet me votim të fshehtë duke i lejuar elektoratit të ushtrojë votën e tij për një kandidat të preferuar lirisht dhe në mënyrë efektive, në përputhje me vetëdijen e tyre dhe pa ndikim, frikësim ose mosmiratim të panevojshëm nga të tjerët. Sipas GJEDNJ-së, kjo gjithashtu i shërben interesit më të madh publik për të siguruar zgjedhje të lira dhe të drejta. Në terma praktike, sipas GJEDNJ-së, çështja se për kë ka votuar një zgjedhës në një zgjedhje nuk duhet t'i bëhet e ditur publikut sepse sistemi i votimit duhet t'i sigurojë votuesit se ata nuk do të detyrohen drejtpërdrejt ose tërthorazi të tregojnë se për kë kanë votuar. GJEDNJ më tej shpjegoi se nuk ka asnjë pretendim nga parashtruesit e kërkesës se procedura në qendrat e votimit nuk siguronte fshehtësinë e votave të tyre, por përkundrazi se duke qenë se ata kishin vetëm një zgjedhje si votues të pakicave kombëtare, përzgjedhja e tyre zgjedhore në mënyrë të tërthortë iu zbulua të gjithëve. Sipas GJEDNJ-së, nëse një zgjedhës zgjedh të regjistrohesh si votues i pakicës kombëtare të një pakice të caktuar, ai ose ajo ka vetëm një zgjedhje dhe në praktikë do t'i jepet një fletëvotim me kandidatët e listës së pakicave kombëtare, në vend të fletëvotimit që ofron një zgjedhje midis kandidatëve të ndryshëm të partive politike. Prandaj, të gjithë të pranishmit në qendrën e votimit në kohën përkatëse, veçanërisht anëtarët e komisioneve përkatëse zgjedhore, do të kuptonin se zgjedhësi kishte hedhur votën për kandidatët në listën e pakicave kombëtare. Në mënyrë të ngjashme, votuesit e pakicave kombëtare mund të lidhen me votat e tyre gjatë procedurës së numërimit, veçanërisht në qendrat e votimit ku numri i votuesve të regjistruar të pakicës kombëtare ishte i kufizuar. Siç është e dukshme, sipas GJEDNJ-së, rregullimi i vendosur për votuesit e pakicave lejoi që detajet se si një votues i pakicës kombëtare kishte hedhur votën e tij ose të saj të dihej nga të gjithë dhe të mblidhej informata për qëllimet elektorale të votuesve të pakicës kombëtare sapo të jenë regjistruar si të tillë. Me fjalë të tjera, e drejta për fshehtësi të plotë nuk ishte në dispozicion për parashtruesit e kërkesës si votues të pakicës kombëtare. GJEDNJ theksoi se konsideron se votuesit që vendosin të hedhin votat e tyre si votues të pakicës kombëtare duhet të mbrohen në të njëjtën mënyrë si rregullat zgjedhore që mbrojnë të drejtën e votuesve që vendosin të hedhin votat e tyre në favor të një partie politike ose një kandidati të pavarur. Prandaj, sipas GJEDNJ-së, kërkohet të ruhet fshehtësia për të dyja kategoritë e personave. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së sistemi i votimit në listën e pakicave kombëtare nuk ishte në dispozicion për parashtruesit e kërkesës pa u cenuar e drejta e fshehtësisë së votës së tyre (paragrafët 68-71 të Aktgjykimit në rastin *Bakirdzi dhe E.C kundër Hungarisë*).
146. GJEDNJ-ja në fund përsëriti se çdo legjislacion zgjedhor duhet të vlerësohet në dritën e evolucionit politik të vendit në fjalë, në mënyrë që tiparet që do të ishin të papranueshme në kontekstin e një sistemi mund të justifikohen në kontekstin e një sistemi tjetër. GJEDNJ-ja gjithashtu vlerësoi se është e vetëdijshme se nuk ka asnjë kërkesë sipas Konventës për

trajtim të ndryshëm në favor të partive minoritare. Megjithatë, ajo vuri në dukje se sapo legjislatura vendos të krijojë një sistem që synon të eliminojë ose zvogëlojë rastet aktuale të pabarazisë në përfaqësimin politik, është e natyrshme që masa të kontribuojë në pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në baza të barabarta me të tjerët në zgjedhjen e legjislativit, në vend që të përjetësojë përjashtimin e përfaqësuesve të pakicave nga vendimmarrja politike në nivel kombëtar (shih paragrafin 73 të Aktgjykimit në rastin *Bakirdzi dhe E.C kundër Hungarisë*).

147. Ndërsa në kontekst të së drejtës pasive të votës, GJEDNJ, në rastin e saj *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* [DHM], nr. 27996/06 dhe 34836/06, Aktgjykim, i 22 dhjetorit 2009, shqyrtoi, ndër të tjerash, pamundësinë e parashtruesve përkatës, të cilin kishin identifikuar veten si pjesëtarë të komunitetit rom dhe me origjinë hebraike respektivisht, që të garojnë për zgjedhje në Dhomën e Përfaqësuesve dhe të Presidencës së Shtetit, për arsye se ata nuk kishin deklaruar përkatësinë e tyre me njërin nga “*popujt konstituentë*”, ashtu siç kërkohej me dispozitat e Kushtetutës së Bosnje dhe Hercegovinës. GJEDNJ gjeti se dispozitat kushtetuese, të cilat i pamundësuan parashtruesve garimin në zgjedhjet për Presidencën e Shtetit, ishin diskriminuese sipas nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Me atë rast, GJEDNJ, ndër tjerash, kishte vlerësuar:

“45. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se për të pasur të drejtën për t’u zgjedhur në Dhomën e Popullit (House of People) të Bosnjë-Hercegovinës, duhet të deklarohet përkatësia me njërin nga “*popujt konstituentë*”. Parashtruesit e kërkesës, të cilët e deklarojnë veten me origjinë rome dhe hebreje, respektivisht dhe që nuk dëshirojnë të deklarojnë përkatësinë me njërin nga “*popujt konstituentë*”, si rezultat i kësaj janë të përjashtuar (shih paragrafin 11 më lart). Gjykata vëren se ky rregull përjashtimi ndoqi të paktën një qëllim që është gjerësisht në përputhje me objektivat e përgjithshme të Konventës, siç pasqyrohet në Preambulën e Konventës, përkatësisht rivendosjen e paqes.[...]”

148. Ngjashëm, në rastin *Zornić kundër Bosnje dhe Hercegovinës* (nr. 3681/06, Aktgjykim, i 15 korrikut 2014) përkatësisht rrethanat e të cilit rast ngjashëm si me ato në rastin *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, ndërlidhen me atë se parashtruesja e kërkesës si rezultat i refuzimit të saj që të deklaronte afilimin e saj me njërin nga popujt konstituentë por thjesht deklarimit si qytetare e Bosnje dhe Hercegovinës iu ishte mohuar e drejta e saj për t’u zgjedhur në Dhomën e Përfaqësuesve dhe në Presidencën e Bosnje dhe Hercegovinës. Edhe në këtë rast, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së. Në këtë rast, GJEDNJ, ndër tjerash, kishte theksuar që konstatimi i shkeljes së nenit 14 në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së ishte rezultat i drejtpërdrejtë i dështimit të autoriteteve për vendosjen e mekanizmave për të siguruar pajtueshmërinë me Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së në rastin *Sejdić dhe Finci*. Sipas GJEDNJ-së, dështimi i autoriteteve shtetërore për të propozuar masa kushtetuese dhe legjislative për të përfunduar papajtueshmërinë e Kushtetutës dhe ligjit zgjedhor me KEDNJ-në, ishte një faktor rëndues që ndërlidhet me përgjegjësinë e shtetit bazuar në Konventë për gjendjen ekzistuese si dhe një kërcënim për efektivitetin e ardhshëm të makinerisë së Konventës.
149. Në fund, dhe në kontekst të nenit 15 të Konventës Kornizë, GJEDNJ, ndër tjerash, kishte theksuar që e njëjta nuk kërkon detyrimisht trajtim të ndryshëm për komunitetet pakicë dhe se çdo shtet ka lirinë e vlerësimit, përkatësisht përcaktimit të masave adekuate për të mbrojtur dhe promovuar komunitetet jo-shumicë, masa këto të cilat, pas miratimit, nuk mund të përbëjnë bazë për diskriminim. Më saktësisht, në rastin *Partei der Friesen kundër*

Gjermanisë, GJEDNJ, ndër tjerash, kishte theksuar që “ [GJEDNJ] në vijim vëren se Konventa Kornizë, përderisa njeh hapësirën e vlerësimit (margin of appreciation) të shteteve në çështjet zgjedhore, ajo vë në theks përfaqësimin e pakicave kombëtare në çështje publike (shih nenin 15 të Konventës). [...] Shtetet palë në Konventën Kornizë gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në mënyrën se si t'i qasen qëllimit të Konventës Kornizë për të promovuar pjesëmarrjen efektive të personave që u përkasin pakicave kombëtare në çështjet publike, siç përcaktohet në nenin 15 [të Konventës Kornizë]. Për rrjedhojë, [GJEDNJ] vlerëson se, edhe nëse interpretohet në dritën e Konventës Kornizë, Konventa nuk kërkon një trajtim të ndryshëm në favor të palëve të pakicave në këtë kontekst. 44. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 14 të [KEDNJ-së] në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1. (shih paragrafët 43 dhe 44).”

(v) Parimet e përgjithshme sipas Kodit të Praktikës së Mirë, opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias dhe dokumenteve tjera relevante të Këshillit të Evropës

150. Gjykata në vijim, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, do të elaborojë parimet dhe standardet e përgjithshme të zhvilluara përmes Kodit të Praktikës së Mirë, opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias dhe Komentarit të Komitetit Këshillëdhënës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.
151. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht vë në dukje se Kodi i Praktikës së Mirë të Çështjeve Zgjedhore, në pikën 2.4 [Barazia dhe Pakicat Kombëtare] të tij, përcakton lejimin e subjekteve politike që përfaqësojnë pakicat kombëtare dhe se rregullat specifike që pakicave kombëtare iu garantojnë vende të rezervuara në parim nuk janë në kundërshtim me votën e barabartë dhe se as kandidatët e as votuesit nuk janë detyruar që të zbulojnë përkatësinë e tyre si pakicë kombëtare.
152. Më tej dhe në pikën 4 të po këtij kodi, përcaktohet që për votuesit, fshehtësia e votës nuk është vetëm një e drejtë por edhe detyrim, mosrespektimi i të cilit duhet të jetë i dënueshëm me diskualifikim të çdo vote përmbajtja e të cilës është zbuluar. Më saktësisht, në pikën 4 të këtij Kodi përcaktohet që:

[...]

“b. Vota është individuale. Vota familjare ose çdo formë e kontrollit të votuesit për votën e tij nga tjetri është i ndaluar.

c. Lista e personave të cilët votojnë nuk duhet publikuar.

d. Cenimi i votimit të fshehtë duhet që të sanksionohet.”

153. Gjykata vëren se në lidhje me pikën 2.4 në Raportin Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë, ndër tjerash, është theksuar se: “Disa masa të marra për të siguruar përfaqësimin minimal për pakicat ose duke rezervuar vende për to ose duke parashikuar përjashtime ndaj rregullave normale mbi shpërndarjen e vendeve, p.sh. duke hequr dorë nga kuorumi për partitë e pakicave kombëtare nuk shkelin parimin e barazisë. Mund të parashikohet gjithashtu se individët që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të votojnë si për listat e përgjithshme, ashtu edhe për ato kombëtare të pakicave. Megjithatë, as kandidatëve dhe as votuesve nuk duhet t'u kërkohej të tregojnë përkatësinë e tyre me ndonjë pakicë kombëtare.”
154. Më tej, në Komentarin e Komitetit Këshillëdhënës për Konventën Kornizë, i 27 shkurtit në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë, ndër tjerash, theksohet se:

80. Pjesëmarrja e personave që i përkasin pakicave kombëtare në proceset zgjedhore është shumë e rëndësishme për t'u bërë të mundur minoriteteve të shprehin pikëpamjet e tyre kur hartohen masa legjislative dhe politika publike me rëndësi për ta.

81. Duke pasur parasysh se shtetet palë janë sovraane për të vendosur për sistemet e tyre zgjedhore, Komiteti Këshillëdhënës ka theksuar se është e rëndësishme t'i jepen mundësi pakicave në fjalë të përfshihen në agjendat publike. Kjo mund të arrihet ose nëpërmjet pranisë së përfaqësuesve të pakicave në organet e zgjedhura dhe/ose nëpërmjet përfshirjes së shqetësimeve të tyre në agjendën e organeve të zgjedhura.

82. Komiteti Këshillëdhënës ka vënë re se kur ligjet zgjedhore parashikojnë kërkesën e pragut, duhet të merret parasysh ndikimi i tyre i mundshëm negativ mbi pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në procesin zgjedhor. Përrjashtimet nga kërkesat e pragut kanë rezultuar të dobishme për të rritur pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në organet e zgjedhura.”

(vi) Parimet e përgjithshme sipas rekomandimeve të LUND-it

155. Gjykata në vijim, do të elaborojë parimet e përgjithshme të reflektuara në rekomandimet e LUND-it, të OSBE-së, të cilat në kontekst të zgjedhjeve rekomandojnë që: (i) shtetet duhet të garantojnë të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare për pjesëmarrje në jetën publike duke përfshirë të drejtën për votim dhe kandidim për funksion publik pa asnjë diskriminim; (ii) Rregullimi i formimit dhe aktivitetit të partive politike duhet të përputhet me parimet e ligjit ndërkombëtar për lirinë e asociimit, i cili parim përfshin lirinë e formimit të partive politike të bazuara në identitetet e bashkësive si dhe të atyre që nuk identifikohen vetëm me interesat e ndonjë komuniteti; dhe (iii) Sistemi zgjedhor duhet të mundësojë përfaqësimin dhe ndikimin e pakicave.

156. Në sqarimet e këtyre Rekomandimeve nënvizohet se: “7) Përfaqësimi qeveritar nëpërmjet zgjedhjeve të lira, fer dhe periodike është gurrthemel i demokracisë bashkëkohore. Qëllimi kryesor sipas fjalëve të nenit 21 (3) të Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut është se “vullneti i njerëzve do të jetë baza për kryerjen e qeverisjes”. Ky standard kryesor artikullohet në marrëveshjet univervale dhe evropiane, respektivisht në nenin 25 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe neni 3 i Protokollit 1 [...] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për shtetet e OSBE-së, paragrafët 5 dhe 6 të Dokumentit të Kopenhagës vërtetohet se “përmes elementeve të drejtësisë që janë qenësore për shprehjen e dinjitetit dhe për të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjitha qenieve njerëzore”, “vullneti i njerëzve i shprehur lirë dhe fer nëpërmjet zgjedhjeve periodike dhe të vërteta, është baza e autoritetit dhe legjitimitetit të çdo qeverisjeje”.

(vii) Konkluzion përkitazi me dispozitat kushtetuese, parimet e zhvilluara nga GJEDNJ, praktika gjyqësore e Gjykatës, të mekanizmave të Këshillit të Evropës dhe të OSBE-së

157. Bazuar në dispozitat kushtetuese dhe atyre të instrumenteve ndërkombëtare, praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, opinionet dhe raportet e Komisionit të Venecias në çështje zgjedhore dhe Komentarin e Komitetit Këshillëdhënës për Konventën Kornizë dhe rekomandimeve të LUND-it, Gjykata vëren se të lartcekurat në mënyrë të përmbledhur dhe ndër tjerash, në parim dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, përfshijnë si në vijim: (i) në kuptim të nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur, si për individët ashtu edhe për subjektet politike, në cilësi të personave juridikë; (ii) neni 45 i Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së përfshin garancione përmbajtësore, siç është vota është personale, e lirë, e barabartë dhe e

fshehtë; (iii) Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore thekson se as kandidatëve dhe as votuesve nuk duhet t'u kërkohej të tregojnë përkatësinë e tyre etnike; dhe (iv) shtetet anëtare të Konventës Kornizë kanë hapësirë dhe liri vlerësimi për të vendosur për sistemet e tyre zgjedhore.

158. Në vijim dhe në dritën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (PLE), Gjykata do të vlerësojë nëse Gjykata Supreme në vendimmarrjen e saj ka interpretuar dhe aplikuar këto parime dhe garanci të lartcekura të vendosura përmes dispozitave kushtetuese, instrumenteve relevante ndërkombëtare, praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias në çështje zgjedhore, Komentarin e Komitetit Këshillëdhënës për Konventën Kornizë dhe Rekomandimeve të LUND-it. Në këtë kuptim, dhe marrë parasysh karakteristikat dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të referohet garancive përmbajtësore të të drejtave zgjedhore në aspektin aktiv dhe pasiv të votës në kontekste pas-zgjedhore.

II. Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

159. Gjykata fillimisht rikujton që kërkesa e parashtruesit të kërkesës para Gjykatës, ndërlidhet me dy çështje kryesore, përkatësisht kërkesën që Gjykata (i) të anulojë vetëm pjesërisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, përkatësisht të obligojë të njëjtën që të anulohet/shpallë të pavlefshme proporcionalisht edhe fletëvotimet në vendvotimet e saktësuara në Graçanicë, Kamenicë dhe Mitrovicë të Veriut, në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë arritur votat e nevojshme për tu bërë deputet, si dhe pastaj të urdhërojë zëvendësimet eventuale të deputetëve në Kuvendin e Kosovës; dhe (ii) *“të konstatojë obligimin e Kuvendit që të nxjerrë legjislacionin përkatës në mënyrë që përgjegjësitë shtetërore për garantim të pjesëmarrjes efektive të komuniteteve sipas nenit 58(4) të Kushtetutës të përmbushen”* (pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë paraqitur detajisht në paragrafët 56-66 të këtij Aktgjykimi).
160. Më saktësisht, përkitazi me çështjen parë, parashtruesi i kërkesës, thekson që e drejta e parashtruesit të kërkesës për tu zgjedhur deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit 2021 është cenuar si rezultat i refuzimit të anulimit/shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotimet e saktësuara në tri komunat e lartcekura. I njëjti, dhe siç është shtjelluar në pjesën që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesit të kërkesës së këtij Aktgjykimi, në esencë, thekson që (i) fletëvotimet në vendvotimet përkatëse do të duhej të anulohen/shpallen të pavlefshme në proporcion me numrin e votuesve që përfaqësojnë komunitetin përkatës sepse në të kundërtën, përfaqësuesit të zgjedhur në Kuvend i *“mungon lidhja objektive me komunitetin”* që i njëjti deklaron që përfaqëson; dhe (ii) vendet e garantuara në Kuvend sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës mund të fitohen vetëm nëse votohen nga i njëjti komunitet të cilin partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur që garojnë për këto vende deklarojnë që i përfaqësojnë. Thënë këtë, parashtruesi i kërkesës, vet thekson që *“nuk ka praktika dhe norma precize ndërkombetare, as në kuadër të Këshillit të Evropës e as gjetiu, të cilat në mënyrë shprehimore përcaktojnë që në ulëse të garantuara duhen zgjedhur në çdo vend dhe çdo rast përfaqësues vetëm me vota që vijnë nga pjesëtarët e komunitetit të cilit ai përfaqësues i takon”*, dhe në mungesë të një baze ligjore pretendon që bazuar në paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës, Gjykata duhet të detyrojë Kuvendin që të ndërmerr masa adekuate, përmes nxjerrjes së ligjeve, përmes të cilave, do të sigurohet pjesëmarrja efektive e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, ashtu që dhe ndër tjerash, vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës do të fitoheshin vetëm nëse votohen nga anëtarët e të njëjtit komunitet të cilin ata deklarojnë që e përfaqësojnë dhe me saktësisht që *“komunitetet do të regjistrohen në lista zgjedhore të*

veçanta (separate communal/electoral rolls) ashtu qe vetëm votuesit e komuniteteve që gjenden në ato lista të mund të votojnë për përfaqësuesit që janë deklaruar se do ti përfaqësojnë ato komunitete në ulëset e garantuara”.

161. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht (i) do të vlerësojë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, për aq sa është kontestuar nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht refuzimin e Gjykatës Supreme që të anulohen/shpallen të pavlefshme edhe fletëvotimet në vendvotimet e saktësuara në komunat e Graçanicës, Kamenicës dhe Mitrovicës së Veriut; dhe më pas (ii) do të adresojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës bazuar në të cilat Gjykata duhet të detyrojë Kuvendin të nxjerr ligj.

(i) nëse refuzimi i anulimit/shpalljes së pavlefshme të votave në komunat e Graçanicës dhe Kamenicës ka cenuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për tu zgjedhur në kundërshtim me garancitë e saktësuara në paragrafin 1 të nenit 45 të Kushtetutës

162. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me refuzimin e PZAP-së dhe konfirmimin pasues të Gjykatës Supreme për anulimin/shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotimet në komunat e Graçanicës, Kamenicës dhe Mitrovicës së Veriut, Gjykata fillimisht dhe siç është sqaruar në përmbledhjen e fakteve të këtij Aktgjykimi, sqaron që vendimi i PZAP-së i 7 marsit 2021, nuk kishte vendosur lidhur me ankesat/apelet përkitazi me komunën e Mitrovicës së Veriut. Për pasojë, dhe pas ankesave përkatëse, PZAP kishte vendosur përkitazi me fletëvotimet në komunën e Mitrovicës së Veriut më 10 mars 2021. Këtë vendim të PZAP-së, parashtruesi i kërkesës nuk e kishte apeluar në Gjykatën Supreme. Për pasojë, i njëjti, nuk i ka shteruar mjetet juridike siç janë të përcaktuara në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës për të kontestuar refuzimin e anulimit/shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve në komunën e Mitrovicës së Veriut. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit të kërkesës mund të i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë vetëm përkitazi me refuzimin e anulimit/shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotimet e caktuara në komunat e Graçanicës dhe Kamenicës, respektivisht.
163. Në vijim, Gjykata sqaron që bazuar në nenin 53 të Kushtetutës, ajo është detyruar që të drejtat dhe liritë themelore ti interpretojë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe në kontekst të të drejtave zgjedhore, në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në kontekst të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes të cilës, ndër tjerash, në aspekt të kontesteve pas-zgjedhore është vlerësuar përputhshmëria me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së e anulimit, përkatësisht shpalljes së pavlefshme të votave, Gjykata i referohet rasteve të GJEDNJ-së, *Kovach kundër Ukrainës, Kerimova kundër Azerbajxhanit dhe Riza dhe të tjerët kundër Bullgarisë*.
164. Më saktësisht, rasti *Kovach kundër Ukrainës* (kërkesa nr. 39424/02, Aktgjykim, i 7 shkurtit 2008) kishte të bënte me mënyrën në të cilën rezultati i zgjedhjeve ishte shqyrtuar nga autoritetet vendore përgjegjëse. Rrethanat e rastit ndërlidhen me një kandidat që kishte garuar në zgjedhje dhe i cili kishte marrë numër më të madh votash se kundërkandidati përkatës. Megjithatë autoritetet kompetente kishin anuluar/shpallur të pavlefshme një numër votash, duke u bazuar në një dispozitë ligjore, sipas të cilës, votat do të mund të shpalleshin të pavlefshme, nëse “*rrethana tjera e bëjnë të pamundur përcaktimin e rezultateve qe reflektojnë vullnetin e votuesve*”. Në vlerësimin e GJEDNJ-së, një bazë e tillë

ligjore nuk ishte e mjaftueshme për të justifikuar anulimin e votave, sepse dhe ndër tjerash, nuk kishte asnjë dispozitë ligjore apo praktikë të brendshme që mund të shpjegonte se cilët faktorë mund të konsideroheshin si “*rrethana tjera që e bëjnë të pamundur përcaktimin e rezultateve që reflektojnë vullnetin e votuesve*”. Sipas GJEDNJ-së, mungesa e qartësisë së dispozitës ligjore në fjalë dhe rrjedhimisht rreziqet e mundshme ndaj të drejtave zgjedhore kërkonin kujdes të veçantë nga ana e autoriteteve vendore dhe për pasojë, GJEDNJ arriti në përfundimin se vendimi për anulimin e votimit në katër divizionet zgjedhore duhej të konsiderohej si arbitrar dhe jo proporcional dhe për pasojë, cenim i garancive të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih arsyetimin e GJEDNJ-së në paragrafët 59-61 të Aktgjykimit).

165. Më tej, rasti *Kerimova kundër Azerbajxhanit* (kërkesa nr. 20799/06, Aktgjykim, i 30 shtatorit 2010), gjithashtu kishte të bënte me mënyrën në të cilën rezultati i zgjedhjeve ishte shqyrtuar nga autoritetet vendore përgjegjëse. Rrethanat e këtij rasti gjithashtu ndërlidhen me një kandidat në zgjedhje dhe i cili kishte marrë numrin më të madh të votave por një pjesë e të cilave më pas ishte anuluar nga autoritetet kompetente zgjedhore. Për më tepër, në këtë rast, autoritetet përkatëse gjithashtu kishin vërtetuar që dy zyrtarë të zgjedhjeve kishin manipuluar me procesin zgjedhor. Megjithatë, dhe përkundër që një manipulim i tillë ishte konfirmuar nga autoritetet kompetente, sipas GJEDNJ-së, autoritetet zgjedhore, kishin vendosur që të shpallin të pavlefshme vota në një numër vendvotimesh, pa bazë të qartë ligjore dhe pa vlerësuar nëse manipulimi i zyrtarëve përkatës mund të kishte qenë i përmasave të tilla që të ndryshonte vullnetin e votuesve në zonën e caktuar dhe për më tepër, pa arsyetuar pse nuk i kanë shfrytëzuar dispozitat ligjore përmes të cilave votat do të mund të ishin rinumëruar apo/edhe të ishte urdhëruar rivotimi në zona të caktuara. Sipas GJEDNJ-së, shpallja e pavlefshme e votave kishte rezultuar në cenim të të drejtave zgjedhore të parashtrueses përkatëse në kundërshtim me garancitë e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, roli i gjykatave nuk është të modifikojnë shprehjen e vullnetit të votuesve (shih arsyetimin e GJEDNJ-së në paragrafët 52-54 të Aktgjykimit).
166. Nga ana tjetër, në rastin *Riza dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (kërkesa nr. 48555/10 dhe 48377/10, Aktgjykim, i 13 tetorit 2015), rezultatet e 23 qendrave të votimit të ngritura jashtë vendit ishin shpallur të pavlefshme për shkak të parregullsive të pretenduara, duke i hequr të drejtën e mandatit një deputeti. GJEDNJ shqyrtoi si ndërhyrje në të drejtën e votës të 101 zgjedhësve, edhe të drejtën për t'u zgjedhur për deputet dhe partinë që ai përfaqësonte. GJEDNJ konstatoi se për të shpallur të pavlefshme zgjedhjet në një numër qendrash votimi ishin dhënë vetëm arsyeime të pastra formale. Për më tepër, rrethanat në të cilat gjykata u mbështetet për të arsyetuar vendimin e saj nuk ishin parashikuar, në mënyrë mjaft të qartë dhe të parashikueshme, në legjislacionin vendor dhe nuk ishte treguar se ato do të kishin ndryshuar zgjedhjen e votuesve ose shtrembëruar rezultatin e zgjedhjeve. Përveç kësaj, ligji zgjedhor nuk parashikonte mundësinë e organizimit të zgjedhjeve të reja në qendrat e votimit ku fleta e votimit ishte shpallur e pavlefshme – në kundërshtim me Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias – që do të kishte barazuar qëllimin legjitim të ndjekur nga anulimi i rezultateve të zgjedhjeve, përkatësisht ruajtja e ligjshmërisë së procesit zgjedhor, me të drejtat subjektive të zgjedhësve dhe kandidatëve në zgjedhjet parlamentare. Si rrjedhojë, GJEDNJ konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih konkludimin e GJEDNJ-së në paragrafët 176-179 të Aktgjykimit).
167. Bazuar në të lartcekurat, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, është e rëndësishme të theksohet që sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (i) nuk është roli i gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve; (ii) në vlerësimin nëse fletëvotimet në një

zonë zgjedhore mund të shpallen të pavlefshme, autoritetet përkatëse duhet të bazohen në dispozita të qarta të ligjore; dhe (iii) ndër tjerash, në rastin *Kovach kundër Ukrainës*, GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së edhe në rrethanat kur autoritetet përkatëse ishin referuar në një bazë ligjore e cila mundësonte shpalljen e pavlefshme të votave, por e cila sipas GJEDNJ-së nuk ishte mjaftueshëm e qartë për të pamundësuar arbitraritetin e autoriteteve përkatëse në anulimin, përkatësisht shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve dhe të cilat e kishin afektuar rezultatin zgjedhor.

168. Bazuar në praktikën e lartcekur të GJEDNJ-së, dhe që vë theks në faktin që (i) nuk është roli i gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve; dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e votave duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse në Republikën e Kosovës, ka bazë kushtetuese dhe ligjore, për të shpallur të pavlefshme fletëvotime bazuar në përkatësinë etnike të votuesve dhe/ose detyrim sipas të cilit partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur që garojnë për vendet e garantuara sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës duhet të votohen vetëm nga votuesit përkatësinë etnike të të cilave ato deklarohen që e përfaqësojnë.
169. Fillimisht dhe në kontekst të vlefshmërisë dhe/ose pavlefshmërisë së fletëvotimeve, Gjykata fillimisht rikujton nenin 64 të Kushtetutës, dhe sipas të cilit, dhe ndër tjerash, vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. Në anën tjetër, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, përderisa nuk përcakton kriteret mbi bazën e të cilave mund të konstatohet vlefshmëria dhe/ose pavlefshmëria e votave, bazuar në nenin 115 (Emërimi i Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa) të tij, përcakton PZAP-në si organ të përhershëm dhe të pavarur e kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore, duke përfshirë kompetencën për të anuluar/shpallur fletëvotime të pavlefshme ne rrethana të jashtëzakonshme por gjithnjë bazuar në rregullativën e aplikueshme.
170. Më saktësisht, bazuar në nenin 117 (Procedurat e [PZAP-it]) të ligjit të lartcekur, (i) PZAP-i vendos rregullat dhe procedurat e tij; (ii) gjatë vendosjes për një ankesë ose apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se e konsideron këtë të nevojshme; (iii) vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse; dhe (iv) PZAP-i mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën ose apelin. Më tej dhe bazuar në nenin 120 (Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve), ndër tjerash, dhe në rrethana të jashtëzakonshme, PZAP, mund të anulojë rezultatet zgjedhore në një vendvotim apo të udhëzoj KQZ-në të urdhëroj përsëritjen e votimit në një qendër votimi. Në fund dhe bazuar në nenin 118 (Vendimet) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, vendimet e PZAP-së mund të kontestohen në Gjykatën Supreme, dhe në të cilën ankesa pranohet (i) në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa 5,000 euro; dhe (ii) në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Bazuar në nenin 106 (Rezultatet zgjedhore) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ.
171. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata thekson se, kriteret mbi bazën e të cilave votat mund të shpallen të pavlefshme, janë të përcaktuara në rregullativën e KQZ-së, përkatësisht, (i) Rregullën Zgjedhore nr. 06/2013 lidhur me Qendrat e Numërimit dhe e Rezultateve; dhe (ii) Rregullën Zgjedhore nr. 09/2013 lidhur me Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Qendrës së Votimit. E para në nenin 7 (Numërimi i fletëvotimeve në QNR)

të saj saktëson rastet kur një fletëvotim konsiderohet i pavlefshëm, përkatësisht nëse (i) në fletëvotim është shënuar më shumë se një subjekt politik; (ii) mënyra se si është shënuar fletëvotimi e bën qëllimin e votuesit të paqartë; (iii) nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve, përveç nëse është fletëvotim për votim përmes postës, i cili nuk kërkohet të vuloset; dhe (iv) është fletëvotim për votim përmes postës që nuk është fletëvotim i pranueshëm siç përcaktohet në Rregullën e Zgjedhjeve nr. 03/2013, Votimi jashtë Kosovës. Ndërsa e dyta, në nenin 21 (Procesi i numërimit në vendvotimet e rregullta), përkatësisht pikën 21.10 përcakton saktë rrethanat në të cilat një fletëvotim duhet të konsiderohet i pavlefshëm, përkatësisht nëse (i) në fletëvotim është shënuar më shumë se një subjekt politik; (ii) mënyra se si është shënuar fletëvotimi e bën qëllimin e votuesit të paqartë; (iii) nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve, kur është nxjerrë nga kutia e votimit; dhe (iv) votuesi e shënon vetëm kandidatin dhe jo subjektin politik. As Ligji dhe as rregullativa e KQZ-së, nuk përcakton asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve.

172. Thënë këtë, Gjykata rikujton që në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, PZAP dhe Gjykata Supreme, përderisa kishin refuzuar anulimin/shpalljen e pavlefshme të votave në komunat e Graçanicës dhe Kamenicës, respektivisht, përmes të njëjtave vendime kishin vendosur dhe konfirmuar shpalljen e pavlefshme të fletëvotimet në vendvotimet e saktësuara në komunat e Leposaviqit, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit dhe Klokotit. Në konfirmimin e anulimit/shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve të saktësuara përmes vendimit të PZAP-së të 7 marsit 2021, Gjykata Supreme, ndër tjera, kishte theksuar si në vijim, (i) *“secili komunitet ka të drejtën të zgjedh përfaqësuesit e tij, dhe këtë të drejtë të garantuar, shteti e ka për obligim që ta mbrojë, pasi mbrojta e këtyre të drejtave është obligim kushtetues i cili bazohet në nenin 58, paragrafët 4 dhe 7 të Kushtetutës”* dhe në këtë kontekst specifik, konkludoi se marrë për bazë se tri komuniteteve që nuk janë shumicë, përkatësisht, atij rom, ashkali dhe egjiptian, i garantohet nga një vend i përfaqësimit në Kuvend dhe një vend shtesë i takon edhe njërit nga këto tri komunitete, zgjedhja e përfaqësuesit rom me votat e komuniteteve të tjera, nuk përfaqëson zgjedhjen dhe realizimin e përfaqësimit të komunitetit rom, *“pasi vetëm votat e komunitetit rom përfaqësojnë vullnetin e tyre, dhe në asnjë formë nuk mund të konsiderohet se kemi përfaqësim të komunitetit joshumicë, sipas vendeve të rezervuara, deri sa nuk është zgjedhur nga vet votat e komunitetit vendi i të cilit është i rezervuar”*; (ii) se në pesë (5) komuna, në të cilat janë anuluar fletëvotimet e subjektit politik Romani Iniciyativa, *“ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara e të cilat vota janë fituar nga votës të cilët janë të komunitetit tjetër në krahasim me komunitetin e subjektit për të cilin ka votuar, kjo vërtetohet nga numri i banorëve në krahasim me numrin e votave të marra, ndërsa numri i banorëve pasqyrohet përmes të dhënave të marra nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës të vitit 2011, por edhe raporteve kredibile të OSBE-së dhe Librat e Votuesve.”*; (iii) në rastin konkret *“nuk ekziston lidhje objektive në mes të votuesve dhe subjektit të votuar”*, edhe pse ky kusht është i domosdoshëm për të konsideruar se përfaqësimi është realizuar konform me dispozitat ligjore dhe kushtetuese për vendet e rezervuara të komuniteteve që nuk janë shumicë; (iv) *“në rastin konkret garojnë parimet, por parimi i garantimit të përfaqësimit të komuniteteve, kur bëhet fjalë për vendet e rezervuara sipas ligjit dhe kushtetutës, mbizotëron mbi çdo parim tjetër, pasi edhe neni 45 i Kushtetutës është në funksion të zbatimit të përfaqësimit të barabartë nga komunitetit konform ligjit dhe kushtetutës, por edhe praktikës së krijuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*; (v) në kuptim të konceptit të demokracisë konsociacionale theksoi se *“përtej kornizës kushtetuese, dispozitat ligjore për vendet e rezervuara kanë premisa të këtij koncepti, e të cilat e diktojnë ruajtjen e përfaqësimit efektiv të komuniteteve përmes mekanizmave të cilat në radhë të parë garantojnë të drejtën e votës, por brenda kësaj kornize edhe të drejtën e*

përfaqësimi për komunitetet nga përfaqësues me lidhje objektive me komunitetin, posaçërisht lidhja e përkatësisë etnike, pa përjashtuar edhe gjuhën etj.” dhe “në Kushtetutën e Republikës, përmes vendeve të rezervuara për komunitete jo shumicë është synuar përfaqësimi i të gjitha grupeve në organin përfaqësues, andaj për këtë përfaqësimi duhet të ekzistojë një lidhje objektive në mes të përfaqësuesve dhe votuesve të komunitetit përkatës, përndryshe deformohet përfaqësimi efektiv i komuniteteve për të cilat Kushtetuta ka garantuar vendet e rezervuara [...]” dhe, në lidhje me këtë Gjykata Supreme ka theksuar se (vi) nuk promovon konceptin e demokracisë konsociacionale përtej kornizës kushtetuese, por interpreton se dispozita ligjore dhe kushtetuese për vendet e rezervuara “kanë premisa të këtij koncepti, e të cilat e diktojnë ruajtjen e përfaqësimit efektiv të komuniteteve përmes mekanizmave të cilat në radhë të parë garantojnë të drejtën e votës, por brenda kësaj kornize edhe të drejtën e përfaqësimit për komunitetet nga përfaqësues me lidhje objektive me komunitetin, posaçërisht lidhja e përkatësisë etnike pa përjashtuar edhe gjuhën etj.”

173. Gjykata, vëren që sipas arsyetimit të Gjykatës Supreme, në esencë, në kontekst të zgjedhjeve parlamentare, e drejta aktive dhe pasive e votës janë të kufizuara nga përkatësia etnike. Më saktësisht, sipas arsyetimit të lartcekur (i) komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë në kontekst të së drejtës aktive të votës janë të kufizuara të votojnë, përkatësisht të zgjedhin vetëm kandidatët e komunitetit të njëjtë; (ii) në kontekst të së drejtës pasive të votës, të votohen, përkatësisht të zgjedhen vetëm nga komuniteti i njëjtë; dhe (iii) përkundër mungesës të një mekanizmi të përcaktuar në Kushtetutë dhe/ose ligj, të gjitha votat në një vendvotim të caktuar që e tejkalojnë numrin e qytetarëve të një përkatësie etnike, duhet të shpallen të pavlefshme, sipas PZAP dhe Gjykatës Supreme, bazuar në të dhëna të “*Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës të vitit 2011, por edhe raporteve kredibile të OSBE-së dhe Librat e Votuesve.*”
174. Në kontekst të këtij interpretimi të PZAP-së dhe të Gjykatës Supreme, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, thekson që çështja thelbësore ndërlidhet me atë nëse (i) në rendin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, ushtrimi i të drejtave të garantuara përmes nenit 45 të Kushtetutës është i kushtëzuar nga përkatësia etnike; dhe (ii) nëse autoritetet përkatëse, përkatësisht KQZ, PZAP por edhe Gjykata Supreme, mund të shpallin të pavlefshme fletëvotime apo të konfirmojnë pavlefshmërinë e tyre bazuar në përkatësinë etnike të votuesve, përkatësisht siç është rasti në rrethanat e rastit konkret, shpalljen e pavlefshme të votave në një vendvotim në momentin kur tejkalohet proporcioni në mes votave të fituara nga partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin përkatës dhe numrin e votuesve që supozohet që përfaqësojnë të njëjtin komunitet bazuar në të “*dhëna të marra nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës të vitit 2011, por edhe raporteve kredibile të OSBE-së dhe Librat e Votuesve.*”
175. Gjykata tashmë sqaroi që një bazë e tillë për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve nuk është e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme apo/edhe rregullativën e aplikueshme të KQZ-së e cila në fakt është shumë e qartë dhe specifike kur përcakton rrethanat në të cilat mund të anulohen fletëvotimet, fakt ky të cilin vet KQZ e kishte theksuar në përgjigjen përkatëse në PZAP ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës. Thënë këtë, duke marrë parasysh që PZAP dhe Gjykata Supreme, në shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në pesë (5) komunat e lartcekura ishte referuar në paragrafin 4 të nenit 58 dhe paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës, duke e anashkaluar nenin 45 të Kushtetutës, Gjykata në vijim, duhet të shtjellojë, nëse Kushtetuta, përfshirë instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare siç janë saktësuar në këtë Aktgjykim por edhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, mundësojnë shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve duke u bazuar në supozimin që në kontekst të

vendeve të garantuara sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, ushtrimi i të drejtave aktive dhe pasive zgjedhore është e kushtëzuar në përkatësi etnike. Në këtë kontekst, Gjykata vë theks edhe një herë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila bazuar në nenin 53 të Kushtetutës është e detyrueshme në interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore, dhe sipas të cilës e siç është sqaruar më lart, në konteste pas-zgjedhore fletëvotimet mund të shpallen të pavlefshme nga autoritetet kompetente vetëm sipas bazave të specifikuara kushtetuese dhe/ose ligjore.

176. Gjykata gjithashtu rikujton që në shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në pesë komunat e lartcekura, interpretimi i PZAP-së dhe i Gjykatës Supreme, ishte bazuar në paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës dhe nenit 15 të Konventës Kornizë. Në kontekst dhe fillimisht, Gjykata rikujton nenin 15 të Konventës Kornizë dhe i cili është drejtpërdrejtë i aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe i cili saktëson që secili shtet duhet të krijojë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta. Ky detyrim në fakt, është gjithashtu pjesë e Kushtetutës së Kosovës, i përcaktuar edhe përmes paragrafit 4 të nenit 58 të saj, dhe bazuar në të cilin, Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje dhe se masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.
177. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që neni 45 i Kushtetutës është neni themelor që rregullon të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes. I njëjti përcakton që (i) çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor, duke garantuar kështu të drejtën aktive dhe pasive zgjedhore siç është përcaktuar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së; (ii) që vota është “personale”, e “barabartë”, “e lirë” dhe “e fshehtë”; dhe (iii) institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.
178. Përtej nenit 45 të Kushtetutës, neni 22 i Kushtetutës, gjithashtu përcakton zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të instrumenteve ndërkombëtare dhe të cilat garantojnë të drejta zgjedhore, përfshirë KEDNJ-në, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj. Këto instrumente ndërkombëtare dhe siç është sqaruar në pjesën e parimeve të përgjithshme të këtij Aktgjykimi, të lexuara së bashku dhe në parim, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, garantojnë (i) organizimin e zgjedhjeve të lira në intervale të arsyeshme kohore; dhe (ii) votim të fshehtë dhe të të barabartë dhe shprehje të lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e organizmit ligjvënës sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.
179. Bazuar në dispozitat e Kushtetutës, aspekti aktiv i të drejtave zgjedhore, përkatësisht drejta për të zgjedhur, i nënshtrohet vetëm dy kufizimeve kushtetuese, moshës dhe vendimit përkatës gjyqësor. Të njëjtat të drejta janë të garantuara edhe përmes Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ky i fundit, në Kreun II, përcakton të Drejtën për të Votuar, Listat e Votuesve dhe Periudhat e Kundërshtimit dhe Konfirmimit për Listën e Votuesve. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, në nenin 5 (E drejta për të Votuar) të tij, përcakton edhe disa kufizime që ndërlidhen me të drejtën për të votuar, ndërsa në nenin 7 (Lista e Votuesve) përcakton që qytetarët me të drejtë vote janë ata të

regjistruar në Regjistrin Qendror Civil, duke saktësuar që informatat e nevojshme për Listën e Votuesve janë *“emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar”*, të dhëna këto që shënohen në gjuhët dhe alfabetet në të cilat shënimet origjinale mbahen në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë. Ligji dhe rregullativa e aplikueshme e KQZ-së, nuk përmban asnjë detyrim të vetëm që votuesit të deklarojnë përkatësinë e tyre etnike për qëllime të Listës së Votueseve dhe ushtrimit të të drejtave aktive zgjedhore. Një qasje e tillë në fakt është në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare, duke përfshirë siç është sqaruar përmes Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore, dhe sipas të cilës, e ndër tjerash, as kandidatëve dhe as zgjedhësve nuk duhet t'u kërkohej të tregojnë përkatësinë e tyre të një pakice kombëtare. Karakteristikat e votës që ndërlidhen me lirinë dhe fshehtësinë e saj janë të garantuara me të gjitha instrumentet ndërkombëtare, siç është sqaruar në pjesën e parimeve relevante të këtij Aktgjykimi.

180. Ndërsa, në kontekst të së drejtës t'u zgjedhur, përkatësisht aspektit pasiv të të drejtave zgjedhore, neni 45 i Kushtetutës, me përjashtim moshës dhe kufizimit përmes vendimit gjyqësor, nuk përcakton asnjë kufizim apo kushtëzim tjetër. Megjithatë, në kontekst të zgjedhjeve parlamentare, ky nen duhet të lexohet dhe interpretohet së bashku edhe me nenet 64 [Struktura e Kuvendit], 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore] dhe 73 [Pamundësia e Kandidimit] të Kushtetutës, respektivisht. I pari, përcakton që njëzet (20) vende në Kuvendin e Kosovës janë të garantuara për partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb ose komunitetet tjera, pa marrë parasysh numrin e vendeve të fituara, ndërsa i dyti dhe i treti, përcaktojnë kualifikimet e nevojshme për të kandiduar dhe rrethanat e pamundësisë së kandidimit për deputetë të Kuvendit. Për rrethanat e rastit konkret, relevante është ndërlidhshmëria e neneve 45 dhe 64 të Kushtetutës, respektivisht.
181. Në këtë kontekst, Gjykata së pari rithekson që neni 45 i Kushtetutës, garanton të drejtën aktive dhe pasive të votës, përkatësisht të drejtën për të zgjedhë dhe për tu zgjedhur, dhe saktëson që kjo votë është personale, e barabartë, e lirë dhe fshehtë. Në anën tjetër, votën e fshehtë e thekson edhe neni 64 i Kushtetutës, duke vënë theks gjithashtu në lista të hapura zgjedhore. Ky nen gjithashtu thekson që (i) Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura; dhe (ii) vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.
182. Thënë këtë, dhe në përjashtim të këtij parimi të përgjithshëm dhe pa marrë parasysh numrin e votave, përkatësisht vendeve të fituara, neni 64 i Kushtetutës, saktëson që në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Më saktësisht, ky nen saktëson që (i) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10); dhe (ii) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe

komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

183. Përkundër parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 45 të Kushtetutës, por në dritën e paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës dhe nenit 15 të Konventës Kornizë, neni 64 i Kushtetutës përcakton që, përtej garancisë për barazinë e votës dhe pa marrë parasysh numrin e votave, përkatësisht numrin e vendeve të fituara në Kuvend, komunitetet që nuk janë shumicë, kanë numër të caktuar të vendeve të garantuara në Kuvendin e Kosovës, sipas specifikave të përcaktuara në nenin 64 të Kushtetutës.
184. Për më tepër, Gjykata thekson që bazuar në nenin 110 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, (i) Kosova konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë; (ii) subjekti politik paraqet listën e kandidatëve në bazë të procedurave të caktuara nga KQZ dhe ky ligj; (iii) secila listë e kandidatëve do të ketë së paku tridhjetë për qind (30%) të kandidatëve të gjinisë tjetër; (iv) secili subjekt politik i certifikuar paraqitet në votim me *“listë të hapur”*; dhe (v) duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi voton për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votojë për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Më tej, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, çështjet që ndërlidhen me procedurat përkitazi me regjistrimin e partive politike dhe subjekteve politike, saktëson në Kreun III (Regjistrimi i partive politike dhe certifikimi i subjekteve politike) të këtij ligji. Asnjë nga këto procedura nuk përcaktojnë përjashtime apo procedura të veçanta në kuptim të komuniteteve që nuk janë shumicë. Një kriter i tillë, duke u bazuar në paragrafin 2 të nenin 64 të Kushtetutës, përkatësisht përcaktimit të vendeve të garantuara për komunitetin që është deklaruar që përfaqëson atë serb apo komunitet tjera që nuk janë shumicë, është i përcaktuar në Rregullat e KQZ-së. Më saktësisht, Rregulla nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në nenin 3 të saj përkitazi me regjistrimin e partive politike, në kuadër të dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin përkatës, gjithashtu parasheh *“deklaratën e përkatësisë etnike të themeluesit të iniciativës politike”*. Një kriter i tillë, është paraparë gjithashtu me rregullativën e KQZ-së të nxjerrë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021, përkatësisht në (i) pikën 5.12 të nenit 2 (Aplikimi për certifikim i subjektit politik) të Rregullores nr. 04/2023 lidhur me Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre; dhe (ii) pikën 1.5 të nenit 2 (Regjistrimi i partive politike) të Rregullores nr. 01/2023 lidhur me Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike.
185. Bazuar në të lartcekurat, në rendin juridik të Republikës së Kosovës, (i) bazuar në paragrafin 1 të nenit 64 të Kushtetutës, Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura; (ii) bazuar në paragrafin 1 të nenit 110 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Kosova konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë; (iii) bazuar në paragrafin 2 të nenit 45 të Kushtetutës, vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë; dhe (iv) Lista e votuesve sipas përcaktimeve të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk përmban të dhëna mbi përkatësinë etnike të votuesve në përputhje me standardet që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare siç janë shtjelluar në këtë Aktgjykim. Partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitete që nuk janë shumicë sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, *“do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura”*, pa marrë parasysh numrin e votave të fituara. Kushtetuta, ligji zgjedhor dhe rregullativa e aplikueshme e KQZ-së, nuk përcakton asnjë detyrim dhe/ose mekanizëm përmes të cilit (i) në kontekst të së drejtave aktive zgjedhore, votuesit do të detyroheshin që të zgjedhin vetëm partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët të pavarur që deklarohen që përfaqësojnë komunitetin që ata përfaqësojnë; dhe (ii) në kontekst të të drejtave pasive

zgjedhore, as vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës për partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët të pavarur nuk janë të kushtëzuara vetëm në votën e qytetarëve që u përkasin komuniteteve që ata deklarojnë që i përfaqësojnë.

186. Në kontekst të konstatimit të lartcekur, Gjykata vëren që të garantuarit e vendeve të caktuara në Kuvend për komunitete që nuk janë shumicë, por edhe në institucione tjera, është karakteristikë e, ndër tjerash, shteteve me demokraci konsociacionale. Thënë këtë, në kontekst, të rregullimit të sistemit të zgjedhor dhe siç është theksuar edhe përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe instrumenteve të tjera relevante ndërkombëtare, shtetet kanë një liri vlerësimi, përkatësisht përcaktimi të karakteristikave të vet sistemit zgjedhor, duke u bazuar në karakteristika historike dhe politike të shtetit përkatës. Më konkretisht, të garantuarit e vendeve të caktuara në Kuvend për komunitetet që nuk janë shumicë, jodetyrimisht ngërthen edhe detyrimin që këto vende të mund të fitohen vetëm nëse janë votuar nga po i njëjti komunitet që nuk është shumicë.
187. Më saktësisht, çështjet që ndërlidhen me të drejtat e pakicave kombëtare në kontekst të sistemeve zgjedhore, përtej parimeve të përgjithshme të shtjelluara në këtë Aktgjykim, janë elaboruar detajisht edhe në dokumentet në vijim:

- (i) [Ligji Zgjedhor dhe Pakicat Kombëtare i Këshillit të Evropës](#) i 25 janarit 2000 (CDL-INF (2000) 4);
- (ii) Raporti për Rregullat Zgjedhore dhe Veprimet Afirmative për Pjesëmarrjen e Pakicave Kombëtare në Procesin e Vendimmarrjes në Shtetet Evropiane, miratuar nga Komisioni i Venecias më 11-12 mars 2005 (CDL-AD(2005)009);
- (iii) [Komentet në Shënimin e Komisionit të Lartë për Pakica Kombëtarë të OSBE-së](#) lidhur me analizën e Komisionit të Venecias për votimin e dyfishtë të pakicave kombëtare të 13 shtatorit 2007 (CDL-EL(2007)025);
- (iv) Mbrojtja e Pakicave Kombëtare dhe Zgjedhjet, miratuar nga Komisioni i Venecias më 16 maj 2008 (CDL-EL(2008)002rev); dhe
- (v) Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve lidhur me sistemet Zgjedhore dhe Pakicat Kombëtare të miratuar nga Komisioni i Venecias më 24 qershor 2019 (CDL-PI(2019)004).

188. Raportet dhe opinionet e lartpërmendura, sqarojnë sistemet zgjedhore në të gjitha shtetet evropiane dhe më gjerë në kontekst të akomodimit të pakicave kombëtare. Siç sqarohet në dokumentet e lartcekura, në pjesën më të madhe të tyre, rregullat zgjedhore nuk bëjnë dallimin në mes votuesve, përderisa ka edhe sisteme zgjedhore të cilat në kontekst të të drejtave pasive zgjedhore përcaktojnë garanci dhe/ose lehtësi shtesë lidhur me pakicat kombëtare, ndërsa në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore vënë theksin në lirinë dhe fshehtësinë e votës, e përjashtimisht dhe në raste të veçanta duke mundësuar votën e dyfishtë ose lista të veçanta zgjedhore për pakicat kombëtare. Thënë këtë, për aq sa janë të rëndësishme për rrethanat e rastit, dokumentet e lartcekura, ndër të tjera, përmbledhin rregullime të ndryshme të sistemeve zgjedhore dhe të cilat, varësisht nga karakteristikat e secilit shtet, mund të lehtësojnë përfaqësimin e pakicave, duke përfshirë mekanizmat e mundshëm si në vijim (i) duhet të lejohen partitë që përfaqësojnë pakicat kombëtare, megjithatë, pjesëmarrja e pakicave kombëtare në partitë politike nuk është dhe nuk do të kufizohet në të ashtuquajturat parti me bazë etnike; (ii) rregulla të veçanta që garantojnë vendet e rezervuara për pakicat kombëtare ose parashikojnë përjashtime nga kriteret normale të ndarjes së vendeve për partitë që përfaqësojnë pakicat kombëtare (për shembull, lirimi nga kërkesa e kuorumit) në parim nuk bien ndesh me të drejtën e barabartë të votës;

(iii) as kandidatët dhe as votuesit nuk duhet të jenë të detyruar të zbulojnë anëtarësimin e tyre në një pakicë kombëtare; (iv) pragjet zgjedhore nuk duhet të ndikojnë në mundësitë e përfaqësimit të pakicave kombëtare; dhe (v) njësitë zgjedhore (numri i tyre, madhësia dhe forma, magnituda) mund të dizajnohen me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së pakicave në proceset vendimmarrëse (shih CDL-PI(2019)0004, faqe 13).

189. Për sa i përket, veçanërisht rregullave specifike të votimit për pakicat kombëtare, sipas raporteve të lartcekura, shtetet përjashtimisht, mund të devijojnë nga parimi i të drejtës së barabartë të votës, duke miratuar sisteme të veçanta në lidhje me pakicat kombëtare nëse një sistem i tillë ngërthen një qëllim të ligjshëm dhe të nevojshëm dhe metoda e zgjedhur është proporcionale me rezultatin e kërkuar (CDL-EL(2008)002rev, paragrafi 48). Në kontekstin e rregullimit specifik për pakica kombëtare në kontekstin e të drejtave aktive zgjedhore, dhe siç është sqaruar më lart, këto sisteme mund të parashikojnë (i) të drejta votimi të dyfishta; dhe (ii) listat e veçanta të votuesve (shih CDL-AD(2005)009, paragrafi 16). Këto sisteme duhet të jenë mishëruara në Kushtetutat dhe/ose ligjet zgjedhore të vendeve përkatëse.
190. Në Republikën e Kosovës, një sistem i tillë, i cili përcakton sisteme të veçantë zgjedhor për komunitetet që nuk janë shumicë në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, nuk është i përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme përfshirë rregullativën e KQZ-së. Në fakt, bazuar në të lartcekurat, Gjykata thekson që në rendin juridik të Republikës së Kosovës, të drejtat aktive zgjedhore, përkatësisht e drejta për të zgjedhur bazuar në nenin 45 të Kushtetutës i nënshtrohet vetëm kufizimit të moshës, përkatësisht asaj tetëmbëdhjetë vjeçare dhe vendimit gjyqësor, dhe përtej këtyre dy kritereve, ajo është personale, e lirë, e barabartë dhe fshehtë dhe bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi në kontekst të përkatësisë etnike të votuesve. Kushtetuta dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, nuk kanë asnjë dispozitë bazuar në të cilën vendet e garantuara sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, mund të fitohen vetëm me kushtin që vota për to të jetë dhënë nga komuniteti i njëjtë dhe përderisa shtetet kanë hapësirë vlerësimi dhe liri në përcaktimin e sistemeve zgjedhore, një qasje e tillë është në përputhshmëri me instrumentet ndërkombëtare siç janë sqaruar më lart dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Sipas Kushtetutës vota është personale, e lirë, e barabartë dhe e fshehtë ndërsa dhe ndër tjerash, sipas Kodit të Praktikave të Mira, as kandidatët dhe as votuesit nuk janë të detyruar të zbulojnë përkatësinë e tyre si pakicë kombëtare.
191. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton, Aktgjykimet e GJEDNJ-së, të shtjelluara më lart dhe bazuar në të cilat ajo ka trajtuar të drejta dhe/ose konteste zgjedhore në kuptim të të drejtave të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe në të cilat është kontestuar shkelje e nenit 3 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Shkeljet e përcaktuara nga GJEDNJ, dhe gjithnjë në dritën e rrethanave faktike dhe konteksteve në të cilat janë nxjerrë aktgjykimet përkatëse, saktësojnë në parim (i) që përkatësia etnike nuk mund të jetë pengesë për tu regjistruar në lista zgjedhore, përkatësisht për të ushtruar të drejtën për të zgjedhur (aspekti aktiv i votës), siç është rasti në Aktgjykimin *Aziz kundër Qipros* ose për tu zgjedhur (aspekti pasiv i votës), siç është rasti në Aktgjykimin *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* por edhe *Zorić kundër Bosnje dhe Hercegovinës*; dhe (ii) që përkatësia etnike nuk mund të privojë nga e drejta për të ushtruar të drejtën e lirë të votës (aspekti aktiv i votës), duke e kufizuar një qytetaretë një pakicë kombëtare për të votuar vetëm për listën e mbyllur e specifike të kandidatëve të pakicës përkatëse siç është rasti me Aktgjykimin *Bakirdzi dhe E.C. kundër Hungarisë*.

192. Në fakt ky i fundit, përkatësisht rasti *Bakirdzi dhe E.C kundër Hungarisë* është tejet relevant për rrethanat e rastit konkret, sepse ndër të tjera, ka të bëjë me (i) shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve; (ii) mangësitë e sistemit të votimit të pakicave kombëtare që ndikojnë në fshehtësinë e votimit; (iii) sistemet që kërkojnë që një kandidat i pakicës kombëtare të zgjedhet vetëm nga votuesit e të njëjtës pakicë; (iv) sistemet që lejojnë votuesit e pakicave kombëtare të votojnë vetëm për listat e tyre përkatëse të pakicave kombëtare dhe jo për listat e përgjithshme të partive politike; dhe (v) sistemet që kufizojnë mundësinë e votuesve të pakicave kombëtare që të rrisin efektivitetin e tyre politik si grup dhe rreziku i reduktimit të diversitetit dhe pjesëmarrjes së pakicave në vendimmarrjen politike.
193. Në këtë rast, dhe përkundër faktit që vet ligji hungarez përcakton ndërlidhjen në mes të të drejtave aktive dhe pasive zgjedhore me përkatësinë etnike përkatëse lidhur me vende të caktuara në kuvend, GJEDNJ, në kontekst të rrethanave të rastit përkatës, konstatoi që të drejtat zgjedhore të votuesve të pakicave kombëtare ishin cenuar në kundërshtim me garancitë e përcaktuara përmes nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke theksuar, ndër tjerash, që (i) ka dyshime se një sistem në të cilin vota mund të hidhet vetëm për një listë specifike të mbyllur të kandidatëve dhe që kërkon nga votuesit të braktisin përkatësitë e tyre partiake në mënyrë që të kenë përfaqësim si anëtar të një pakice kombëtare, siguron “shprehje të lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e legjislativit”; dhe (ii) e drejta për fshehtësi të plotë të votës në rrethana të tilla, nuk është në dispozicion të votuesve të pakicës kombëtare.
194. Parimet e shtjelluara më lart, sqarojnë që (i) parimet që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare e siç janë shtjelluara në këtë Aktgjykim, nuk përmbajnë asnjë detyrim bazuar në të cilin shtetet duhet të miratojnë mekanizma sipas të cilave pakicat kombëtare janë të kufizuara të votojnë vetëm për subjektet politike dhe të cilat deklarohen që e përfaqësojnë të njëjtën pakicë kombëtare, përkundrazi sipas të njëjtave instrumenteve, shtetet kanë një liri të gjerë vlerësimi dhe përcaktimi përkitazi me sistemet zgjedhore bazuar në karakteristikat historike dhe politike përkatëse, gjithnjë duke gjetur mekanizmat e nevojshëm për përfaqësimin efektiv të pakicave kombëtare në vendimmarrje; dhe (ii) bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësia etnike nuk mund të paraqes kufizime as nuk kuptim të të drejtave aktive dhe pasive zgjedhore, me theks në faktin që çdo sistem që përcakton përjashtime në kuptim të të drejtave zgjedhore të pakicave kombëtare, duhet të sigurohet që e mundëson “shprehjen e lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e legjislativit” dhe siguron lirinë dhe fshehtësinë e votës.
195. Për më tepër, parimet e sqaruara më lart gjithashtu përcaktojnë që (i) bazuar në paragrafin 2 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vota është personale, e barabartë, e lirë dhe fshehtë; (ii) bazuar në paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës, pa marrë parasysh numrin e vendeve të fituara, njëzet (20) vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës i takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në mënyrën e saktësuar në këtë nen; (iii) Kushtetuta, instrumentet ndërkombëtare të saktësuara në nenin 22 të saj, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, nuk përfshijnë kushtëzimin e të drejtave aktive dhe pasive zgjedhore në përkatësi etnike, përkatësisht dhe në kontekst të vendeve të garantuara sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, detyrimin e votuesve për të zgjedhur vetëm partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur që deklarojnë të përfaqësojnë të njëjtin komunitet që nuk është shumicë në Kosovë dhe as detyrimin që këto të fundit që votohen vetëm nga komuniteti që ato deklarohen që përfaqësojnë; (iv) nëse shteti përcaktohet për një sistem të tillë, i njëjti duhet të jetë i përcaktuar përmes ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe në përputhje me përcaktimet dhe vlerat kushtetuese; dhe (v) bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është roli i

gjykatave të përcaktojnë vullnetin e votuesve dhe që çdo shpallje e pavlefshme e votave duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore dhe bazuar në procedurë të saktë të ndjekur siç është përcaktuar në ligjet dhe rregullativën e aplikueshme.

Konkluzion

196. Bazuar në sqarimet e lartcekura, në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore; dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.
197. Për pasojë, dhe në kontekst të kërkesës së parashtruesit të kërkesës që të konstatohet që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka rezultuar në cenimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për tu zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 si pasojë e refuzimit të anulimit të fletëvotimeve në komunat e Graçanicës dhe Kamenicës respektivisht, Gjykata duhet të konstatojë që ky nuk është rasti. Kjo sepse sipas sqarimeve të lartcekura bazuar në Kushtetutë, instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare, praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës fletëvotimet mund të shpallen të pavlefshme bazuar në përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë deklarin e supozuar të përkatësisë etnike që votuesit përfaqësojnë.
198. Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit.
199. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatojë që refuzimi i anulimit, përkatësisht shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotimet e saktësuar në komunën e Graçanicës dhe Kamenicës, respektivisht përmes pjesës së kontestuar të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të 12 marsit 2021 nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës për t'u zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës siç është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

(ii) Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mungesë të mekanizmave konkret për garantimin e pjesëmarrjes efektive të komuniteteve jo-shumicë dhe kërkesën e parashtruesit të kërkesës që Gjykata të detyrojë Kuvendin që të nxjerr ligj

200. Parashtruesi i kërkesës në kontekst të pretendimit të tij për shkelje të paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë pretendon edhe mungesë të mekanizmave konkret për garantimin e pjesëmarrjes efektive të komuniteteve jo-shumicë, duke konsideruar që: "[...] Gjykata Kushtetuese do duhej që të obligonte Kuvendin e Republikës së Kosovës që sa më parë të ndërmerre këto masa adekuat dhe të krijonte kushtet e nevojshme, duke rregulluar kornizën ligjore në këtë fushe, ashtu që komuniteteve

jo shumicë ne vend t'u mundësohet përfaqësimi efektiv në ulëse te garantuara, dhe, si rezultat, përfaqësimi efektiv në çështje publike dhe vendimmarrje ne përgjithësi. Këto masa adekuate do duhej te garantonin që komunitetet në mënyrë substanciale të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, duke mos lejuar shndërrimin e ulëseve të garantuara në mekanizma iluzore të përfaqësimit. Gjykata Kushtetuese, konform standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, do duhej t'i linte Kuvendit një margjine të gjerë vlerësimi që të përcaktojë se cilat masa do të ishin adekuate për të arritur këtë pjesëmarrje efektive. Një masë e tillë adekuate, për kontekstin kushtetues kosovar, do të ishte, shembull, përcaktimi ligjor që komunitetet të regjistronen në lista zgjedhore të veçanta (separate communal/electoral rolls) ashtu që vetëm votuesit e komuniteteve që gjenden në ato lista të mund të votojnë për përfaqësuesit që janë deklaruar se do t'i përfaqësojnë ato komunitete në ulëse të garantuara. Askush jashtë atyre listave nuk do të mund të votonte për ulëset e garantuara për komunitetin tjetër. Kështu do të pamundësohej votimi manipulativ mes komuniteteve në shkallën siç ka ndodhur ne Zgjedhjet e 14 Shkurtit. (Megjithëse, siç thamë, standardet ndërkombëtare precize dhe shprehimore mungojnë, të paktën në një rast është sugjeruar nga Komisioni i Venecias që një masë e tillë e listave te veçanta zgjedhore të komuniteteve të implementohet, duke marrë parasysh specifikat e situatës në atë shtet.) Kuptohet, regjistrimi në këto lista zgjedhore nuk do të ishte i detyrueshëm: secili pjesëtar i komunitetit joshumicë, konform standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, do mund të vendoste se a të regjistrohet ne listat e veçanta të komuniteteve (për të votuar për komunitetin e vet), apo në listën e përgjithshme të votuesve (për të votuar për 100 ulëset tjera në Kuvendin e Kosovës). Regjistrimi i etnicitetit të pjesëtareve të komuniteteve joshumicë në lista zgjedhore do të bëhej me kritere objektive të përkatësisë, konform Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, gjithnjë duke ruajtur privatësinë e deklariesve siç përcaktohet edhe me standarde të Komisionit të Venecias.”

201. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se vendimi i PZAP-së dhe Gjykatës Supreme për mosanulimin e votave edhe në tri komunat, Graçanicë, Kamenicë dhe Mitrovicë Veriore, “përbën shkelje të nenit 58 (4) të Kushtetutës së Kosovës dhe të nenit 15 të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, zbatimi i së cilës garantohet me nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës”.
202. Parashtruesit e kërkesës më tej theksojnë se: “vendimet e kontestuara kanë shkelur, përveç komponentit tjetër te nenit 58 (4) të Kushtetutës (barazinë efektive) në lidhje me nenin 4 (2) të Konventës Kornizë, edhe nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili përcakton një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit për të gjitha të drejtat e garantuara me kushtetutë dhe ligj.”
203. Thënë këtë, Gjykata thekson që paragrafi 4 i nenit 58 të Kushtetutës, nuk përcakton të drejta individuale, por detyrim të shtetit, i cili, “sipas nevojës do të miratojë masa” adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Sipas po të njëjtit nen dhe në kontekst të fjalisë pararendëse, masat e tilla, pasi të jenë miratuar, nuk do të konsiderohen që përbëjnë diskriminim. Për më tepër, dhe përkitazi me nenin 15 të Konventës Kornizë, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në një rast në të cilin, ndër tjerash, i është referuar nenit 15 të Konventës Kornizë, përkatësisht rasti *Partei der Friesen kundër Gjermanisë*. Në këtë rast, GJEDNJ, ndër tjerash, kishte theksuar që “[GJEDNJ] vëren se Konventa Kornizë, përderisa njeh hapësirën e vlerësimit [margin of appreciation] të shteteve në çështjet zgjedhore, ajo vë në theks përfaqësimin e pakicave kombëtare në çështje publike (shih nenin 15 të Konventës). [...] Shtetet palë në Konventën Kornizë gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në mënyrën se si t'i qasen qëllimit të

*Konventës Kornizë për të promovuar pjesëmarrjen efektive të personave që u përkasin pakicave kombëtare në çështjet publike, siç përcaktohet në nenin 15 të Konventës Kornizë. Për rrjedhojë, GJEDNJ vlerësoi se, edhe nëse interpretohet në dritën e Konventës Kornizë, Konventa nuk kërkon një trajtim të ndryshëm në favor të palëve të pakicave në këtë kontekst. Rrjedhimisht, sipas GJEDNJ-së, në rrethanat e rastit përkatës, nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1.” (shih, paragrafët 43 dhe 44 të Aktgjykimit *Partei der Friesen kundër Gjermanisë*).*

204. Në dritën e sqarimeve të mësipërme, Gjykata thekson që paragrafi 4 i nenit 58 të Kushtetutës lexuar së bashku me nenin 15 të Konventës Kornizë, përcaktojnë mundësinë e shtetit që të miratojë masa të caktuara për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve, përfshirë në fushën e sistemit elektoral, dhe se masat e tilla nuk përbëjnë diskriminim. Thënë këtë, në mënyrë që paragrafi 4 i nenit 58 të Kushtetutës së bashku me nenin 15 të Konventës Kornizë të krijojë të drejtë individuale në kontekst të të drejtave zgjedhore, një masë e tillë, duhet të jetë miratuar nga shteti, dhe bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ndërmarrja dhe/ose miratimi i një mase të tillë në kontekst të sistemit zgjedhor i takon pushtetit legjislativ dhe jo pushtetit gjyqësor dhe i cili ka për detyrë interpretimin/zbatimin e masës përkatëse pasi e njëjta të jetë miratuar. Për pasojë, Gjykata thekson që të drejtat zgjedhore në Republikën e Kosovës, nuk mund të interpretohen bazuar në paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës, por pikënisja e analizës duhet të jetë neni 45 i Kushtetutës.
205. Në kontekst të kërkesës së parashtruesit të kërkesës që Gjykata “do të duhej të detyrojë Kuvendin e Republikës së Kosovës që sa më parë të ndërmerrte këto masa adekuate dhe të krijonte kushtet e nevojshme, duke rregulluar kornizën ligjore në këtë fushe”, Gjykata fillimisht vë theks në dy çështje, përkatësisht (i) natyrën e kërkesës së parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese.
206. Në këtë kontekst, Gjykata sqaron që kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar si kërkesë individuale përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, sipas të cilit, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
207. Ndërsa bazuar në nenin 63 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, institucioni ligjvënës i Republikës së Kosovës është Kuvendi. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kompetencën e plotë që të përcaktojë modelin dhe specifikat e sistemit zgjedhor si dhe procedurat përkatëse përmes ligjeve të miratuara. Bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ligjet e miratuara nga Kuvendi, mund të i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese nëse kontestohen para saj bazuar në dispozitat e nenit 113 të Kushtetutës.
208. Në fund, Gjykata vë theks edhe në tri çështje tjera dhe të cilat ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret si në vijim (i) një Aktgjykim tjetër të Gjykatës Supreme dhe i cili ka vendosur ngjashëm si në rrethanat e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyrimin kushtetues që vetëm votat e shpallura si të vlefshme të përcaktojnë të fituarit e vendit përkatës në Kuvend, dhe procedurat përkatëse për shpalljen e pavlefshme të tyre, duke përfshirë edhe trajtimin e pretendimeve për shkelje, përkatësisht vepra të mundshme penale, lidhur me zbatimin e rregullave dhe procedurave zgjedhore, siç janë të përcaktuara në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës; dhe (iii) efektet e këtij Aktgjykimi.

209. Lidhur me çështjen e parë, Aktgjykimi sqaron që parashtuesi i kërkesës në parashtresën e tij i është referuar edhe një Aktgjykimi të Gjykatës Supreme, përkatësisht [AA.nr.30/2021] të 11 marsit 2021, që është nxjerrë pas apeleve subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin boshnjak *Nasha Inicijativa; Lista Boshnjake Unioni Social Demokrat dhe Nova Demokratksa Stranka*, dhe i cili, sipas parashtresit të kërkesës, bazuar në të njëjtin interpretim të paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës, ka anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotimet në të gjitha vendvotimet të cilat ishin kontestuar nga subjektet politike ankuese. Gjykata thekson që ky Aktgjykim asnjëherë nuk është kontestuar para Gjykatës dhe për pasojë, nuk i është nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj.
210. Përkitazi me çështjen e dytë, Aktgjykimi sqaron që paragrafi 1 i nenit 64 të Kushtetutës i referohet specifikisht “*numrit të votave të vlefshme*” në përcaktimin e vendeve të fituara në Kuvendin e Republikës, ndërsa bazat përkatëse ligjore dhe mënyra e shpalljes së votave të pavlefshme është specifikisht e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativën tjetër të aplikueshme zgjedhore. Gjykata vë theks në faktin që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, shpallja e pavlefshme e votave, duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore. Për më tepër, Gjykata thekson që veprat penale kundër të drejtave të votimit janë të përcaktuara në Kapitullin XVIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Pretendimet për shkelje përgjatë procesit zgjedhor, duke përfshirë keqpërdorimin e të drejtës së votimit dhe procedurat si të njëjtat adresohen, janë të saktësuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme por dhe Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
211. Në fund, dhe përkitazi me çështjen e tretë, përkatësisht efektet e këtij Aktgjykimi, ky i fundit sqaron që ashtu siç ka saktësuar në të paktën dy Aktgjykime paraprake që ndërlidhen me të drejta dhe liri individuale në konteste paszgjedhore, përkatësisht në (i) Aktgjykimin e Gjykatës KI207/19, me parashtues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH.nr.20/2019] të 30 tetorit 2019 dhe [A.A.U.ZH.nr.21/2019] të 5 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; dhe (ii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KI45/20 dhe KI46/20, me parashtuese *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimeve [AA.nr. 4/2020] të 19 shkurtit 2020 dhe [AA.nr.3/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, bazuar në parimin e sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk mund të prodhojë efekt juridik prapaveprues në rezultatin e shpallur zgjedhor përkitazi me zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit 2021.
212. Megjithatë, njëjtë siç ka theksuar në dy Aktgjykimet e lartcekura, kjo nuk nënkupton që ky Aktgjykim është thjeshtë deklarativ dhe pa asnjë efekt. Përmes këtij Aktgjykimi është sqaruar, ndër tjerash, që (i) bazuar në paragrafin 2 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vota është personale, e barabartë, e lirë dhe fshehtë; (ii) bazuar në paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës, pa marrë parasysh numrin e vendeve të fituara, njëzet (20) vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në mënyrën e saktësuar në këtë nen; (iii) Kushtetuta, instrumentet ndërkombëtare të saktësuar në nenin 22 të saj, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, nuk përfshijnë detyrimin që votuesit të zgjedhin vetëm për partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët të pavarur që deklarohen që përfaqësojnë komunitetin që ata përfaqësojnë dhe në kontekst të të drejtave pasive zgjedhore, as vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës për partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët të pavarur nuk janë të kushtëzuara vetëm në votën e qytetarëve që u përkasin komuniteteve që ata deklarojnë që i përfaqësojnë; (iv) nëse shteti përcaktohet për një sistem të tillë, i njëjti duhet të jetë i përcaktuar në ligje të

aplikueshme të miratuara nga Kuvendi dhe në përputhje me përcaktimet dhe vlerat kushtetuese; dhe (v) që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është roli i gjykatave të përcaktojnë vullnetin e votuesve dhe që çdo shpallje e pavlefshme e votave duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore dhe bazuar në procedurë të saktë të ndjekur siç është përcaktuar në ligjet dhe rregullativën e aplikueshme. Një interpretim i tillë duhet të merret parasysh në ciklin e ardhshëm zgjedhor për zgjedhjet parlamentare, për aq sa sistemi zgjedhor, siç është përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, mbetet i pandryshuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4 dhe 113, paragrafin 1 dhe 7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 39 dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 prill 2023

VENDOSI

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri të papranueshme kërkesën e Partisë Rome të Bashkuar të Kosovës (PREBK), të përfaqësuar nga Albert Kinolli;
- II. TË DEKLAROJË, njëzëri të pranueshme kërkesën e Partisë Liberale Egjiptiane (PLE) të përfaqësuar nga Veton Berisha;
- III. TË KONSTATOJË, me shumicë votash që Aktgjykimi [AA.nr.29/2021] i 12 marsit 2021 i Gjykatës Supreme nuk ka cenuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për tu zgjedhur sipas paragrafit 1 të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË, me shumicë votash që ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe që në bazë të parimit të sigurisë juridike nuk prek të drejtat e palëve të treta;
- V. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- VI. Ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.5 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani